

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

SH.09

f 76

**NASHO  
JORGAQI**

**SILUETA  
LETRARE**

014.09  
776.

NASHO V. JORGAQI

SILUETA  
LETRARE



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 2000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

DREJTORIA E KOMBINATIT POLIGRAFIK

Shtypshkronja e re

Tiranë, 1976

## FILLIMET ROMANTIKE TË NAIM FRASHËRIT DHE NOVELA «KATËR STINËT»

### I

Veprat e para që Naimi shkroi dhe botoi në gjuhë të huaj, ndonëse, për nga vlera dhe roli që luajtën, nuk hyjnë në krijimtarinë e tij madhore, prapë ato kanë rëndësinë e tyre jo vetëm si pikënisje në veprimtarinë letrare të poetit tonë, por edhe si krijime që i shërbejnë njohjes së atyre premisave e faktorëve të cilat çuan në formimin ideoartistik të Naimit.

Dihet se Naimi është një prej përfaqësuesve më të shquar të romantizmit shqiptar dhe nga kjo pikëpamje ia vlen të dimë se cilat qenë interesat dhe ndikimet e hershme tek ai, nga ç'burim u ushqye në fillimet e veta letrare.

Është i njohur fakti se Naimi në fillim nuk u prezantua si poet romantik. Në hapat e parë, ai u dha pas poezisë klasike persiane, u dashurua me veprat e Saadiut dhe Hafëzit, shkroi qindra vjersha persisht dhe duke ndjekur traditën e letërsisë persiane, modelet e poetëve të preferuar, shkroi dhe botoi vëllimin poetik «Ëndërrimet» («Tejahylat»). Por më vonë, ai nuk ndoqi këtë rrugë dhe nuk kishte si ta ndiqte. Fryma dhe mjetet tradicionale të poezisë klasike persiane dhe turko-arabe nuk i përgjigjeshin kërkesave të reja historike, nevojave të lëvizjes kombëtare që filloi me kohë t'i ndiejë e t'i kuptojë.

Në Zosimea ai kishte mësuar gjuhën dhe letërsinë

frënge, ishte njohur me historinë e Francës, kishte lexuar veprat e Rusoit dhe të Volterit. Naimi u mëkua me idetë e revolucionit borgjez dhe këto ide s'kishin si të mos sillnin ndryshime në botëkuptimin e tij përgjithësisht dhe të koncepteve estetike në veçanti. Po këto ide me siguri do të kishin mbetur në kufijtë e entuziazmit djaloshtar edhe te Naimi, në qoftë se ai nuk do të ishte lidhur ngushtë me lëvizjen kombëtare të vendit të vet. Hovi dhe organizimi që mori lëvizja e jonë kombëtare pas ngjarjeve të Lidhjes së Prizrenit çelën para poetit tonë horizonte pune dhe lufte, i dhanë një përmbajtje konkrete botëkuptimit të tij.

S'ka dyshim që botëkuptimi i përparuar që përfantuan idetë e revolucionit freng te poeti ynë dhe militimi nga ana e tij në lëvizjen kombëtare, qenë faktorët kryesorë që e bënë të përqafojë një drejtim të shëndoshë letrar, siç qe romantizmi përparimtar.

Romantizmi në Evropë, në kohën kur e përqafoi Naimi, nuk ishte më në lulëzim, përkundrazi. Po dihet për arsye historike, se ai erdhi vonë në disa letërsi, siç ndodhi me letërsinë e vendeve të robëruara ose të prapambetura. Një fenomen i tillë ngjau edhe në letërsinë tonë dhe një aspekt të saj paraqet krijimtaria e Naimit.

Është e kuptueshme që Naimi për kohën kur hyri në letërsi dhe për detyrat që kishte para lëvizjes kombëtare nuk mund të përqafonte klasiçizmin, një drejtim letrar i kapërcyer, i një shoqërie që po largohej nga skena e historisë; po as realizmin, që me parimet e veta kërkonte zbulimin e kontradiktave shoqërore dhe paraqitjen me vërtetësi të jetës. Në kushtet e shoqërisë së atëhershme shqiptare dhe të nivelit të letërsisë shqipe, romantizmi ishte ndoshta e vetmja metodë krijuese që u përgjigjej nevojave imperative, për ta vënë letërsinë në shërbim të luftës çlirimtare.

Për këtë arsye më duket se paraqet mjaft interes hu-

lumtimi i atyre elementeve e premisave në krijimtarinë e Naimit, që e përgatitën poetin tonë si romantik. Marrë nga kjo pikëpamje, novela «Katër stinët», është një moment mjaft kuptimplotë.

Kalimi në pozitat e romantizmit përbënte një hap mjaft të rëndësishëm për Naimin po të kemi parasysh se ç'përfaqësonte perandoria mesjetare turke. Poeti ynë jetonte në një vend ku ishin në fuqi obskurantizmi dhe injoranca, fanatizmi e dhuna, ku jeta që vënë nën zgjedhën e një sistemi feudalo-ushtarak dhe feja e kleri kishin robëruar tërë sferat mendore e shpirtërore të njeriut. Njeriu dhe jeta e tij shoqërore, bota e brendshme qenë krejt të huaja për letërsinë. Prandaj ta drejtoje vëmendjen nga njeriu dhe shoqëria njerëzore, të çmoje botën e tij të brendshme, ndjenjat dhe mendimet, ta shikojë lumturinë e njeriut vetëm mbi tokë, të ngriheshe kundër asketizmit dhe të himnizoje natyrën, ishte vetvetiu një reagim i hapur ndaj ideologjisë sunduese. Kjo do të thoshte të viheshe në kundërshtim me letërsinë zyrtare, me dogmat muslimane.

Përpyekjet e Naimit për ta shkëputur krijimtarinë e vet nga ndikimi i fesë, për ta bërë atë pasqyrë të jetës, nuk qenë përpjekje të veçuara. Ato ishin pjesë e luftës që bënte inteligjenca përparimtare në perandorinë turke, për të përhapur idetë iluministe kundër reaksionit feudalo-klerikal.

Ndryshimet ekonomike e shoqërore që ndodhën gjatë viteve të reformave të Tanzimatit (1830-1870) sollën pasoja të rëndësishme dhe në letërsi. Pikërisht në këtë kohë, lind dhe zhvillohet letërsia borgjeze turke. Shkrimtarët e brezit të ri si Shinasiu, Zija Pasha, Ahmet Mitati etj. luftuan me ithtarët e kulturës feudale dhe epigonët e poezisë klerikale, zhvilluan një veprimtari të gjerë iluministe. Në kundërshtim me letërsinë e mëparshme, këta i vunë vetes

për detyrë ta lidhnin letërsinë me jetën reale, t'i kushtonin vëmendje njeriut dhe problemeve të rëndësishme që shqetësonin kohën e tyre. Këto përpjekje gjetën pasqyrim jo vetëm në brendinë e re që filloi të rrjedhë me letërsinë turke, po dhe në format e reja letrare që u lavruan si: novela, romani, drama, lloje të panjohura deri atëherë prej letërsisë zyrtare.

Në radhët e para të kësaj lufte që bënte inteligjenca turke do të qëndronte dhe Samiu, i njohur me emrin Shem-sedin Sami. Në këtë luftë, me sa duket u angazhua dhe Naimi. Por angazhimi i Naimit në terrenin turk, nuk vazhdoi gjatë. Ndryshe nga Samiu që forcat kryesore krijuese i lidhi me luftën e inteligjencës turke për progresin shoqëror e politik në vendin ku jetonte, Naimi talentin dhe tërë aftësitë e veta, duke filluar nga mesi i viteve '80, ia kushton kryesisht kauzës së çlirimit të atdheut. Në fakt, novela «Katër stinët», është e vetmja vepër letrare turqisht që përbën kontributin e Naimit në luftën e përbashkët për progres.

Dihet se Samiu zhvilloi një punë të madhe me karakter iluminist, jo vetëm duke përkthyer libra si «Historia e Francës» apo duke dhënë në turqisht një sërë veprash letrare të huaja, ndërmjet të cilave dhe «Të mjerët» e V.Hygoit, po dhe duke themeluar e drejtuar organe të ndryshme e duke marrë inisjativa të tjera që i shërbenin zgjimit dhe emancipimit të popullit.

Në këtë drejtim një rëndësi të madhe ka themelimi prej tij i *Bibliotekës së xhepit* më 1884. Në këtë punë, Samiu, duke marrë mbi vete barrën kryesore, tërhoqi botuesin më të shquar të Stambollit, armenin Mihran. Naimi, që sapo ishte vendosur aso kohe përfundimisht në Stamboll, i erdhi me sa duket në ndihmë të vëllait.

Në serinë e *Bibliotekës së xhepit* u botuan vepra me karakter divulgativ që përhapnin njohuri shkencore mbi

njeriun, shoqërinë dhe botën, pikëpamje të drejta mbi moralin, mbi gruan etj. Naimi përgatiti për Bibliotekën e xhepit veprat: «Zbulime dhe shpikje», një libër i vogël me karakter shkencor divulgativ dhe «Katër stinët».

Novela «Katër stinët» ishte kryesisht vepër letrare fare e ndryshme nga shoqet e saj të serisë. Po megjithëse kemi të bëjmë me një vepër letrare, «Katër stinët», siç do ta argumentojmë më poshtë, në thelb përkonte me qëllimin e përgjithshëm që kishte Biblioteka e xhepit: t'i shërbente përhapjes së ideve e koncepteve të reja mbi jetën shoqërore e shpirtërore të njeriut, t'i vinte në ndihmë emancipimit të shoqërisë, të luftonte fanatizmin dhe dogmat e ngurta të fesë myslimane.

Novela «Katër stinët» u botua më 1884 në Stamboll, në shtypshkronjën e Mihranit nën titullin turqisht: «*Fursuli erbea*». Në krye të librit është vënë shënimi «*Marrë nga frëngjishtja prej Mehmet Naimit*».

Problemi i parë që del para studjuesit ka të bëjë me shkallën e origjinalitetit të veprës. Vetë shënimi që thotë se është marrë nga frëngjishtja pa përmendur emrin e autorit, tregon qartë se nuk jemi para një vepre krejtësisht origjinale. Hulumentimet që kemi bërë në veprat e shkrimtarëve romantikë të preferuar të Naimit, siç qenë V. Hygoi dhe Lamartini, na nxitin të pohojmë se nuk kemi të bëjmë as edhe thjeshtë me një përkthim. Na e thotë mendja se lënia jashtë e emrit të autorit s'është pa shkak. Në qoftë se Naimi do të kishte bërë thjeshtë një përkthim ishte e natyrshme që ai ta vinte emrin e autorit, ashtu siç ndodhi më vonë në përkthimin e fragmenteve të Iliadës së Homerit.

Mendojmë, siç do të përpiqemi ta arsyetojmë më poshtë, se «Katër stinët» s'është as vepër krejtësisht origjinale, as thjesht përkthim, po një përshtatje. Ka shumë mundësi që Naimi të ketë marrë nga ndonjë vepër e letër-



sisë frënge, idetë, subjektin, personazhet dhe elemente të tjerë dhe këto t'i ketë përpunuar lirisht, duke futur dhe një pjesë elementesh të veta. Një praktikë e tillë ishte e njohur në letërsinë turke të asaj kohe. Nga mungesa e traditës, si-domos në fushën e prozës, kishte autorë që subjektet, motivet, figurat apo dhe elemente të tjerë i merrnin nga letërsia perëndimore, veçanërisht nga ajo franceze, dhe i trajtonin pastaj në mënyrën e tyre, simbas mundësive dhe aftësive të veta.

Dihet se vjersha e njohur e Naimit «Të varfërit» ishte një përshtatje e një vjershe omonime të V. Hygojt, po që poeti ynë nuk e quajti të arsyeshme të vejë ndonjë shënim. Këtë mund ta shtrinim për analogji dhe për «Katër stinët». Po pavarsisht nga mungesa e një pohimi të drejt-përdrejtë nga ana e Naimit, mund të themi se disa veçori të përmbajtjes së veprës na japin të drejtë ta quajmë «Katër stinët» një përshtatje. Gjejmë në të elemente që na kujtojnë tërthorazi realitetin turk, ku jetonte poeti, tipare të psikologjisë e të ambientit fanatik që i ndrydhte e i shtypte ndjenjat e të rinjve. Përsëritet herë pas here leitmotivi i njohur i poezisë orientale mbi dashurinë e bilibilit me trëndafilin. Lulet që përmenden shpesh janë lulet karakteristike të lindjes, si trëndafili, karafili, zymbyli, jasemini, borzilogu etj. Dashuria e dy të rinjve jepet vazhdimisht në një sfond lulësh e përgjithësisht me një florë të pasur që të kujton florën e vendeve orientale. Edhe nga pikëpamja e perceptimit poetik të jetës gjejmë figura karakteristike për mentalitetin e ambientit ku jetonte Naimi. Kështu, dashuria është përfytyruar si gjarpër, apo zemra e prekur nga dashuria përfytyrohet me tela apo fusha e shtruar si qilim e qielli si çarçaf, etj.

Për një punë deri diku origjinale nga ana e Naimit flasin dhe disa veçori kompozicionale e stilistike të veprës. Mënyra se si ai thuri episodet, thjeshtësia e kompo-

zicionit, gjuha e thjeshtë, disa nuanca stilistike etj. e afrojnë «Katër stinët» me Naimin. Siç do ta vemë re, ajo është pjellë e klimës letrare të kohës dhe nuk e kalon stadin e letërsisë së vendit ku jetonte e krijonte poeti ynë.

## II

Novela «Katër stinët» është një tregim lirik ose më mirë të themi një poemë në prozë kushtuar dashurisë. Ajo nuk ka subjekt në kuptimin e mirëfilltë. Vendi e subjektit e zë përshkrimi i dashurisë së dy të rinjve, duke pasur në sfond natyrën gjatë katër stinëve të vitit. Heronjtë e tregimit janë kryesisht dy të rinj, një vajzë e një djalë anonimë, pa emër. Edhe vendi ku zhvillohet idili i tyre jepet pa adresë konkrete, diku në gjirin e natyrës. Bile dhe jeta është dhënë në kufi në mes të realitetit dhe të ëndrrës.

Kjo sigurisht lidhet me atë tendencë të njohur të romantikëve, të cilët në krijimin e figurave i largoheshin qëllimisht karaktereve të gjallë, tipareve e situatave konkrete, duke i kthyer kështu në simbole e përgjithësisht në figura alegorike. Pak a shumë një praktikë të tillë do ta gjejmë të shprehur dhe në «Katër stinët».

Në themel të novelës janë vënë dashuria dhe natyra, si burime të gjalla të kuptimit e të gëzimit të jetës së njeriut mbi tokë. Ato janë përshkruar me hollësi përmes një pasurie të madhe detajesh të imta që të kujtojnë shpesh punën e endur në filigramë. Dhe pavarësisht nga fakti se deri në ç'shikallë janë origjinale, prapë ato e zbulojnë Naimin para lexuesve si artist mjaft të hollë, hetues të imtë të botës së brendshme të njeriut e vrojtues aktiv të natyrës.

Dashuria e dy të rinjve na jepet në tregim kryesisht

nëpërmjet shetitjeve që ata bëjnë në gjirin e natyrës gjatë katër stinëve të vitit. Ideja e veprës duket sa konkrete aq edhe alegorike; dashuria, ashtu si natyra ka stinët e saj, që nuk varen nga vullneti i njeriut. Këtë ide autori rreh të na e vërtetojë, duke na e përshkruar idilin e të rinjve hollësisht në kohë të ndryshme.

Shëtitja e parë e dy të rinjve ndodh në pranverë. Ashtu si çelet natyra, çelet dhe dashuria e tyre. Si në një fokus zbulohet para lexuesve lindja e kësaj ndjenje të fuqishme, trazuar me dëshira të vagëlluara e dyshime, me druajtje e heshtje, me buzëqeshje e zemërime të lehta. Duket sikur gazi e brenga nuk mund të kuptohen pa njëri-tjetrin. Është ajo fazë e dashurisë, kur ka dëshira dhe pak guxim, kur ka tundime, po ka dhe maturi nga mungesa e përvojës.

Dashuria na përshkruhet si një vuajtje e ëmbël që buron nga një kontradiktë e fortë psikologjike: nga një anë është dëshira e madhe e të rinjve për t'u afruar, por nga ana tjetër forca e zakonit, druajtja e turpi.

Gjendja psikologjike e heronjve të tregimit është dhënë në harmoni të plotë me natyrën. Natyra kudo shërben për evidencimin e dashurisë. Kështu, tërë ajo lektisje ndjenjash e endjesh, dëshirash e ëndrrash jepen duke pasur si sfond pranverën që lulëzon rreth e qark.

Në pranverë, në ringjalljen e natyrës, do të thotë autori, zgjohet më mirë se asnjëherë dashuria. Prandaj, pranvera dhe dashuria merren të lidhura ngushtë, përshkruhen të gërshetuara me njëra-tjetrën. Ndjenjës optimeste të dashurisë i është vënë peisazhi pranveror plot dritë e ngjyra, me variacione të ndryshme. Kudo që shetisin të rinjtë, në fusha e pyje, pranë krojeve e lumejve, ndihet e preket pranvera. Kjo është arritur jo vetëm në përshkrimin e hollë e piktoresk të florës së pasur dhe të këngëve të zogjve, po dhe të natyrës, përgjithësisht, të

diellit dhe qiellit, të reve dhe të erës në çaste të ndryshme të ditës e të natës.

Takimet e shetitjet e dy të rinjve në stinën e verës zenë pjesën më të madhe të novelës. Marrëdhëniet e tyre në këtë stinë janë dhënë të plota dhe konkrete. Dashuria është bërë më e fuqishme. Tani ata nuk kanë frikë të afrohen, përkundrazi, të ndezur e të dalldisur nga zjarri i dashurisë nuk dinë të shkëputen nga njëri-tjetri. Janë mbyllur në një dhomë dhe kjo i ka dhënë autorit dorë të na i përshkruajë heronjtë më afër. Kjo është një pamje që ndryshon nga tabloja idilike e pranverës. Ndjenjat e dëshirat tani nuk janë të vagëlluara apo të ndrydhura. Ato janë paraqitur të gjalla dhe të lira. Në mënyrë të veçantë na jepen me radhë tiparet fizike të vajzës, herë me ngjyra delikate, herë me një notë sensualizimi. Si vajza dhe djali paraqiten shumë të ndjeshëm, të ngarkuar me emocione të forta. Gjëja më e vogël i prek, aq sa dhe bukuria e muzgut të mbrëmjes ua mbush sytë me lotë. Flasin pak, për të mos thënë hiç. Më shumë kundrojnë njëri-tjetrin. Po në ndryshim nga pranvera, ata tani shohin dhe pëllumbat që fluturojnë, ndjekin me sy dhe zogjtë e tjerë, vërejnë lulet përqark, pinë verë e hanë pemë. Dhe kjo nuk është bërë pa qëllim: ata janë në verën e dashurisë, gëzojnë frutat që pjek kjo stinë!

Kur dashuria e dy të rinjve është në kulmin e saj, pa pritur i futen disa elementë që krijojnë një atmosferë pasigurie e skepticizmi, bëjnë të ndihet «diçka e çuditshme, si një shtatore trishtuese». Dëgjohen të këndojnë zogj ndjellëkeqas si kukuvajka e bufi, shihet një skifter që i sillt përqark çiftit. Lihet përshtypja se diçka po e kërcënon dashurinë.

Me futjen e këtyre elementëve novela nga kuptimi konkret merr një kuptim alegorik. Tani vëmendjen e lexuesit nuk e tërheq vetëm përshkrimi i marrëdhënieve

konkrete të çiftit, po dhe ajo tendencë filozofimi që nis të ravijëzohet këtej e tutje në tregim.

Në përshkrimin e vjeshtës tendenca e filozofimit thellohet më shumë. Autori i largohet gjithnjë e më tepër përshkrimeve konkrete dhe flet me gjuhën e figurave.

«Lulet tani nuk dolën gënjeshtare — u thonë heronjve frutat e pemëve. — Po ju që ju lulëzoi dashuria, ku i keni frytet?».

Autori pohon se gëzimet që sjell dashuria, si çdo gjë në botë nuk janë të përjetshme. Ato vijnë dhe ikin si pëllumba që zënë fole në zemrën e njeriut e pastaj largohen. Këtë fillojnë ta ndjejnë dy të rinjtë në stinën e vjeshtës:

«Dashuria që i kishte bërë ta donin njëri-tjetrin, që i kishte bërë të gëzuar, që ua kishte treguar të bukur e të dashur botën dhe jetën e tyre dhe që u kishte dhënë lumturi e rrojtje pa andralla, pra kjo dashuri ishte më të fluturuar si pëllumbi dhe zemrat e tyre, që ishin çerdhe e këtij pëllumbi, po mbeteshin shkretë».

Të dy të rinjtë tani na paraqiten të tërhequr në mendime, të ftohtë, të prekur nga brenga e dhimbja.

«Ata kishin humbur pa shkak gëzimin e parë. Ishin zhytur në ca mendime që po i trishtonin që të dy. Po bëheshin përherë e më të brengosur, më të drobitur».

Sipas autorit dashuria e tyre kishte lulëzuar në pranverë, po nuk kishte lidhur kokrra, prandaj s'kishte si të jepte fryte në vjeshtë. Ftohja e dy të rinjve është dhënë shumë qartë në sfondin e peisazhit të vjeshtës.

Në pjesën e fundit jepet mbarimi i dashurisë dhe kjo përkon me stinën e dimrit. Djali dhe vajza tani janë ftohur krejt. Zemrën e tyre e ka mbushur brenga e dëshpërimi. Ata kanë ardhur në vendet ku shetitën dikur të kërkojnë gjurmët e kujtimeve të dashurisë. Po këto gjurmë nuk i gjejnë gjëkund. Atëherë qajnë, po s'janë në gjendje ta kthejnë dashurinë e humbur.

«Dashuria, — thotë djali, — ashtu si erdhi pa na pyetur ne, ashtu s'na mori leje edhe kur iku. Ajo jetoi në zemrat tona aq sa mund të rrojë një trëndafil në mes gjethesh beloshe».

Alegoria në pjesën e fundit sa vjen e zotëron në novelë. Ndihet një frymë fatalizmi që shprehet në faktin që heronjtë tani nuk e kanë veten në dorë. Ata duan dashurinë, po s'janë të zot të duan njëri-tjetrin.

«Zogun e dashurisë që është më të fluturuar nuk janë në gjendje ta mbajnë».

Për t'i theksuar më mirë idetë edhe në këtë pjesë përsëri një rol të dorës së parë luan përshkrimi i natyrës. Natyra është dhënë e shkretë. Gjithë gjallëria e bukuria e stinëve të tjera tani është zhdukur nën dëborë. Qiellin e kanë mbuluar re të zeza. Era ulërin përçark. Dalngadalë po vjen nata.

«Bota s'ish asgjë tjetër, veç dëborë e re të zeza, hesh-tje e thellë. Brenda në savanin e tokës shtrihej kufoma e të ftohtit».

Me këto fjalë mbyllet tregimi për dashurinë.

### III

S'ka dyshim se nga gjithë sa përshkruam më lart kup-tohet se «Katër stinët» është një vepër tipike romantike, goftë nga brendia, goftë nga fryma, goftë dhe nga mjetet e trajtat e saj.

Në Turqinë feudale, në vendin e fanatizmit mesjetar, ku liria e dashurisë apo dhe shoqërimi i lirë i vajzës me djalin ishte një shkelje flagrante e normave morale sunduese, një vepër si «Katër stinët», i kundërvihet vetvetiu letërsisë obskurantiste myslimane që predikonte robërinë

e gruas, asketizmin dhe ndrydhjen e ndjenjave. Me frymën e saj humanitare e tokësore, ajo përbënte një kontribut në letërsinë e re që sapo kishte marrë krahë.

«Katër stinët», ruan në vetvete disa nga veçoritë karakteristike të letërsisë romantike të shekullit të kaluar. Në radhë të parë tregimi është ngritur mbi një tipar të njohur të romantizmit. Në bazën e tij është vënë kulti i ndjenjave dhe i natyrës. Gjithë synimi është të zbulohet bota e brendshme e heronjve, dashuria e tyre në faza të ndryshme, e dhënë me tërë nuancat e variacionet. Dashuria është ndjenja e vetme që sundon tek ata.

Heronjtë e tregimit nuk janë natyra kryengritëse, që t'u ngjajnë figurave të Bajronit apo të Shelit, po përgjithësisht përkojnë me natyrën e zakonshme të heronjve romantikë të kohës. Të arratisur nga arena e shoqërisë, larg problemeve të kohës, ata tërhiqen në gjirin e natyrës dhe jetojnë në botën e lektisur të ndjenjave.

Prallë e tek dhe shkarazi na zbulohet ndonjë kënd i jetës, po dhe atëherë na jepet i idiluar. Kështu fjala vjen kur të rinjtë dalin jashtë qytetit, thuhet se «Fshatarët kishin filluar punën me dëshirë e me zell të madh».

Heronjve të novelës nuk i intereson asgjë, veç ndjenjave të tyre dhe soditjes së bukurive të natyrës. Nga kjo pikëpamje gama e pasqyrimin të jetës është mjaft e kufizuar. Po nuk duhet të harrojmë që duke përshkruar botën e ndjenjave, atë sferë të jetës shpirtërore, që letërsia fetare myslimane e kishte përjashtuar, letërsia romantike, në një vend ku sundonte fanatizmi, luante një rol përparimtar.

Në këtë vështrim, dashuria si një ndjenjë jetësore, me forcë përtëritëse, e paraqitur në një vepër me shije e vërtetësi përmes situatash e hetimesh psikologjike, kishte një vlerë ideoestetike për lexuesin që jetonte në atmosferën mesjetare anadollake.

Në novelë gjejmë mendime interesante, konstatime të holla që zbulojnë anë të reja të botës poetike të Naimit:

«Bukuria që është në të mbaruar nuk ndryshon në dukje nga bukuria që po fillon, ashtu si nuk ndryshon edhe dashuria që po zë fill nga dashuria që është në të shterur e sipër. Po bukuria dhe dashuria që janë në të mbaruar janë më tërheqëse, më të reja...»

Novela është e mbushur plot me përshkrime të bukura të natyrës. Natyra na paraqitet jo si një dekor i thjeshtë, po si pjesë përbërëse e veprës në funksion të zbulimit të botës së brendshme të njeriut. Pamjet e saj janë aq të shumta e të larmishme, sa lexuesi ndien një kënaqësi të thellë estetike. Peisazhi i fushës, pamja e pyllit dhe e kroit, loja e reve dhe e erës, lulet dhe drurët, dielli dhe hëna, të gjitha këto të vështruara në të katër stinët e vitit, ditën dhe natën i gjejmë në tablotë e panumërta të natyrës në novelë.

«... e kishte rrëmbyer vija e kroit, që rridhte ngadalë, në mes lulësh duke murmuritur e duke thënë kaq të fshehta si dhe përroi që vinte me buçimë të pashtershme nga shkëmbinjtë e lartë» ose «Atë e kishte mahnitur dhe përpirë madhështia e rëndë e mureve, hijeshia e natyrës, stolitë e derdhura mbi faqen e tokës, ngjyra e ëmbël dhe e dashur e kupores së qiellit». ose «Ushtria e reve po rendte me vrap, ku qielli si një vashë me fustan të kaltër po zbulonte ngadalë fytyrën e vet».

Të një natyre poetike, plot delikatesë e hijeshi janë dhe portretet në tregim, psh: «Balli i saj, që s'donte t'ia dinte erës, ishte dhe më i bardhë se dëborë e grumbulluar në rrëzën e malit... Shikimi i saj rrëronte çdo zemër... Leshrat e rënë mbi supe e qafë i shëmbëllenin dallgëve që bien mbi një gur mermeri që ndodhet në breg të detit».

Krahas spiritalizmit, përshkrimit të bukurisë shpirtërore të heronjve, në novelë ndihen dhe nota sensualiz-



mi. Kjo duket në vizatimin me hollësi të tipareve fizike, e veçanërisht të atyre tipareve që zgjojnë afirim reciprok. Në këto raste tregimi për dashurinë bëhet akoma më konkret, më tokësor.

«Katër stinët», siç e përmendim më lart, duke qenë pjellë e klimës romantike të kohës nuk i ka shpëtuar një lloj fryme fataliste. Në qoftë se në pjesën e parë e të dytë kjo pothuajse nuk ndihet dhe nuk lot ndonjë rol, në pjesën e tretë, ku tendenca e filozofimit, kuptimi alegorik zotëron, fryma fataliste zë një vënd me rëndësi. Kjo shprehet në idenë që dashuria e lumturia janë të kërcënuara vazhdimisht nga fuqia e errët e fatit.

Sipas autorit një forcë e fshehtë, e paracaktuar, pasi i bëri djalin e vajzën të gëzojnë dashurinë në pranverë e në verë, i ftohu gradualisht në vjeshtë dhe i ndau me përdhunë në dimër.

Është pikërisht kjo frymë fataliste një nga ato veçori që e bashkon novelën me letërsinë romantike të kohës.

Po novela, na duket se largohet nga koncepti i njohur i romantikëve mbi dashurinë që e merr dashurinë të përjetshme. Në «Katër stinët» dashuria konceptohet dialektikisht si një fenomen që ka stadet e zhvillimit të saj.

Siç vihet re, domethënia filozofike e veprës ishte kontradiktore, autori nuk është konsequent në pikëpamjet e tij. Nga një anë pranon ekzistencën e një force të fshehtë, fuqinë e fatit në jetën e njeriut, nga ana tjetër gjykon në mënyrë dialektike në trajtimin e një fenomeni njerëzor, siç është dashuria. Kuptohet se ky lloj eklektizmi në domethënien filozofike të veprës shpjegohet në përgjithësi me kontradiktat e botëkuptimit të Naimit.

Në përfundim, mund të themi se «Katër stinët», për frymën dhe karakterin që ka, për idetë dhe brendinë e saj, zë një vënd të veçantë në fillimet romantike të poetit tonë. Kjo është e para vepër, me sa dimë deri më sot që

e lidh Naimin me romantizmin, me këtë rrymë të fuqishme letrare që do të vërshojë më vonë në tërë krijimtarinë e tij.

Sigurisht «Katër stinët» është hapi i parë i poetit tonë drejt shkollës së re letrare, po kjo ka rëndësi, sepse duke përqafuar këtë metodë krijuese, ai do të shkëputet nga modelet e vjetra letrare, nga letërsia anakronike, do ta drejtojë vëmendjen nga njeriu dhe jeta e gjallë, nga bukuritë e natyrës dhe kënaqësitë tokësore.

Romantizmi i hapi horizont Naimit edhe në pikëpamje të pasurimit të mjeteve letrare, i zgjeroi kufijtë e formës artistike. Gama e gjerë e jetës, bota e pasur e ndjenjave dhe mendimeve njerëzore, sferat e reja të njohjes nuk mund të jepeshin më me mjetet e vjetra letrare, me bagazhin e varfër artistik të letërsisë së atëhershme. Metoda e re e bëri Naimin të çmojë më shumë vlerën e verbit poetik, të njohë nëntekstin, të pasurojë sistemin figurativ sidomos me simbolin, të përdonë lloje të reja të vargut etj.

Novela «Katër stinët», megjithëse nuk trajton ndonjë problem konkret të shoqërisë së kohës, dëshmon nga një anë për interesat e Naimit, për kulturën e tij, për ndjenjat e holla dhe mendimet që e shqetësonin, dëshmon nga ana tjetër se duke kaluar nëpër shkallën e parë të romantizmit, poeti ynë do ta ketë më të lehtë më vonë të lidhë poezinë me kërkesat e lëvizjes kombëtare, ta bëjë atë pasqyrë të saj, të botës shqiptare dhe të vetë njeriut shqiptar.

1971



## «ENDËRRIMET — PËRMBLEDHJA E PARË POETIKE E NAIMIT

«Ëndërrimet» («Tejahylat») u shkrua nga poeti ynë në persisht dhe u botua në Stamboll më 1884, kur ai ishte në moshën 38 vjeçare. Persishten Naimi e pat mësuar shpejt. Që fare i ri u njoh e u lidh shpirtërisht me poezinë klasike persiane. Dihet se Saadiu dhe Hafizi ishin poetët e tij të dëshiruar, prej të cilëve mori dhe formimin e parë ideoestetik. Akoma gjimnazist, Naimi filloi të vjershërojë persisht. Persishtja ishte atëherë gjuha e kulturës dhe e poezisë në vëndet e Lindjes, ashtu siç qe latinishtja në Perëndim gjatë mesjetës. «Persishtja — shkruante Samiu — është një gjuhë e krijuar për poezi, kurse poezia është e shpikur për atë gjuhë». Kuptohet se për një njeri që donte të hynte në fushën e poezisë, të vargëzuarit persisht ishte aso kohe një gur prove. Këtë provë, si duket, e kaloi dhe poeti ynë.

Naimi, simbas «Kalendarit kombiar» (1926) kishte gati një vëllim prej 200 faqesh me vjersha persisht, qëkur mësonte në Janinë. Këto ishin, me sa duket, ushtrime poetike në këtë gjuhë, të cilat ai nuk i përfshiu në përmbledhjen «Ëndërrimet». Në vëllimin e tij të parë përmblodhi kryesisht vjersha të shkruara gjatë dhjetëvjeçarit 1873-1883. Pra, me sa shihet, këto nuk janë vjersha të rinisë, siç është thënë deri më tani, po krijime që i takojnë një

moshe pak a shumë të pjekur, kur ai ka fituar një përvojë jete dhe ka hedhur bazat e kulturës e të botëkuptimit të tij.

Në vëllimin «Ëndërrimet» poeti ynë ka përmbledhur 24 vjersha, të cilat nga idetë e sfera e problemeve, nga figura dhe mënyra e trajtimit janë tipike për fazën e parë të krijimtarisë së tij. Në to, jo vetëm ndihet ndikimi i drejtpërdrejtë i poezisë klasike persiane, me gjithë ndonjë përpjekje që ai bën për t'u shkëputur prej saj, po ç'është më e rëndësishme, mungon qëndrimi aktiv ndaj problemeve të mëdha të kohës, ajo lidhje e fortë me lëvizjen patriotike, që do të shpërthejë e fuqishme në poezinë e mëvonshme të poetit. Po megjithatë, «Ëndërrimet» është pasqyrë e mendimeve dhe interesave të tij, është një pikë krahasimi për të treguar se ç'krah të fortë i dha poezisë së Naimit vala e madhe e lëvizjes kombëtare me ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit.

Në «Ëndërrimet» poeti ynë është akoma në kërkim të poezisë dhe të ideve të veta, ai ende nuk ka gjetur veten e tij. Tematika karakteristike e poezisë persiane, format dhe mjetet e saj të njohura, konvencionalizmi, tendenca e të filozofuarit dhe mbi të gjitha shkëputja përgjithësisht nga jeta e gjallë shoqërore, do të gjejnë shprehje në këtë përmbledhje poetike. Shumica e vjershave të «Ëndërrimet» janë vjersha filozofike-meditative, disa herë me spekulime mistike e metafizike, ndërsa një pjesë i kushtohet natyrës e dashurisë, ose janë thjesht elegji.

«Ëndërrimet» është padyshim pjellë e kohës, e botëkuptimit në formim e sipër të poetit, dhe kjo shpjegon faktin që në vëllim ndeshemi me aspekte të ndryshme të ideologjisë fetare apo me ngjarje e figura nga historia e fesë. Dihet se Naimi qëndron në pozita idealiste, kur një ekzistencën e një fuqie hyjnore në krijimin e botës, po duhet thënë se qysh në këtë vëllim, gjejmë përpjekje për

të mënjanuar rolin absolut të fesë në interpretimin e dukurive shoqërore e natyrore.

Në vjershat e këtij vëllimi natyra paraqitet si objekt frymëzimi dhe vëzhgimi nga ana e poetit. Çdo mendim, çdo ide ai do ta lidhë me natyrën; kulti i natyrës është në bazë të poezisë së tij dhe kjo shpjegohet me pikëpamjet panteiste të Naimit, që do të zhvillohen më vonë në veptrat e tjera.

Përmbledhja «Ëndërrimet» nuk hapet me vjershën drejtuar zotit, siç i hapnin zakonisht vëllimet e tyre poetët arabo-persianë, po me një vjershë kushtuar «Qiellit», që shpreh mahnitjen e poetit para madhështisë së natyrës. Natyra është e mbushur plot të fshehta, ajo flet, thotë Naimi, me gjuhën e erës, të reve, të detit, të malit, të yjeve dhe këtë gjuhë përpiqen ta zbulojnë dijetarët, ta njohë shkenca («Gjuha e zemrës»). Ai pranon haptazi mundësinë e njohjes së botës dhe entuziazmohet nga mendja e njeriut që arrin të depërtojë në thellësi të natyrës. Është interesant të vihet në dukje që Naimi, duke pohuar mundësinë e njohjes së ligjeve të natyrës, duke e dhënë këtë ide nëpërmjet vargjeve të tij, përhap pikëpamje të drejta, që ngjallin besim në forcën e mendjes dhe të dorës së njeriut, vihet kështu në kundërshtim me interpretimin fetar. Kuptimplotë për këtë është vjersha «Filozofi», ku ai orvatet të bëjë portretin e filozofit, të japë botën e shqetësuar dhe kërkimet e tij të vazhdueshme për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të panumërta që zgjon natyra e që kanë të bëjnë me ligjet e saj objektive. Propagandimit të diturive të këtilla i shërbejnë dhe vjershat «Lulja», «Dielli», «Hëna» etj.

Vlen të shënohet se vëmendja e poetit drejtohet jo vetëm nga gjithësia, po dhe nga jeta e njerëzve mbi tokë, nga gjendja e shoqërisë njerëzore, sado që në një kuadër shumë të ngushtë. Ai ankohet për jetën që nuk plotëson

dëshirat e qëllimet e njerëzve, e quan atë zuzare, e përfytyron si det që përpin pamëshirë njerëz dhe shpresat e tyre i quan mirazhe («Durimi dhe shpresa»).

Në vjershën «Hëna», poeti e kalon shpejt përshkrimin e bukurisë e hijeshisë së hënës, ai e shikon atë më shumë si dëshmitare të përjetshme të vuajtjeve e të padrejtësive që ndodhin mbi tokë:

*«Sa përleshje, moj në tokë ti ke parë?  
Sa trazime, sa mjerime, sa Ulahtarë...»*

Dhe fill pas tablosë së mjerimeve mbi tokë, ai gjen rast të përmendë me respekt Rusoin dhe Volterin, këta filozofë të iluminizmit evropian.

Poeti pikëllohet për vuajtjet e jetimit, i cili «dridhet si plepi në mes të erës», i qan hallin dhe merr anën e tij («Jetimi»). Ai i këndon pranverës, si stinës së varfanjakëve («Pranvera»). Por në këto lloj vjershash ndihet më shumë dëshira, keqardhja e poetit që nuk i kapërcen kufijtë e konstatimit të dhimbshëm dhe humanizmit fetar.

Naimin, si çdo poet, e ka tërhequr bukuria e peisazhit. Ai na e përshkruan peisazhin në formë të përgjithshme, pa ngjyra konkrete, na e jep atë në dimër e në pranverë, natën dhe ditën. («Dimri», «Bilbili», «Pranvera», «Anës lumit» etj.) Poezia e peisazhit të Naimit është më shumë meditative se sa përshkruese, ai përmes natyrës gjen shkas të na zbulojë mendimet dhe shqetësimet e veta:

*«Ç'më fsheh zemra e dëgjoj në tënden valë  
Të shoh ty dhe nyjen time zgjidh ngadalë!»*

Kështu i drejtohet detit Naimi me shpirt të trazuar, në vjershën «Në breg të detit». Ai i këndon me ndjenjë

të hollë bukurive të lumit, e bën për vete lëvizja e përhershme e tij dhe thotë:

*Herë shkon duke dredhur, herë drejtë,  
herë shkon duke çaluar, herë shpejt,  
herë rrjedh me kaq naze tatëpjetë,  
herë hovshëm si të ishe një shigjetë,  
herë shkon përmes lugajës që bleron,  
herë nën të drunjtat degë gjarpëron,  
herë shkon me vrull si kali që s'ka fre,  
me rrëmbim, i shkumëzuar si vare,  
herë vjen me këngë, herë vjen me valle  
herë shpejt si zog dhe herë mengadale.*

Duke i kënduar jetës mbi tokë, si jetës së vërtetë të njeriut në vjershën «Toka dhe njeriu», Naimi, dashur padashur, i kundërvihet konceptit sundues të kohës, sipas të cilit jeta e njeriut mbi dhe është një gjë kalimtare dhe se jeta e vërtetë e tij fillon në botën e përtejme. Për poetin Toka është një trup qiellor, një yllth, si gjithë trupat e tjerë «bijtë e etërit», që ka si nënë «diellin zjarrpërhapës». Nga drita e diellit lindi jeta mbi tokë, dolën frymorët e parë, prej të cilëve «u shfaq dhe ky njeriu i mbarë».

Naimi, në kundërshtim me asketizmin fetar, bën thirrje:

*Pranë tokës rri, gëzohu, o njeri!*

Edhe pse njerëzit mbi tokë vdesin e shkojnë, prapë na thotë poeti:

*«Për njerinë vdekje kurrë s'do të ketë»*

Për Naimin toka është e dashur, po «më i dashur sa më s'ka» është atdheu:

*«Më je mëmë, më je motër, më je vlla.»*

*Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je!  
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe!*

(«Atdheu»)

Në këtë vjershë gjejmë vargun:

*«Hi u bëshin gjithmonë armiqtë e tij!*

Poeti nuk na e thotë se për cilët armiq të atdheut e ka fjalën, për armiqtë në përgjithësi apo për ata, kundër të cilëve ai ka filluar të angazhohet në luftë bashkë me të vëllezërit. Sidoqoftë, kjo është kënga e parë, me sa dimë, që i këndon atdheut poeti ynë, një këngë pak e përgjithshme, konvencionale, sepse akoma nuk e kemi atë vizion konkret të atdheut, që do të përvijohet më vonë në poezinë patriotike të Naimit.

Motivi erotik prek në «Ëndërrimet» vetëm dy vjersha: «Dashurija» dhe «Vasha nazemadhe dhe me të ecur të këndshëm».

Në rast se në të parën i këndon ndjenjës së zjarhtë të dashurisë, duke e pleksur me pikëpamjet panteiste, në të dytën, kemi një vjershë të frymëzuar drejtpërdrejt nga jeta, me vargje optimiste që rrëfejnë për gëzimin e jetës mbi tokë. Poeti na vizaton portretin delikat të vajzës nazike, duke i qëndruar besnik konceptit dhe mjeteve figurative, karakteristike për poezinë orientale të kohës. Ai i këndon me frymëzim tipareve fizike të vajzës, që përbëjnë bukurinë dhe nurin e saj dhe shpreh në fund keqardhjen që kjo bukuri nuk është e përjetshme.

*«S'janë sy, por dy yje ata dy,  
është hënë, s'është ballë ai mbi ty  
ajo gojëz, ato faqe, sy e flokë  
dritë qiejsh janë, rënë te kjo tokë.*



Jetën e poetit, veç të tjerash e tronditën dhe disa fatkeqësi familjare, të cilat nuk kaluan pa lënë jehonë dhe në poezinë e tij. Në «Ëndërrimet» gjejmë disa vjersha të shkruara në vdekje të vëllezërve, të motrave e të bijave të tij. Ato janë të vetmet krijime me adresë të caktuar në jetën e poetit tonë në këtë fazë. Në vjershat «Mbi varret e motrave dhe vëllezërve» dhe «Mbi varrin e sime motre», duke marrë shtytje nga fatkeqësia, Naimi, me ton elegjiak shpreh dhimbjen e thellë dhe jep mendime mbi jetën dhe vdekjen, që arrijnë deri në shfaqje të hapura mistiko-fetare.

Një pikëllim të fortë ka zgjuar te Naimi vdekja e së bijës, të cilën ai e shpreh natyrshëm, me vargje të vetvetishme e plot sinqeritet, sa të kujton vajtimin e popullit:

*«Mjeri unë, vaj moj bijë, mjeri unë!  
Moj e dashur, moj e ëmbëla aq shumë!*

Zemra e babait është shumë e tronditur dhe në këtë gjendje, ai shpërthen në mallkime të fuqishme, duke mos i kursyer edhe kundër qiellit:

*«Pa ty mbeta, pa ty mbeta, moj me lotë!  
U shkretofsh, o qiell, moj zuzarja botë!*

(«Mbi trupin e bijës sime të vdekur).

Po këtë qëndrim të poetit shohim dhe te vjersha «Në vdekje të vëllait», kur përsëri i drejtohet qiellit me varg të rreptë, plot zemëratë:

*«Ku e ke, o qiell, vallë drejtësinë?  
Ku e ke mëshirën, hirin, bujarinë?»*

Me «Ëndërrimet», Naimi bëri hapin e parë në fushën e poezisë, prandaj ishte e natyrshme që kjo përmbledhje

barti, nga një anë kufizimet e fazës së hershme të jetës së poetit, po nga ana tjetër tregoi qartë talentin e tij, pasqyroi përpjekjet për t'u shkëputur nga tradita sunduese. Këtë shkëputje sikundër dihet, ai do ta realizojë më vonë me veprat e tij madhore, pikërisht kur do të vihet në pararojë të lëvizjes për çlirimin kombëtar.

1971.

## MENDIME RRETH PIKËPAMJEVE ESTETIKO- -LETRARE TË F. S. NOLIT

Vështirë të flasësh për mendimin estetiko-letrar të F.S.Nolit kur akoma nuk është studjuar si duhet botëkuptimi i tij. Vështirë edhe sepse ky mendim, i shpërndarë në disa periudha historike, është i kushtëzuar nga shkaqe e rrethana të ndryshme politiko-shoqërore. Po megjithatë kjo nuk na pengon të pohojmë që në krye se F. Noli edhe në këtë fushë dha një kontribut fort të çmuar, vuri një gur themeli, pa të cilin nuk mund të kuptohet historia e mendimit estetik shqiptar paramarksist. Kjo veprimtari që kap afro gjysmë shekulli, nis më 1906 me artikullin modest «Shekspiri në rrezik» dhe përmbyllet më 1947, me veprën madhore «Bethoveni dhe revolucioni frëng». Në mes këtyre dy kufijve, ai shkroi shtatë introdukte, ndonjë artikull dhe disa shënime në formë paragrafesh.

Pra, siç shihet, Fan Noli nuk na la ndonjë traktat, ku të parashtronte drejtpërdrejt pikëpamjet e veta estetiko-letrare. Këto pikëpamje gjenden të shpërndara, të shprehura në kohë e raste të ndryshme, për probleme nga më të ndryshmet. Kryesisht shkroi për autorë e vepra të letërsisë së huaj. Është fakt që Noli nuk u mor me autorë e vepra të letërsisë shqipe. Po kjo nuk ka pse të na habisë, aq më tepër, të na bëjë ta shohim si shenjë shpërfilljeje apo mungese njohjeje. Për një patriot e artist si Noli, që militonte në radhët e para të lëvizjes sonë kombëtare dhe asaj demokra-

tike nuk ishte i huaj fati i letërsisë shqipe. Ai vetë krijonte në këtë fushë, krahas shkrimtarëve të tjerë. Por, Noli, edhe pse u mor me probleme letrare, me sa duket, asnjëherë nuk e vuri veten në rolin e kritikut. Bile, na e thotë mendja se edhe kur shkroi introduktet, ai s'ishte i ndërgegjshëm që po hidhte bazat e kritikës demokratike shqiptare dhe po krijonte kështu një traditë të shëndoshë. Në qoftë se i hyri kësaj pune, ai e bëri këtë në radhë të parë për t'i ardhur në ndihmë letërsisë e kulturës shqiptare, lexuesit shqiptar. Noli u bë përkthyes nga nevojat imperative që kishte kultura jonë, u bë kritik e dha gjykime prapë nga të njëjtat motive. Nga kjo pikëpamje, ai ndoqi, si të thuash, rrugën e hapur nga Rilindja, duke zhvilluar një punë prej iluministi.

Më vonë, në kohën e emigracionit politik, F. Noli i trajtoi këto probleme nga pozita të demokracisë revolucionare, si pjesë përbërëse të luftës në të cilën ishte angazhuar kundër reaksionit për progres shoqëror.

Dhe janë pikërisht rrethanat historike dhe detyrat që kreu si luftëtar i udhëheqjes në gjirin e popullit të tij, që përcaktuan idealin estetik të Fan Nolit. Është pra e qartë se ky ideal nuk u formua nga ëndjet dhe shijet subjektive. Konceptet estetike, si pjesë e botëkuptimit të artistit kanë kurdoherë karakter historik e klasor. Një gjë e tillë do të ndodhte pa dyshim dhe me Nolin. I dalë nga vegjëlia e duke shprehur interesat e saj në krahun më të përparuar të Rilindjes sonë Kombëtare, i vënë në krye të lëvizjes demokratike në vitet '20, duke u afruar për një kohë dhe me idetë socialiste, Noli farkëtoi një ideal estetik të shëndoshë e përparimtar.

Ndryshe nga pikëpamjet idealiste dhe estetizante të Faik Konicës, ideali estetik i Nolit përbëhet nga koncepte të drejta mbi artin, mbi natyrën dhe funksionin e tij, nga koncepte demokratike. Mendimi i tij estetik është në për-

gjithësi materialist, pasi ai nuk e mistifikon artin, nuk e merr atë si shfaqje hyjnore, as nuk e absolutizon forcën krijuese të artistit, siç ndodh me ithtarët e estetikës idealiste.

Qysh në fillimet e veta, në artikullin «Shekspiri në rrezik», Noli zë në tërësi një pozitë të drejtë estetike. Duke përqafuar pikëpamjet iluministe të Dideroit, ai e sheh bukurimin e bukurisë në radhë të parë në natyrë dhe artet i quan bija të saj. Për të natyra është modeli i parë i artit dhe bukuria e saj qëndron më lart se bukuria e arteve që krijojnë njeriu.

Koncepti nolian mbi të bukurën ka një brendi konkrete, të përcaktuar nga koha e vendi, nga rrethanat shoqërore. Ai nuk e merr të bukurën në vetvete, po si shfaqje të vetë realitetit të jetës e të historisë. Ky vështrim materialist shtrihet dhe në mënyrën si e kupton ai të madhërishtmen në jetë e në art, duke e marrë jo si diçka të mbinatyreshme e mbinjerëzore, po si manifestim e mishërim i forcës e i pasurisë shpirtërore të njeriut, si shfaqje madhore të luftës që bën ai për një çështje të drejtë. Nga një pozitë e shëndoshë estetike konceptohet dhe tragjika të Noli. Duke përjashtuar çdo mistifikim e interpretim fetar, Noli i trajton vuajtjet e njerëzve në një plan krejt njerëzor, si pasojë konfliktesh të mëdha që ndodhin në jetë e në histori.

Këto koncepte mbi kategoritë estetike duken sheshti në analizat që ai u bën veprave të cilat merr në shqyrtim. Janë tamam këto koncepte që e udhëheqin Nolin, për të hetuar e përcaktuar drejt thelbin ideoestetik të krijimeve artistike, domethënien e tyre social-historike, karakterin kompleks të figurave. Kështu vlerën e vërtetë të veprës të «Armiku i popullit» e gjen në idenë e demaskimit që u bëhet «idealeve borgjeze, faqe me nder demokratike», kurse të «Don Kishoti», i duket madhë-

shtore tallja dhe vënia në lojë me një bukuri të pashoqe e klasës feudale, si klasë anakronike. Ai ngre lart idenë e luftës kundër dallimit racial të «Otello». Atë e bën për vete figura e Hamletit si njeri i Rilindjes, siç e entuziazmon dhe ideja e lirisë së personalitetit të njeriut kundër obskurantizmit mesjetar të «Rubairat». Deri dhe në muzikën e Bethovenit, bukurinë dhe madhësinë e saj ai e lidh drejtpërdrejt me idealet revolucionare që ajo mishëron.

Spektri i idealit estetik të Nolit është i gjerë dhe kjo zbulohet mjaft qartë në qëndrimin që ai mban ndaj një varg çështjesh kardinale që përcaktojnë fizionominë estetike të një artisti apo kritiku. Në qoftë se çështja e marrëdhënieve në mes brendisë dhe formës është guri i themelit, që përcakton estetikën e çdo artisti, në rastin e Nolit mund të themi se ai e zgjidh këtë në favor të së parës, duke e parë brendinë në unitet të përbashkët me formën. Gjithmonë të veprat e artit Noli do të shikojë në radhë të parë brendinë. Në këtë çështje, ai do të mbajë në vija të përgjithshme një qëndrim konsekuent dhe është kjo arsyeja, që ka një lidhje të brendshme në mes mendimeve të shprehura në hapat e tij të para dhe atyre të periudhës së pjekurisë. Për këtë ai do të shprehet, sado tërthorazi, në shkrimin «Jo lundrëthyerit», botuar në fillim të shekullit, kur do të këshillojë bashkatdhetarët:

*«Prapa çdo libre, çdo gazete, çdo këndimi, çdo fjalë, çdo lëvizjeje, shqiptari do të heqë perden, të shikojë cili mëshihet!»*

Natyrisht, ky është vetëm fillimi. Më vonë ky mendim do të evoluojë, do të qartësohet e zbërthehet akoma më tej dhe ai gjithnjë e më tepër do të bëhet i ndërgjegjshëm për rolin vendimtar të përmbajtjes në art. Kështu, në studimin «Bethoveni dhe revolucioni frëng», Noli do të arrijë që dhe në një art abstrakt siç është muzika, të

shohë një brendi konkrete social-historike dhe ta kush-tëzojë vlerën e saj, në radhë të parë, nga ajo çka shpreh e pasqyron. Ai do të shpallë e do të argumentojë shkencërisht se «*është e pamundur të kompozosh, pa patur një ide*».

Pra, Noli është për ideshmërinë e artit, për funksionin shoqëror të tij, për pasqyrimin në të të jetës e të frymës së kohës. Ai asnjëherë nuk e kupton artin si diçka në vetvete, si një qëllim pa destinacion shoqëror. Për Nolin janë krejt të huaja konceptet e trajtimet formaliste, ai nuk verbohët prej formës apo të ashtuquajturit «artit të pastër» dhe u kundërvihet vetvetiu koncepteve estetizante të kohës së tij, që mbronin kultin e formës e mohonin karakterin objektiv të artit. Gjithë in-troduktet noliene kanë në bazë këtë koncept të shëndo-shë. Mbi këtë bazë ai zgjodhi dhe veprat që përktheu, duke i shoqëruar me analiza që i vlerësonin në radhë të parë për nga idetë dhe brendia e tyre social-historike.

Në analizën që u bëri shkrintarëve, veprave dhe fe-nomeneve letrare, Fan Noli zbatonte në përgjithësi me-todën e historizmit. Ai i vendosi ato në epokën e tyre historike dhe i lidhi ngushtë me kushtet shoqërore, me lufën politike e ideologjike të kohës që pasqyrojnë. Për të, krijimet artistike janë «*produkt natyral të kohës e të vendit*». Kjo i jep dorë Nolit që të depërtojë në përmbaj-tjen e veprës, të zbulojë domethënien ideoartistike, të zbërthejë drejt personazhet, të nxjerrë konkluzione të sakta e reale. Në këtë vështrim, shembujt më të mirë, Noli i dha me analizën e «Don Kishotit» dhe të «Ar-mikut të popullit». Njohja e thellë e epokës, e gjendjes së shoqërisë, hetimi i forcave lëvizëse të historisë, pozi-cioni dialektik që ai zë, të gjitha këto krijuan atë sfond të domosdoshëm, për të evidencuar drejt figurat e fe-nomenet, vlerat ideoartistike të veprave të ndryshme.

Por meritat e Nolit rriten, po të kemi parasysh që ai nuk mjaftohet vetëm me vendosjen e veprave dhe të autorëve në epokën e tyre. Noli si militant i lëvizjes revolucionare heq dhe konkluzione për kohën e tij, nxjerr mësim të rëndësishme, shpesh me vlerë praktike. Themi praktike, sepse këto i lidh me fatin e popullit të tij, me gjendjen e atdheut, me detyra politike të lëvizjes në të cilën ai militon e udhëheq. Paralelizmat që Noli bën në mes të Spanjës së Don Kishotit dhe Shqipërisë së kohës së tij, stigmatizimi i rreptë i bejlerëve dhe i mentalitetit bejlerçinas flasin për atë qëndrim aktiv, ku studjuesi është shkrirë me militantin politik. Akoma më të rëndësishme dhe aktuale janë konkluzionet që Noli nxjerr te «Armiku i popullit», kur mohon e godet pa asnjë ngurrim sistemin borgjez dhe pohon se ky sistem do të përmbysset «*kur t'ua ndreqin festen proletarët, të zgjuar nga gjumi dhe të çli-ruar nga robëria*». Qëndrimi klasor i Nolit në këto raste nuk ka si bëhet më i qartë.

Në studimet e veta letrare, Fan Noli i kushton një vëmendje të veçantë vendit dhe rolit të botëkuptimit në krijimtarinë e artistit. Këtë çështje vetëm sa e prek tërthorazi në introduktet, sidomos në analizën e botëkuptimit të Omer Kajamit, të cilin e merr në raport me sistemet filozofike të epokës, kur jetoi e krijoi poeti. Por dihet se problemit të botëkuptimit në krijimtarinë artistike, Noli do t'i kushtojë veprën e tij madhore «Bethoveni dhe revolucioni frëng». Duke e parë artistin si pjellë të epokës dhe veprën e tij pasqyrë të ideve të kohës, ai do ta konsiderojë botëkuptimin si çelës për të zbërthyer e shpjeguar drejt krijimtarin artistike dhe fenomenet e ndërlikuara estetike. Për Nolin ekziston një lidhje e përhershme në mes veprës dhe pikëpamjeve ideologjike e politike të artistit. Këtë lidhje ai e sheh dhe në një sferë aq abstrakte siç është muzika, bile dhe në muzikën jo programatike.



Gjithë analiza magjistrale që ai i bën krijimtarisë së Beethovenit tregon qartë se Noli përmbajtjen e muzikës së kompozitorit të madh e gjen pikërisht te botëkuptimi i tij, në idetë e mëdha që përftoi te ai revolucioni frëng. Studimi i Nolit mbi këtë çështje thelbësore sjell argumenta të reja dhe konkretizon akoma më mirë një nga tezat e rëndësishme të estetikës materialiste.

Ndonëse Fan Noli nuk është shprehur drejtpërdrejt dhe nuk i ka formuluar ndonjëherë pikëpamjet e veta lidhur me drejtimet letrare apo metodën krijuese, prapëseprapë nuk është e vështirë të kuptohet që ai është për një letërsi realiste, për një art realist. Vetë krijimtaria e tij dhe kriteret që ndoqi në zgjedhjen e veprave që përktheu, por akoma më shumë introduktet dhe principet ideoestetike nga të cilat u udhëhoq në analizën dhe interpretimin e veprave, tregojnë se Noli qëndronte në pozitë të realizmit. Realizmi për të, do të thoshnim, përbënte një hap të madh në progresin estetik të historisë së artit.

Jo rastësisht Noli do të ketë si shkrimtar më të preferuar Shekspirin. Qysh kur ishte një emigrant i thjeshtë ekonomik ai nuk do të druhet t'i dalë në mbrojtje dramaturgut të madh duke shkruar te «Kombi» fjalët më entuziaze. Ai e mbron nga goditjet e shpërfilljet që i bënin Leon Tolstoi e Bernard Shou veprës së Shekspirin. Noli çmon te Shekspiri jo vetëm një artist të madh, por pa dyshim dhe një realist të madh. Për të, vepra shekspiriane është një univers i jetës njerëzore, mbushur me konflikte të thella, me karaktere të fuqishme, me mendime të mëdha, me të vërteta të mëdha. Ai shkruan se as Tolstoi me krish-tërimin e tij, as Shou me logjikën praktike nuk janë në gjendje ta zbresin Shekspirin «që atje tek hipi vetë, me mendjen e tij të egërt, të marrë, pa rregull, po të bukur si natyra». Noli shfaqet kundër atyre artistëve që «përpiqen ta zbukurojnë botën, duke u larguar nga burimi i bukurisë,

nga natyra». Kuptohet, që ai është për një konceptim e paqyrim realist të jetës dhe një nga modelet realiste më të mirë e shoh në veprën e «egërt e pa rregull» të Shekspir-it.

Pikëpamjet e Nolit për realizmin manifestohen, sado që jo në formë të drejtpërdrejtë e të pastër, në analizat e introdukteve. Vetë veprat realiste që ai ka zgjedhur, qofshin ato të Shekspirit apo të Servantesit, të Ibsenit apo të Kajamit, flasin jo aq për preferenca letrare, se sa për faktin që ato i përgjigjen konceptit të tij realist mbi artin. Nga ana tjetër, vetë parimet ideoestetike dhe metodologjia që ndjek ai si kritik letrar na e pohojnë qartë këtë gjë.

Me të drejtë është thënë se ai është kritiku i parë shqiptar, që hodhi themelet e «një kritike të plotë shkencore». Duke e konsideruar kritikën si shkencë dhe analizat e saj me vlerë objektive, qysh në fillim zuri një pozitë të kundërt me Faik Konicën.

Te Fan Noli ne kemi përfaqësuesin më të shquar të kritikës letrare në letërsinë tonë demokratike. Është fakt që ndonëse ai jetoi e krijoi në vendet klasike borgjeze, në një kohë kur ishin aq të përhapura shkollat idealiste filozofike dhe estetike e ku mirazhet e dekadentizmit shfaqeshin në forma të ndryshme, prapëseprapë, në vijat kryesore konceptet e tij letrare dhe stetike nuk u prekën. Noli mbeti deri në fund për një art të ideshëm, për funksionin shoqëror të artit, ai çmoi në krijimtari pikësëpari brendinë marrë në unitet të plotë me formën, ai nuk u josh kurrë nga izmat, e konsideroi artin një armë të fuqishme në luftën për çlirim kombëtar e progres shoqëror.

Për këtë janë mjaft kuptimplote parimet ideoestetike dhe metodologjia që ai zbaton në analizën që i bën krijimtarisë artistike. Në të gjitha introduktet vendin qëndror

e zë vlerësimi i veprave, marrë në aspektin social dhe politik. Vëmendjen e lexuesit ai e drejton tek idetë, te lufta politike e konfliktet e thella shoqërore që ngrihen në to. Personazhet i shikon në radhë të parë jo si figura letrare, po si përfaqësues të epokës e të klasave të caktuara, si bartës të ideve të kohës ku veprojnë. Në çdo vepër Noli kërkon dhe kap tendencën themelore, prej së cilës varen dhe ndërthuren mendimet, ndjenjat, ngjarjet dhe fatet e njerëzve. Duke marrë shkas nga këto analiza, ai gjen rast të shprehë mendimet e veta politike dhe ç'është më e rëndësishme, të tregojë qëndrimin e tij, një qëndrim gjithnjë tendencioz, si luftëtar i përparimit shoqëror dhe armik i vendosur i reaksionit e i regresit. Marrë nga kjo pikëpamje shumë nga introduktet e tij nuk janë ngushtësisht studime letrare, po studime ku shprehen çështje kardinale të kohës, probleme të mprehta e urgjente, që dilnin përpara lëvizjes sonë demokratike, mësimet me vlerë për rrugët nëpër të cilat duhet të ecte shoqëria shqiptare në kushtet e rendit feudoborgjez. Këto mendime përshkojnë introduktet e «Don Kishotit», «Armikut të popullit», «Jul Qezarit», «Rubairat» etj.

Në analizën social-historike dhe shqyrtimin ideor, që u bëhen veprave duket kudo Noli politik, angazhimi i tij total, patosi që buron nga idetë demokratike për të cilat lufton; ai s'druhet të thërresë në ndihmë historinë, të godasë haptazi armiqtë e të nxjerrë mësimet nga pësimet. Hapësira e artit për Nolin nuk qëndron në qiell, po brënda kufijve realë të shoqërisë, që zien nëpër shekuj nga lufta sociale, nga padrejtësitë, nga dashuria e urrejtja. Janë këto kufij brënda të cilëve lindin dhe realizohen veprat e artit.

Po Noli kritik, që di aq mirë e bukur t'i zbulojë lexuesit vlerat ideore të veprës, di gjithashtu t'i zërthejë dhe vlerat artistike të saj. Noli është vetë një krijues i talen-

tuar, ai është matur me artistë të mëdhenj të fjalës, kur ka shqipëruar kryeveprat e tyre. Noli e njih mirë peshën dhe «magjinë» e fjalës. Prandaj nuk e ka të vështirë t'i tregojë lexuesit komponentët e tjerë të artit, elementet estetike, të nxjerrë në pah veshjen artistike të veprës, të zbulojë «kuptimet» e fshehura të krijimeve. Në këtë punë ai dëshmon jo vetëm për sens të hollë kritik, për intuitë dhe shije të shëndoshë, po tregon dhe kompetencë e pre- gatitje teorike, njohje të thellë të problemeve, kulturë të gjerë. Kritika e tij shquhet për analizën e mprehtë e të saktë të fakteve e të problemeve, për forcën e sintezës e të përgjithësimeve. Analiza noliiane ka një logjikë eloku- ente, është e thjeshtë në dukje, po prej saj rrjedh një men- dim i thellë. Ai zakonisht zbërthen nyjet e problemeve dhe nxjerr konkluzione konkrete që e ndihmojnë lexuesin për të kuptuar e interpretuar veprën.

Aftësitë e Nolit kritik duken në mënyrë të veçantë në analizën e gjithanshme, shkencore e artistike që u ka bërë figurave, sidomos personazheve kryesorë. Duke i parë ato në përgjithësi nga pozita demokratike e dialek- tike, ai ka kapur thelbin e tyre dhe ka trajtuar një sërë problemesh ideoartistike, shoqërore e psikologjike që li- dhen me to. Noli tregon se i njih veprat thellë dhe jo vetëm veprat, po dhe literaturën kritike mbi to. Kjo i jep dorë t'i trajtojë e interpretojë figurat lirisht e me siguri të plotë, të parashtrojë mendime të vetat. Ne nuk i dimë burimet që ka shfrytëzuar dhe deri në çfarë shkalle i ka patur parasysh ato, po nga mënyra se si e trajton lëndën, nga argumentet që sjell, dëshmon për një punë origjinale. S'ka dyshim, që shkallën më të lartë e më të plotë, origji- naliteti i Nolit në fushën studimore e ka gjetur në vepra si «Bethoveni dhe revolucioni frëng» si dhe «Historia e Skënderbeut», po për mendime origjinale flasin dhe intro- duktet. Mjafton të kujtojmë analizën e plotë të figurave

si ajo e Otellos, e Kasit dhe e Brutit, hetimet e holla rreth figurës së Ofelisë e të Desdemonës, nxjerrja në pah e kufizimeve të figurës së Shtokmanit. Noli përpiqet të zbulojë rrënjët e ambicjes së Makbethit dhe shkaqet sociale e psikologjike të optimizmit bosh të Don Kishotit. Ai i tregon lexuesit se ç'pasuri shpirtërore fshihet pas lëkurës së zezë të Otellos. Po një zberthim të plotë e të gjithanshëm ka gjetur në penën e kritikut tonë figura e Hamletit. Me të drejtë është vënë në dukje se Noli lëkundjet dhe komplekset e Hamletit i shpjegon nëpërmjet faktorëve historiko-shoqërorë, kur pohon se princi është akoma njeri i mesjetës dhe sado që bartte disa veti të Rilindjes, ai është i paaftë të jetojë si duhet në kohën e re. Në gjykimet që jep për Hamletin, Noli nuk mungon dhe të polemizojë bile dhe me mendimin e Gëtes, sipas të cilit Hamleti qenkish dështimi më i madh i Shekspirit. Për Nolin, Hamleti është «*piktura më e pasur dhe më e thellë që ka dalë nga penda e Shekspirit*», i cili «*në fytyrën e tij ka pikturuar vetveten*». Janë këto gjykime serioze e të guximshme, që jep në introduktet, të cilat flasin për studjuesin e ardhshëm të shkallës botërore.

Nga fundi i viteve '20 dhe fillimi i viteve '30, kur Noli do të marrë pjesë aktive në luftën politike, në botëkuptimin e tij do të ndodhin ndryshime të rëndësishme. Në këtë kohë, ai do ta vështrojë e interpretojë historinë e realitetin shoqëror nga pozitat e demokracisë revolucionare. Nga pozita të përparuara do t'i trajtojë dhe problemet letraro-artistike. Kësaj periudhe i përkasin shkrimet mbi Lessingun e Domienë, disa mendime të tjera për figurën e Don Kishotit dhe veçanërisht artikulli «*Shuberti harbut*». Duke zhvilluar në këtë kohë një luftë të madhe politike në front të gjerë, ai inkadron në të si pjesë të saj dhe letërsinë e artin. Pozita e përparuar politike do ta bënte Nolin që t'i shikojë e t'i trajtojë fenomenet e artit

jo vetëm me sy dialektik në përgjithësi, por dhe klasor. Ai e kupton tanimë se arti në analizë të fundit ka karakter klasor. Një koncept i tillë revolucionar përshkon artikullin «Shuberti harbut». Më shumë se një artikull jubilar për 100-vjetorin e vdekjes së muzikantit gjenial, ai është një pamflet i ashpër, me të cilin Noli sfidon dhe akuzon klasat sunduese e sidomos borgjezinë si shkaktare të vërtetë të vdekjes së Shubertit. Në jetën e hidhur e vdekjen e parakohshme të kompozitorit të madh, ai shikon fatin e rëndë të artistit në shoqërinë borgjeze. Ashtu si proletari edhe artisti shfrytëzohet pa mëshirë nga rendi kapitalist. «*Shubertin — shkruan Noli, — e vranë borgjezët, pasi i vodhën pemët e punës*». Noli tallet me sofizmat e borgjezisë, e cila mundimet dhe vuajtjet, që i ka shkaktuar kompozitorit, i kthen në merita të saj, duke u përpjekur të na mbushë kokën që i bëri «*një shërbim të madh muzikës, duke e lënë Shubertin pa bukë*». Ai zbulon hipokrizinë e filistinizmin e shoqërisë borgjeze, prandaj mendimet e tij kanë dhe sot një tingëllim aktual. I angazhuar tërësisht në luftën kundër armiqve të popullit, Noli pohon se me armikun e klasës, kur është puna për jetë a vdekje s'është nevoja për arsyetime. «*Borgjezia, — thotë ai — e do me grusht kokës!*» Rruga e vetme është lufta revolucionare, sepse, «*përndryshe punëtorët përgjithësisht, të muzikës e fabrikës, të pendës a të parmendës do të ngordhin pareshtur nga uria e nga oftika, sa kohë i lënë borgjezët e feudalët t'u thëthijnë gjakun, t'i vrasin me stem e më në fund të tallen me varret e tyre*».

Shkrimet që i takojnë periudhës së emigracionit politik përbëjnë shkallën më të lartë që arriti botëkuptimi i Nolit. Aspekt i këtij evolucioni është dhe mendimi nolian i këtyre viteve. Veprat që analizoi, mendimet që dha për fenomenet estetike e letrare, karakterizimet për personalitetet e artit nuk i pa si diçka në vetvete apo thjesht në

aspektin estetik, po si shfaqje të luftës politike e ideologjike, që zhvillohej në shoqërinë e kohës, të marra në raport me klasat e luftën e klasave. Të gjitha këto, padyshim, janë një kontribut i rëndësishëm që Fan Noli solli në fondin e mendimit tonë estetiko-letrar, i cili i paraprin mendimit marksist shqiptar.

1975

## DHIMBJE KRENARE<sup>1)</sup>

(Në vdekje të F. S. Nolit)

Vdekja e Fan S. Nolit, e patriotit dhe mjeshtrit të madh të fjalës shqipe, në këto ditë të bukura të pranverës së sivjetme erdhi fare e papritur. E kujt i kishte shkuar mendja të vdekja e tij! Ai që bërë për ne një figurë e tillë, që ndjenja na shtynte të mendonim sikur për të s'do të kishte mort kurrë. Po ja që vdekja bëri të sajën; reshti edhe zemra e tij, ajo zemër që për shumë e shumë vjet kishte pushtuar, herë një fushë e herë një tjetër të jetës shqiptare, ajo që përmes sa e sa veprave të vyer kishte frymëzuar e mësuar breza të tërë patriotësh e revolucionarësh. Vdiq Noli, po atdheut i mbeti figura e tij e ndritur, mbeti në histori Shqiptari me gërma të mëdha.

Vështirë është të gjenden në historinë e kulturës shqiptare personalitete kaq poliedrike sa personaliteti i gjithanshëm i Nolit. I gjithanshëm, sepse ai nuk që vetëm një patriot dhe demokrat i madh, po dhe një artist i madh, një figurë poliedrike: poet dhe dramaturg, përkthyes dhe kritik, orator dhe publicist, historian dhe kompozitor. Trashëgimi i madh që ai na la pas, me të drejtë mund të konsiderohet si një nga manifestimet e gjenisë së popullit shqiptar.

I mbrujtur me idealet e Rilindjes sonë Kombëtare

1) Botuar me disa ndryshime si kryeartikull në gazetën «Drita», mars, 1965.



dhe mendimet e përparuara të kohës, i pajisur me dhunti të shquara, duke qenë njeri me një erudicion të rrallë, me një sensibilitet artistik të madh, poliglot, Noli e çoi përpara letërsinë dhe shkencën shqiptare në shekullin e XX. Jeta dhe vepra e tij marrin një kuptim dhe rëndësi akoma më të madhe, po të kemi parasysh se Noli rrojti dhe krijoi intensivisht në disa nga momentet më dramatike për fatin e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar. Duke ndjekur traditat më të mira të rilindasve, ai e shpuri më tej stafetën e tyre, luftoi me burrëri e mençuri, si kundër zgjedhës së huaj imperialiste dhe synimeve grabitqare të shovenëve fqinjë, ashtu edhe kundër forcave konservatore e reaksionare që pengonin përparimin e shoqërisë sonë.

Noli dha një shembull të ndritur të atdhetarit që e lidhi fatin e vet me fatin e popullit, që nuk e shkëputi veprimtarinë krijuese nga nevojat e lëvizjes patriotike dhe demokratike të kohës. Tek ai shohim të bashkuar në një patriotin dhe poetin, revolucionarin dhe shkrimtarin. Krijimtaria e tij e gjithanshme i shërbeu kurdoherë idealit të tij politik. Dhe ky ideal qe: lartësimi e përparimi i atdheut. Në shërbim të këtij ideali vuri jetën dhe forcat e tij krijuese. Për interes të lëvizjes kombëtare, ai u dorëzua prift; për t'i ardhur në ndihmë kulturës sonë nisi përkthimet e pavdekshme; ai u bë poet që t'i ngrejë peshë zemrat e bashkatdhetarëve; shkroi historinë e heroit tonë kombëtar që t'u kujtojë shqiptarëve të kaluarën e lavdishme; për të luftuar forcat e errëta, që donin ta përmbysnin atdheun, ai u vu në krye të lëvizjes demokratike dhe u bë kryeministër i një qeverie revolucionare. Ai bëri vjete me ~~radhë istin e revolucionarit dhe gjatë atyre viteve të stuhishme,~~ Noli politikan s'u shkëput asnjëherë nga puna krijuese, nga letërsia e studimet, që i konsideronte si armë të forta në luftën e përditshme.

Poezia e Nolit ka mbetur pasqyrë e patriotit dhe e demokratit, ajo u ka bërë ushëtimë idealeve të tij politike, të farkëtuara në luftë me armiqtë e Shqipërisë. Poezia e tij nisi me vjersha patriotike, përmes të cilave ftonte shqiptarët të bashkohen për rimëkëmbjen e atdheut të poraçliruar nga zgjedha shekullore, ajo mori fytyrë dhe arriti kulmet me lirikat politike, ku shpërthyen dashuria dhe urrejtja e tij popullore, dhe u mbyll me vargjet që u bëjnë thirrje punëtorëve dhe katundarëve të Shqipërisë për t'u ngritur në revolucion. Kështu, poezia noliane u bë shprehje e gjallë e aspiratave të popullit punëtor në kohët e errëta të feudo-borgjezisë. Në pendën e Mjeshtrit të Madh, poezia shqipe u mbrujt me idetë e përparuara të kohës. Vjershat politike të Nolit e zgjeruan horizontin e poezisë shqipe. Mendimi i shëndoshë e i qartë, patosi revolucionar, u harmonizua në poezinë e Nolit me vërtetësinë historike, me realizmin e thellë dhe me një pasuri jo të zakonshme mjetesh artistike, të shprehura të gjitha këto në një gjuhë çuditërisht të fuqishme. Verbi nolian, epitetet e tij të përsëritshme, metaforat e mrekullueshme, nota sarkastike, ritmi marcial, këto e të tjera veti i japin poezisë së Nolit vlerën e një thesari në historinë e artit e të kulturës sonë.

Nolin poet nuk mund ta ndajmë nga Noli përkthyes. Një pjesë të madhe të forcës së tij poetike, ai e derdhi në përkthimet e pavdekshme. Ai bëri të flasin shqip disa nga mjeshttrat më të mëdhenj të letërsisë së përbotshme. Në rolin e përkthyesit, gjithmonë krijonjës, poeti ynë i fali gjuhës shqipe kryevepra me vlera shumë të mëdha. Dhe këtë punë ai e bëri si asnjë tjetër, në kohë të vështira të historisë e të artit shqiptar, duke treguar para botës vitalitetin, forcën dhe pasurinë e gjuhës sonë amtare. Përkthimet e tij lojtën një rol të paçmuar në zhvillimin dhe lartësimin e letërsisë sonë.

Nolin, ashtu siç e kishte parashikuar në vjershën

«Moisiu në mal», e ndoqi një fat i rëndë: ai gati tërë jetën e çoi në mërgim, larg atdheut dhe popullit të vet, dhe vdiq po në dhe të huaj, me zemër të rënduar e me siguri, me vizionin e Shqipërisë para syve në çastet e fundit. Por është fakt i pamohueshëm që ai s'u nda as me mend e as me zemër nga atdheu, nga ato përpjekje heroike që u bënë gjatë këtij çerek shekulli për ta nxjerrë Shqipërinë njëherë e përgjithmonë në rrugën e madhe të historisë. Noli e kuptoi dhe, s'kishte si të mos e kuptonte, se ato që nuk u realizuan në 24-ën, u kryen e u çuan më tej në 44-ën. Ai besoi se tani Shqipëria hyri njëherë e përgjithnjë në rrugën e madhe të përparimit dhe këtë e shprehu në fund të vitit 1944, kur shkroi: «Nga errësira e qorrsokakëve po hyjnë në dritën e fushën e hapur të veprimit me udhëheqës që e kanë provuar zotësinë e tyre në vijën e zjarrit. Këta udhëheqës duhen përkrahur pa kondita, pa rezerva dhe pa kursime, se e meritojnë besimin e popullit plotësisht. Me këta udhëheqës fati i atdheut është i siguar. Rroftë Shqipëria!». Noli, duke u mbetur besnik idealeve patriotike dhe demokratike, s'kishte si të mos i gëzohej me gjithë zemër sukseseve të Shqipërisë socialiste. Ai qëndroi deri në fund patriot i madh i atdheut të tij.

Kur mendojmë se ai tani vdiq dhe shohim se la pas një vazhdë të ndritur, ne ndiejmë një dhembje në shpirt, po një dhembje krenare: dhembje se reshti një zemër e madhe, por dhe një krenari për veprën e pavdekshme që na la.

Vepra e tij do të mbetet përgjithnjë shembull i ndritur për brezat e sotmë dhe të nesërm.

## KRIJIMTARIA LETRARE E STERJO SPASSES PARA ÇLIRIMIT

Në fillim të viteve tridhjetë të këtij shekulli, pas vdekjes së romancierëve tanë pionierë Foqion Postoli dhe Mihal Grameno, u duk sikur proza e gjatë shqipe ngeli pothuajse pa autorë të gjallë. Në të vërtetë kjo qe një çështje kohe, sepse u deshën vetëm pak vjetë që të vijë në letërsi një brez i ri letrarësh të talentuar dhe premtues. Dhe një nga ata letrarë, që e mori stafetën e prozës sonë aso kohe dhe eci më tej në këtë fushë akoma të palëruar mirë ishte edhe Sterjo Spasse. Që nga ajo kohë ka kaluar më se një çerek shekulli; kjo na lejon t'i hedhim një vështrim kritik rrugës që shkrimtari ynë, tanimë i njohur, ka bërë në letërsi. Mund të themi që në krye se duke studjuar nga afër veprat e Sterjo Spasses vëmë re me kënaqësi se krijimtaria e tij, ndonëse me zikzake, ka qenë gjithnjë në ngritje për të arritur caqet e së vërtetës dhe të artit. Tani, pas tridhjetë vjetë veprimtarie krijuese, ne mund të flasim për Sterjo Spassen si për një nga prozatorët e shquar të letërsisë realiste shqipe.

Shkrimtari Sterjo Spasse nuk erdhi rastësisht në letërsi. I dalë nga gjiri i fshatarësisë së shtypur e të skamur, ai pasqyroi në një radhë veprash jetën dhe aspiratat e klasës së vet, duke u bërë kështu këngëtar i fshatit shqiptar. Ndoshta shkrimet e tij të para nuk lidhen drejtpërdrejt me ambientin nga ai doli, po veprat më të mira që krijoi më vonë janë të frymëzuara pa dyshim nga jeta e

mundimshme e fshatarësisë, të cilën e njohu dhe e pasqyroi nga afër.

1

Sterjo Spasse në periudhën e parë të veprimtarisë së tij letrare përfaqësohet me romanin «Pse?!» dhe me një varg tregimesh, prozash alegorike dhe pamfletesh, të cilat e radhitin në mes shkrimtarëve përparimtarë të viteve '30. Biografia e tij si shkrimtar nis në fillim të viteve '30-të, në një nga periudhat më të errëta të historisë sonë moderne. Forcat e reaksionit që triumfuan në dhjetorin e 1924-ës vendosën diktaturën e feudo-borgjezisë, e cila mori të gjitha masat për ta mënjanuar Shqipërinë nga rruga e madhe e historisë e për t'i vënë fre përparimit shoqëror. Rendi obskurantist në fuqi u përpoq të mbyllë të gjitha shtigjet që jepnin mundësi për vazhdimin e traditave të shëndosha të Rilindjes. Shtypi u bë tribunë e ideve reaksionare dhe përfaqësonte interesat antipopullore. Oksidentalizmi, gjunjëzimi ndaj çdo gjëje perëndimore, kozmopolitizmi dhe teoritë fashiste e idealiste, këto përbënin divizën e ideologjisë zyrtare të kohës. Intelektualët e pak të që kryenin studimet jashtë ish në pjesën më të madhe bartës të kulturës borgjeze dhe qëndronin larg interesave të vërteta të popullit. Letrarët e klerit katolik të Shkodrës ishin reparti sulmues i reaksionit në luftë kundër lëvizjes komuniste dhe demokratike, duke bërë kështu punën e Vatikanit dhe të fashizmit. Shkrimtarë si Ernest Koliqi, të zhveshur nga çdo lloj patriotizmi dhe morali, i thurnin himne patriarkalizmit, poetizonin dhe idilizonin jetën e borgjezisë shkodrane, përhapnin izma të letërsisë dekadente, përpiqeshin të rekrutonin talentet që shfaqeshin në letërsinë tonë e t'i vinin në shërbim të interesave të fashizmit në Shqipëri. Të tjerë intelektualë borgjezë luftonin në shtyp kundër ideve komuniste. Branko Merxhani,

duke shpallur përse nuk ishte marksist, përhapte në një sërë artikujsh pikëpamjet idealiste të O.Komtes dhe E.Durkeimit, teoritë psikoanalitike të Z.Froidit. Anton Logoreci propagandonte «sukseset» e të ashtuquajturit rend të ri të nazistëve gjermanë. Ismet Totua kërkonte një diktaturë «të ndritur» dhe së bashku me N.Çikën e V.Koçon donin të krijonin gjoja një ideologji thjesht shqiptare «neo-shqiptarizmin» që do të qëndronte mbi interesat klasore.

Kozmopolitizmi, përhapja e teorive idealiste, veçanërisht ajo e mbinjeriut të Niçes, paraqitja e shtrembër dhe e falsifikuar e marksizmit, trumbetimi i fashizmit në të gjitha lëmet, futja në letërsi e izmave perëndimore, hedhja e parullës së artit për art — ja disa aspekte të pështjellimit ideologjik që zotëronte në jetën mendore të kohës dhe në botëkuptimin e një pjese të madhe të inteligjencës borgjeze. Në këtë drejtim, për të çorientuar njerëzit, një rol negativ ka luajtur shtypi klerikal, revista profashiste «Iliria» etj.

Letërsia shqipe në këto vite nuk është unike. Si edhe më parë në gjirin e saj erdhën e u dalluan dy drejtime të ndryshme letrare, që përfaqësonin interesa klasore të kundërta. Nga një anë kemi letërsinë demokratike, që duke ecur në rrugën e rilindasve, frymëzohet nga ide patriotike e përparimtare, shpreh në forma të ndryshme pakënaqësinë ndaj rendit shoqëror të kohës, trajton një problematikë të gjerë shoqërore duke pasqyruar varfërinë dhe mjerimin e popullit dhe, nga ana tjetër, letërsinë zyrtare, borgjeze-klerikale, apologjete e rendit feudo-borgjez, bartësja e ideve të perënduara dhe izmave dekadente.

Shkrimtarët tanë demokratë e patriotë kalonin çaste të vështira. Disa nga figurat më të njohura të letërsisë sonë ndiqeshin dhe persekutoheshin nga regjimi obskurantist. Klasiku i letërsisë së Rilindjes A.Z.Çajupi vdes në ato vite larg Atdheut; poeti i shquar N. Mjeda tërhiqet

pothuajse fare nga letërsia; F.Noli mbas shumë endjesh e rebeshesh politike larg vendit të tij, kthehet n'Amerikë dhe pushon së marruri me letërsi; letrari me talent Haki Stërmilli burgoset e persekutohet.

Po pikërisht në këtë periudhë filluan t'i vijnë forca të reja krijuese letërsisë sonë përparimtare. Kësaj kohe i përket lindja e asaj plejade letrarësh përparimtarë të talentuar me në krye Migjenin, që njihet me emrin «Brezi i viteve '30». Debutimi i tyre në letërsi, nota e re që ata sollën, idetë përparimtare, qenë të kushtëzuara nga disa fenomene të rëndësishme sociale, që u shfaqën atëherë në shoqërinë shqiptare. Në vitet '30 në Shqipëri lindi lëvizja komuniste punëtore, e cila e thelloi më shumë tendencën realiste në letërsinë shqipe të pavarësisë. Në këtë përpjekje për ta pasqyruar me realizëm jetën, për të paraqitur problemet e kohës në letërsi, hyn edhe shkrimtari i ri Sterjo Spasse me romanin «Pse?!» dhe prozën e tij përgjithësisht.

Letërsia e jonë përparimtare në atë kohë e paraqiti realitetin feudoborgjez në forma të ndryshme. Mjaft nga autorët e saj të talentuar s'kishin një botëkuptim të qartë. Shumica e tyre kishin ideale sociale utopike, qenë të pakënaqur nga rendi shoqëror, ëndërronin për një jetë më të mirë, po duke qenë larg nga botëkuptimi materialist, hynin nëpër rrugë pa krye dhe binin kështu në utopi apo nihilizëm. Prandaj në veprat e tyre duhen dalluar aspiratat demokratike, përpjekjet, megjithëse konfuze, për të mos u pajtuar me realitetin e hidhur, nga disa ide të gabuara ose të huaja që ishin shprehje e një stadi të caktuar të lëvizjes politiko-shoqërore.

Vepra e S.Spases e viteve '30-të është pjellë e kësaj kohe dhe si e tillë, ajo duhet gjykuar duke marrë parasysh kushtet e vështira nëpër të cilat iu desh të kalojë letërsia e jonë përparimtare.

«Në periudhën e rendit feudo-borgjez — shkruante më vonë S.Spasse — kur unë fillova të shkruaj m'u desh të kapërcej shumë kontradikta të brëndshme. Këto kontradikta ishin të paevitueshme në periudhën kur letërsia dekadente e së shkuarës errësonte mendimet e shkrimtarëve...».

2

Kur bëjmë fjalë për Sterjo Spassen si shkrimtar, kemi parasysh në radhë të parë talentin e tij si romancier. Në të vërtetë, ai e filloi veprimtarinë krijuese si autor tregimesh, prozash alegorike, po talenti i tij spikati më shumë në gjininë e vështirë të romanit. Vëllimet e hershme me tregime nuk bën aq jehonë sa bëri romani i tij «Pse?!». Mund të themi se që në romanin e parë u manifestuan cilësitë e tij si romancier. Këtë gjë e pohon në mënyrë edhe më të qartë e gjithë vepra që shkroi më vonë. Prandaj analizën e krijimtarisë të S.Spases para çlirimit po e fillojmë me romanin «Pse?!».

Romani «Pse?!» është pa dyshim një nga veprat që i përket letërsisë realiste të viteve '30, sepse siç e karakterizon DH.S.Shuteriqi kjo vepër, «megjithëse përfundonte në pesimizëm dhe nihilizëm, është një akuzë kundër shoqërisë, që i bënte njerëzit të humbnin ëndrrat e shpresat më të bukura të tyre».

Romani «Pse?!» përbën një aspekt mjaft interesant jo vetëm në krijimtarinë e autorit, por edhe të letërsisë sonë të asaj kohe.

Njohja me këtë vepër do të vlente *së pari* se romani «Pse?!» është vepra më serioze e S.Spases në periudhën e parë, që pohoi talentin e tij të sigurt dhe premtoi për të ardhmen e autorit në fushën e letërsisë; *së dyti* romani i rrëfen lexuesit të sotëm se ç'forma specifike mori letërsia jonë e atëhershme, për të shprehur mospajtimin dhe



protestën ndaj realitetit feudoborgjez; së treti kjo vepër zbulon gjendjen e një pjese të mirë të rinisë intelektuale të kohës, që kishte rënë në pesimizëm dhe pasivitet. Së fundi, romani «Pse?!» ka rëndësi, mbasi është nga romanet e parë të letërsisë sonë. Traditave të prozës shqipe në lëmin e gjinisë së romanit, të krijuara përmes romaneve të M.Gramenos, N.Nikajt, F.Postolit me romanin «Pse?!» iu shtua edhe një vepër e re.

Shkrimtari i ri S.Spasse, që vinte në letërsi në rrethana të tjera sociale, nuk u drejtua nga tema historike, as nga ajo patriotike, siç bënë paraardhësit e tij. Mendjen e autorit e shqetësonin problemet aktuale të kohës. Në kushtet feudo-borgjeze, kur idealet, për të cilat u përpoqën aq shumë rilindasit ishin shkelur me këmbë, trajtimi i temës shoqërore për shkrimtarët përparimtarë ishte detyrë e ditës. Po kapja pas një teme të tillë kërkonte nga ana e shkrimtarit që ai të përcaktonte mirë qëndrimin e tij ndaj realitetit shoqëror. Një gjë e tillë ishte shumë e vështirë, kur çensura qëndronte si shpata e Demokliut dhe ideologjia sunduese ushtronte presion të përditshëm. Zgjidhja e konflikteve dhe problemeve sociale, që shtronte shkrimtari ndërlikohesh akoma më shumë në rastin kur autori ishte akoma i papjekur ideologjikisht dhe personaliteti i tij letrar që ende në formim e sipër. Një gjë e tillë ndodhi edhe me shkrimtarin në romanin «Pse?!».

Tema e këtij romani, siç e pohon vetë ai, i pat lindur autorit që në shkollën Normale. Kur doli në jetë dhe nisi punën si mësues fshati, ideja për të shkruar një vepër, ku të shfrente gjithë pakënaqësinë që i ziente përbrenda, iu forcua më shumë. Padrejtësia, varfëria dhe shtypja që sundonin në jetën shqiptare qenë motivet shoqërore, që, të gërshetuara me motive personale, e shtynë të krijojë «Pse»-në.

Romanin «Pse?!» e shkroi në fshatin Derviçan të

Gjirokastrës. Mësuesi i ri kalonte në këtë kohë një krizë shpirtërore; jeta e kishte zhgënjyer dhe e kishte goditur. Sa larg qe relativiteti në të cilin ai jetonte tani nga ato që kishte mësuar në shkollë. I vetëm, në një fshat të izoluar, i shkëputur nga rrethet e vogla intelektuale dhe nga idetë e përparuara të kohës, ai nuk gjen forca në vetvete t'i zbrapsë mendimet e zymta që e pllakosin. Për më tepër, gjendja e tij ndërlikohet, kur gjatë punës që bën për të shkruar romanin, lexon autorë të tillë si Dostojevski, Niçe, Leopardi, Cvajgu etj..

Për dy vjetë me radhë e mbajti romanin në dorëshkrim dhe botoi vetëm disa fragmente nëpër gazeta. Pas dy vjetësh, më 1935, «Pse»-ja fillon e del në dritë si nënfiletë në «Gazetën e Korçës». Romani i botuar këtu për gjashtë muaj me radhë u ndoq me vëmendje nga lexuesit dhe kjo bëri që libraria «Drita» e Korçës nga fundi i po atij viti ta botojë veprën si libër më vite. Mbas tetë vjetësh, më 1943, romani u ribotua.

Romani «Pse?!» u shkrua në dy vjetët e para të viteve '30, kur lëvizja demokratike në Shqipëri nuk kishte marrë ato forma, siç mori më vonë me aktivizimin e grupeve komuniste. Letërsisë demokratike përparimtare nuk i kishin ardhur akoma forca të reja. Drejtimi kritik në letërsi ishte ende i dobët. Duhesh edhe pak kohë që të afirmohej brezi i viteve '30. Migjeni, prijësi i realizmit kritik, s'kishte dalë akoma. Akoma s'kishte dalë në dritë revista «Bota e re», që grumbulloi rreth vetes forcat letrare përparimtare dhe botoi disa artikuj me karakter programatik të artit realist. Në shtyp sundonte ideologjia zyrtare. Romani «Nëna» i Gorkit që luajti një rol të rëndësishëm në formimin ideor të brezit të ri të shkrimtarëve nuk njihej nga Spasse-ja, si ndodhi më vonë. Pra, koha kur autori i ri shkroi «Pse»-në është një periudhë tranzitore-pregatitore për lëvizjen dhe letërsinë përparim-

tare. S.Spasse nuk diti ku të mbështetej; mungonin ato ide dhe forca të organizuara, që do të vepronin në shoqërinë shqiptare disa vjete më pas.

Merita kryesore e autorit qëndron në radhë të parë në faktin se ai trajtoi në vepër një temë me karakter shoqëror dhe i vendosi ngjarjet në kohën e tij, pa u shtyrë në të kaluarën.

Romani, megjithëse nuk u mor me problemet esenciale të ditës, megjithëse nuk shprehu qartë rezistencën kundër regjimit feudoborgjez dhe s'i dha heroit një rrugëdalje, prapëseprapë është një vepër që pasqyroi një nga format e protestës kundër realitetit të hidhur. Romani, nga ana tjetër, ndonëse në mënyrë konfuze, shprehu ide pozitive dhe goditi e demaskoi disa anë të realitetit feudoborgjez.

«Në vitin 1935, — shkruan S.Spasse, — kur isha akoma i ri, botova romanin tim të parë «Pse?!» Në të unë u përpoqa të pasqyroj atë kaos që kishte pushtuar një pjesë të rinisë intelektuale, që kishte humbur shpresën dhe besimin në një të ardhme më të mirë. Heroit tim kryesor jeta i dukej aq e rëndë dhe e errët, saqë kjo e çoi në urrejtje ndaj gjithë njerëzimit. Ai nuk vuri re disa anë pozitive të jetës dhe arrin deri në nihilizëm duke mos u përpjekur të fillojë luftën kundër rrethit feudo-borgjez, i cili e çoi atë deri në një fund tragjik».

Subjekti i romanit është shumë i thjeshtë: Gjon Zaveri, një fshatar i zgjuar e simpatik mbaron studimet dhe kthehet në fshatin e lindjes. Prindët patriarkalë, sipas zakonëve të vendit, e fejojnë të birin me Afërditën, bashkëfshataren e tij. Gjon Zaveri pas shumë vuajtjesh shpirtërore dhe ropatjesh, pranon më në fund dhe i nënshtrohet zakonit...

Romani është shkruar në formë ditari dhe kjo mënyrë

i përgjigjet karakterit të veprës dhe natyrës së heroit, i cili më shumë mendon dhe filozofon se sa vepron.

Konflikti i Gjon Zaverit me familjen është një nga shkaqet e pakënaqësisë së thellë dhe i dëshpërimit të tij, po jo kryesori. Shkaku kryesor është konflikti me jetën, me shoqërinë e ngritur mbi baza të padrejta, me shoqërinë e kohës që ruan e mbron zakonet e këqia dhe shtyp personalitetin e njeriut. Po ky konflikt nuk është përshkruar në një terren konkret dhe s'është paraqitur qartë e drejtë. Heroi i ri përpiqet të filozofojë i shkëputur nga problemet shqetësuese të kohës. I çoroditur dhe i mpirë nga idetë filozofike të Niçes dhe Shopenhauerit, Dostojevskit dhe Tolstoit, ai bëhet pesimist, e humbet perspektivën për çdo gjë dhe sëmuret. Kjo gjë e bën të paraqitet më shumë si *personazh patologjik* se sa si *personazh social*.

Jeta, dashuria, vdekja — ja tri temat e diskutimeve filozofike që rreh Gjon Zaveri në ditarin e vet. Diskutimet abstrakte, që lindin më shumë nga leximet se sa nga përvoja e tij janë larg problemeve të jetës dhe nevojave të shoqërisë së kohës.

Notat e fatalizmit e të mistiçizmit, mizantropizmi e misogjenia që vihen re nëpër faqet e ditarit të Gjon Zaverit nuk kanë të bëjnë me shqetësimet e tij për fatin e shoqërisë. Ato janë më shumë bagazhi i kohës, fryt i leximeve jo të shëndosha, i dëmeve që i ka sjellë ndikimi i filozofisë reaksionare.

Tipari më i rëndësishëm, i të ashtuquajturës filozofi e Gjon Zaverit, është mohimi, ai mohon gjithçka, po duke mohuar realitetin shoqëror të kohës, mohon edhe vetë jetën; nga ana tjetër, nihilizmit të tij heroj nuk i vë përballë asnjë ideal pozitiv konkret dhe kjo, veç të tjerave, e ul vlerën shoqërore të romanit. Revolta e tij është anarshiste e pa ndonjë drejtim të caktuar.

Gjëja më e shëndoshë në mendimet e Gjon Zaverit është kritika që i drejton shoqërisë, fenomeneve negative në jetën shqiptare të atëhershme. Heroin e mundon fakti që rinia e kohës së tij, dhe në përgjithësi intelektualët, janë dhënë pas qejfeve dhe punëve të kota dhe nuk përpiqen për të krijuar *një lëvizje mendore*. Ai sheh se në jetën e rinisë zotëron amullia, apatia dhe i revoltuar pyet:

«A thua kështu ka kuptim jeta e një qytetari? I duhen shpallur luftë teneqeve mendore, parazitëve, atyre që nuk kanë interesa shoqërore.»

Gjon Zaveri arrin të kuptojë se shoqëria e kohës nuk është ngritur mbi një bazë të arsyeshme, përderisa ekziston diferencimi shoqëror, përderisa të pasurit jetojnë mirë dhe të varfërit vuajnë.

«E theksoj më tepër qëllimin e fundit, — thotë Gjon Zaveri — se unë nuk mund ta quaj aspak qytetërim, kur jetojnë fare mirë vetëm të pasurit, kurse të varfërit vdesin prej urie.»

Ai godet të ashtuquajturin qytetërim borgjez, kur thotë:

«P sh një qytet i pajisur me bulevarde prej asfalti, me ndërtesa madhështore, me teatro e cinemara, me kafene dhe me hotele..., me përmendore të mermerta e të florinjta, me kopshte, ruaj zot, si vende parajsia sa... me kishëra dhe xhamira të mëdha... po, një qytet të tillë nuk mund ta quaj aspak të përparuar, në qoftë se ruan brenda tij së paku njëqind familje që ngrysen dhe gdhihen pa bukë.»

Gjon Zaveri urren dhe kritikon pa mëshirë patriarkalizmin fshatar dhe zakonet e moralin e shoqërisë feudo-borgjeze:

«Oh, këto zakone shekullore e bëjnë verem njerin!»

Heroi i romanit ngrihet kundër mentaliteteve dhe zakoneve patriarkale që zotëronin atëherë në fshat dhe që i shkaktuan atij dramën dhe tragjedinë shpirtërore. Ai

kërkon që të rinjve t'u jepet e drejta dhe liria të zgjedhin e të vendosin vetë për shokun e jetës. Gjon Zaveri demaskon dhe tallë martesat që bëhen me para, pazarllëqet që bëhen me fatin e të rinjve. Ai kërkon një martesë të lirë, të zhveshur nga interesat materiale, të mbështetur në dashuri të vërtetë.

Në roman shtrohet çështja e emancipimit të gruas. Tragjedia e zonjës P. është pasojë e një martese të pabarabartë dhe e moralit sundues.

«Unë jam i mendimit — ngre zërin Gjon Zaveri në mbrojtje të gruas — se gruaja është e zonja të nderojë veten e saj dhe duhet të ketë të drejtë për çdo gjë shoqërore, sepse është njeri.»

Protesta e Gjon Zaverit për gjendjen e mjerë të gruas, arrin deri atje, sa ai i bën thirrje asaj të veprojë:

«Vepro, pra, o femër qytetare se është koha të përbuzësh nderimet hipokrite të burrit, është koha që të bëhesh nënë e pastër, shoqe e mbaruar, e zonjë dhe e lirë me punët e tua. Zgjidh për shoq të jetës një të zotë, një burrë të vërtetë... një njeri! Edhe ti, o vajzë katundare e zhytur n'urtësi, caktoje dashurinë e prindit mbas çmimit që kërkon yt atë nga burri i yt: sa më pak të holla që t'i kërkojë, aq më tepër të duan; dhe sa më tepër të holla të kërkojë, aq më pak të duan. Është koha për t'u dukur e gjallë dhe ti.»

Heroi nuk pajtohet edhe me aspekte të tjera të shoqërisë së kohës. Ai e quan një plagë të madhe shoqërore kumarin, një nga shfaqjet e parazitizmit. Për të, qytetërimi i kohës, qytetërimi borgjez është i sipërfaqshëm dhe nuk i përgjigjet idealeve të vërteta të njerëzimit.

Gjon Zaveri është kundër kozmopolitizmit; ai kërkon të çmohen dhe të ruhen vlerat shpirtërore të popullit, traditat e shëndosha. Sipas tij, «fisnikëria nuk trashëgohet,

por fitohet», prandaj njeriu duhet të përpiqet, për t'ia caktuar vetë vetes vëndin në shoqëri.

Në romanin «Pse?!» veprojnë edhe figura të tjera, por për karakterin që ka vepra, si një roman idesh, ato sapo shikohen dhe janë më tepër personazhe episodike.

Afërdita, e fejuara e Gjonit, është vajza fshatare e kohës me cilësitë dhe kufizimet e saj. Ajo na paraqitet tërthorazi nëpërmjet ditarit të Gjonit. Edhe Afërdita është viktimë e zakoneve, e një lidhje të pabarabartë. Lexuesit i vjen keq për fatin e saj dhe shpirtërisht është me të. Ai çmon ndjenjat e saj, preket nga pastërtia dhe naiviteti i saj rinor. Afërdita është figura më simpatike në roman dhe lexuesi, ndonëse nuk takohet me të asnjëherë drejt-përdrejt, prapëseprapë e ndjen pranë.

Ndërsa Afërdita përfaqëson vajzën fshatare, Pola është vajzë qytetare e kohës. Ajo na është dhënë më e plotë si personazh, ndaj edhe tiparet e saj dalin më të qarta. E rritur në një ambient tjetër, e edukuar dhe e arsimuar, ajo ndryshon nga Afërdita Gjika. Pola është vajza deridiku e emancipuar, që, duke u rritur në një familje qytetare, bie në dashuri dhe përpiqet të lidhet vetë me Gjon Zaverin. Figura e Polës të bën për vete me ndjenjat e thella e të sigjerta, me guxim dhe natyrën fisnike. Të duket për një çast, sikur ajo, duke u njohur me një djalë të emancipuar si Gjoni, do të realizonte ëndrrat e veta. Por ja që Gjoni nuk ka guxim të shkelë zakonet patriarkale dhe e refuzon dashurinë e saj. Edhe Polën e martojnë me shkuesi nëpërmjet pazarllëqesh dhe e lidhin me një njeri, që nuk e do. Kështu edhe ajo bie viktimë e moralit të kohës, e zakoneve tradicionale, megjithëse në një formë tjetër.

Zonja P. është gruaja që vuan pasojat e një martese të padrejtë. Ajo kërkon një rreze drite në jetën e saj të errët dhe është e dëshiruar për dashuri të vërtetë. Vuajtjet

shpirtërore dhe lufta e heshtur, që ajo ka bërë me rrethin e saj, e kanë shndërruar në një grua që vjen e venitet dalngadalë derisa ndeshet me Gjon Zaverin. Zonja P. përfaqëson atë kategori grash, të cilat e mbyllin jetën e tyre me ëndrra të paplotësuara.

Gjençi është një figurë interesante. Ai duket në fillim sikur i është kundërvënë mendimeve nihiliste të Gjonit. Dhe vërtet, ndryshe nga shoku i tij, ai është më realist në jetë dhe ka shumë momente e ide pozitive gjatë zhvillimit të romanit. Të vjen keq që autori këtij personazhi, të cilin e ka nisur mirë, i jep një përfundim tragjik. Motivet që e nxisin atë të mbytet në liqen nuk e bindin lexuesin.

Z.Nasi paraqitet si një personazh me shpirt mefistofelian dhe shumë kontradiktor. Ai e shtyn Gjonin më thellë në mendimet e tij nihiliste e në të njëjtën kohë, i thotë disa të vërteta të rëndësishme mbi jetën. Z. Nasi është i pasur dhe tregohet se është pasuruar gjoja me punën e tij të ndershme. Për më tepër, jepet me ide filantropike dhe mendon në mënyrë të çuditshme, se pasuritë i duhen kthyer popullit, i cili është krijuesi i të gjitha vlerave. Ashtu siç e ka dhënë autori, figura e z. Nasit është jashtë shoqërisë dhe kohës së tij. Po megjithëse si personazh është pak i vërtetë, ai e tërheq lexuesin me disa nga mendimet e tij.

Talenti i autorit spikat më shumë në atë pjesë të romanit, ku ai përshkruan fshatin. S.Spasse tregohet njohës i jetës dhe i botës fshatare. Në qoftë se kapitujt ku ekspozohen mendimet filozofike të Gjon Zaverit janë tepër rationale e të lodhshme, u mungon frymëzimi dhe emocioni i mjaftueshëm, kapitujt që paraqesin jetën e fshatit janë shkruar me ndjenja prej artisti. Edhe pse këto pjesë janë të kursyera, marrë në krahasim me pjesët e tjera, prapëseprapë janë këto që i mbeten më shumë në mendje



lexuesit. Kjo vjen, në radhë të parë, se autori shkruan për një subjekt që e njih dhe e dashuron, për fakte konkrete e të gjalla të jetës, që s'kanë të bëjnë me meditacionet arbitrare të heroit. Kur Gjon Zaveri kthehet në fshat dhe futet në mes fshatarëve, duket sikur qetësohet nga furia e mendimeve. Fshatarët me natyrën e tyre realiste sikur e sjellin në vete, sikur e marrin me vete zakonet dhe festat popullore, që janë të vetmet gëzime në jetën e mundimshme të njerëzve.

Mjaft piktoreske dhe me ndjenja janë përshkruar zakonet e fshatit tonë, sidomos ato të dasmës. Autori këtu nuk ka rënë në folklorizëm dhe s'ka bërë etnografi. Ai ka ditur të krijojë tablo të gjalla, plot jetë dhe interesante. Kështu, në «Natën e kuvendimit» është dhënë me bukuri të madhe gjithë atmosfera e jetës fshatare.

Festat fetare kanë marrë në roman një përmbajtje laike. Ditën e shën Janit, bie fjala, autori nuk na jep asnjë rit nga ceremonia, po na përshkruan krushqinë që lidhet në mes familjes së Gjonit dhe asaj të Afërditës. Apo kisha paraqitet si vend ku të rinjtë shkojnë për të parë dashuritë e tyre e jo për t'u falur.

Të gjitha zakonet, ceremonitë, lojërat që paraqiten në roman kanë si sfond peisazhin karakteristik të fshatit, sidomos liqenin. Kjo i ka dhënë veprës nota lirike dhe të këndshme.

Në paraqitjen e jetës së fshatit romani ka një mungesë të ndijshme meqenëse nuk na përshkruan shtypjen sociale dhe vuajtjet e fshatarësisë në kohën kur zhvillohen ngjarjet. Po vepra bëri jehonë në shtyp dhe te lexuesit, veçanërisht në rininë intelektuale. Problemet shoqërore që trajtoheshin aty dhe talenti i autorit tërhoqën vëmendjen. Një pjesë e rinisë intelektuale, që ushqente ide përparimtare, dinte të gjente në roman elemente të shëndosha. Ajo merre kritikën e Gjon Zaverit kundër realitetit, qëndri-

min mospajtues me kohën. Është pikërisht kjo që e bëri veprën të radhitet në mes veprave realiste të letërsisë tonë përparimtare.

Me romanin «Pse?!» shkrimtari jo vetëm dha provën e parë serioze të talentit të tij, po tregoi në të njëjtën kohë se sa e shqetësonte dhe e preokuponte gjendja e shoqërisë shqiptare në ato vite të errëta.

### 3

Vlera e shkrimtarit S.Spasse si një nga prozatorët e shquar të letërsisë shqipe nuk do të qe e plotë, po qe se nuk do të njiheshim me krijimtarinë e tij në lëmin e gjinive të vogla të prozës. Sigurisht, S.Spasse në radhë të parë është romancier, por edhe tregimet, skicat, prozat alegorike dhe pamfletat që ai ka shkruar janë faqe me vlera. Ato përbëjnë një aspekt mjaft interesant të rrugës nëpër të cilën është zhvilluar e po zhvillohet krijimtaria artistike e shkrimtarit tonë. S.Spasse ka shkruar disa dhjetëra vepërza të tilla. Pjesa më e mirë e tyre përfshihet në vëllimet që ai ka botuar në kohëra të ndryshme, ndërsa të tjerat gjenden të shpërndara nëpër organet e shtypit periodik. Para çlirimit autori ka botuar tre libra me tregime «Kunorë rinije» (1934). «Në krahët e një femre» (1934) dhe «Nusja pa duvak» (1944).

Prodhimin letrar të S.Spases në gjinitë e vogla të prozës mund ta ndajmë në tri lloje: në panflete, në proza alegorike ose skica dhe në tregime. Këto vepërza paraqesin për lexuesin e sotëm interes të dyfishtë: nga një anë, e njohin me gjendjen dhe problemet e shoqërisë shqiptare në të kaluarën, nga ana tjetër me vlerat ideoartistike të S.Spases para Çlirimit, me disa nga krijimet e tij të hershme, që i kanë qëndruar kohës.

Gjëja e parë që të bën përshtypje, kur lexon këto

shkrime është pakënaqësia ndaj realitetit, shqetësimi për fatin e njeriut të thjeshtë dhe të vlerave shpirtërore në konditat e rendit obskurantist, kritika dhe protesta, ndonëse e paqartë që i drejton shoqërisë së pa drejtë, kërkimet që bën shkrimtari në rrugë utopike, për të gjetur të vërtetën.

Mëndjen e shkrimtarëve tanë përparimtarë në të kaluarën e shqetësonin mjaft probleme jetike të shoqërisë shqiptare. Ata përpiqeshin nëpërmjet shkrimeve të veta të kontribuonin në zgjidhjen e këtyre problemeve. Arma e tyre e vetme ishte kritika, demaskimi, goditja e fenomeneve negative, që po e mbytnin shoqërinë tonë. Në këtë drejtim aso kohe u lavruan me sukses pamfleti dhe proza alegorike, dy lloje këto letrare-gazetareske, të cilat Gorki i ka quajtur «letërsia e jonë militante». Janë të njohura tashmë prozat alegorike të Migjenit, që shkroi në kohën e tij. Me këto gjini u morën edhe një radhë letrarësh të tjerë përparimtarë si N.Bulka, M.Treska, V.Stafa etj. Pamfletin dhe prozën alegorike e gjejmë edhe në krijimtarinë e S.Spases të kësaj periudhe. Ai trajton zakonisht probleme politike dhe shoqërore, të paraqitura herë drejtpërdrejt, herë të veshura me figura të ndryshme letrare. Në to ndjehet një notë e fortë revolte kundër normave e moralit të kohës, që e venë autorin në opozitë me ideologjinë sunduese.

/// Në pamfletin «Bota u çthur!» autori, nëpërmjet figurës konvencionale të një të çmenduri, parashtron mendime shumë të guximshme dhe godet aspekte të ndryshme të realitetit feudo-borgjez. Heroi i tij ngrihet kundër mentaliteteve të ndryshme e konservatore të ambientit dhe ideologjisë së klasave sunduese, që predikojnë nënshtrim. Ai i drejtohet vetes me këto fjalë:

«... Deh, pusho moj zemër e copëtuar! Mos rrënko më! Ti duhet të rrosh! Të rrosh që t'i kallëzosh botës të

vërtetën!... Të rrësh, po, po të rrësh, si me forcë përmbinjerëzore, gjersa të krijohet një jetë e re me njerëz të rinj! Pra, jeto, jeto edhe puno për idealin e caktuar!»

Autori konstaton me hidhërim se shoqëria e kohës i merr nëpër këmbë, i tall, bile i çmend njerëzit me vlerë. Kjo ndodh, simbas tij, sepse kudo sundojnë të liqtë, të cilët me ndihmën e fesë e shtypin popullin. Ja çfarë lexojmë në panfletin «Nga një ditë e një të çmenduri»:

«Zot, o zot, ngopmë, veshmë, mbathmë e nderomë, duke ndenjuri, dhe unë po të besoj se je! E ç'doli nga kjo? Asgjë! Shenjtor, të lutem lëshomë rrugën. Kam kohë kur të mendojem për mbas vdekjes!»

Në panfletin «Skandal! Jo, aspak», që ka në bazën e subjektit një episod prekës nga jeta, autori i çjerr maskën pseudo-moralit të klasave sunduese, rendi shoqëror i të cilëve pjell korrupsionin.

«Të mos merremi me gjëra të kota, të mos e shtrembërojmë të vërtetën, të themi atë që është, të vemë gishtin në plagë» — ja se ç'kërkon S.Spasse «Nga shënimet e një Dhiogjeni të ri».

«A nuk është më mirë dhe shumë e arsyeshme në vend të: «si je, t'i themi gazetarit: A gënjen shumë? Fajdexhiut: A rrëmben shumë faiz?... Nëpunësit: A merr shumë rryshfet? Katundarit: A ke shumë halle?...»

Kontraste shumë të forta gjejmë në panfletin «Dy të vdekur». Autori na përshkruan dy procesione të përmortshme, që ndeshen në një rrugë kryq: i pari, që përbëhet nga një varg pa mbarim njerëzisht të pispillosur dhe tërë pompozitet, përcjell një zyrtar të lartë, i cili sa kishte qenë gjallë e kishte rrjepur dhe shtypur popullin dhe, i dyti, një grup njerëzish prej katër vetash pa kurora, pa marshe vajtimi, përcjell një mësues që kishte punuar për të ndritur popullin.

Egoizmi, cinizmi dhe etja e pashuar për para — këto

janë tiparet e familjes borgjeze që dalin nga panfleta «Allilluia, allilluia, allilluia».

Autori dënon kozmopolitizmin e atyre intelektualëve, të cilët, duke mos i njohur bukuritë dhe vlerat e atdheut, ngrejnë në qiell vendet e huaja.

Ashtu si në panfletet edhe në prozat alegorike, po në një formë më të figurshme, merret me probleme të kohës dhe parashtron mendime të shëndosha.

Në bazën e këtyre vepërzave qëndrojnë figura alegorike të forta dhe realiste. Ato aludojnë tërthorazi për gjendjen e mjeruar të popullit, për errësirën që zotëron në Shqipëri, për padrejtësitë që bëhen kudo («Zëri i zemrës trandafilit»). Autori tregon nëpërmjet figurës alegorike të lumit («Ankimi i lumit») për vuajtjet e mëdha që i sjellin njerëzve tiranët dhe xhelatët, të cilët janë vetëm vegla të klasave sunduese.

Shkrimtari e ndien veten në shoqërinë e kohës si në një pellg, i rrethuar nga të gjitha anët me gjëmba dhe ferra («Pellgu»). Detyra e shkrimtarit në këto çaste të vështira në jetën e kombit është t'i shërbejë popullit («Ajka e botës»).

Një kapitull mjaft të rëndësishëm në veprimtarinë letrare të S.Spases e përbëjnë tregimet. Ai është marrë dhe merret vazhdimisht me këtë gjini.

Tema kryesore e tregimeve të S.Spases është jeta e rëndë e popullit me halle të shumta e gaze të pakta. Vëmendjen e tij autori e përqëndron në plagët sociale, që e bëjnë të vuajë e të rrijë në vënd shoqërinë shqiptare.

Tregimin «Profiti» mund ta konsiderojmë si kredon e mendimeve që përshkojnë gjithë tregimet e tij. Me anë të figurës së profitit, autori tërthorazi trumbeton ide përparimtare dhe tregon se cilat janë shkaqet sociale që njerëzit vuajnë.

Profiti, sigurisht është një personazh i krijuar, por

alegorik që me fjalën e tij të zjarhtë demaskon hipokrizinë, gënjeshtrenë dhe padrejtësinë e shoqërisë borgjeze.

Tregimi «Babai» mund të quhet një nga krijimet më realiste të S.Spases në vitet e paraluftës. Ai është pothuajse i panjohur nga lexuesit, sepse kur u botua në revistën përparimtare «A. B. C», ai numër u ndalua nga çensura të qarkullonte.

Ngjarja është e thjeshtë, po mjaft prekëse: një fshatar shkon përmes borës dhe furtunës në qytet me gomarin ngarkuar, për të shitur dru e për t'i blerë bukë familjes. Kur e mbaron së lexuari tregimin nuk të bën të mendosh aq odiseja e këtij babai të dhimbsur, që vuan e sakrifikon veten për fëmijët e tij, se sa fati i fëmijëve, të cilëve vërtet «sot po u shuhet uria, po nesër si do t'u bëhet halli?!...». «Babai» është një tablo e gjallë dhe realiste e gjëndjes së fshatarësisë në kohën e Zogut.

Në tregimin «Kujtimet e fundit» autori ka shprehur një ide të guximshme, me gjithë notën sentimentale që gjejmë në të. Nëpërmjet dramës së Agronit ai dënon pabarazinë sociale të kohës, që s'i lë të rinjtë e dashuruar të bashkohen dhe u prish kështu jetën.

Figura e bukur e mësuesit zë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e S.Spases. Duke qenë vetë për vite me radhë mësues, autori çmon misionin e tij. I frymëzuar nga jeta dhe përpjekjet e kolegëve, shkrimtari në tregimin «Mësuesi» vë në kontrast punën e palodhur e plot sakrificë të një mësuesi fshati me trajtimin e keq që i bëjnë atij qeveritarët anadollakë të kohës.

Afër me këtë temë qëndron edhe tregimi «Malësori i vogël». Populli është i etur për dije dhe kjo paraqitet bukur në figurën e Markut, malësorit të vogël, i cili lufton përditë kundër varfërisë, urisë, vështirësive të natyrës dhe vete në shkollë të mësojë. Malësori i vogël na bën të mendojmë për fëmininë e vështirë të autorit.

Në një radhë tregimesh S.Spasse ka prekur plagën e kurbetit, që i bënte te vuanin kushedi sa familje shqiptare në të kaluarën. Varfëria, deziluzioni, malli i zjarritë, frika, pasiguria — ja se ç'i karakterizon personazhet e këtyre tregimeve — të cilët të zgjojnë emocione të hidhura.

Shkrimtari S.Spasse në një sërë veprash është marrë në mënyrë të veçantë me zakonet e këqia të martesës në të kaluarën në vendin tonë. Kjo u duk qartë që në romanin «Pse?!». Me këtë tematikë, ku dënohen zakonet patriarkale si martesë në djep, martesë me para, martesë e të miturve, poligamia, janë shkruar një pjesë e madhe e tregimeve. Nuk do ta tepronim, po të thoshnim se për mendimin tonë tregimi më i mirë i S.Spasse është tregimi «Nusja pa duvak», që trajton një subjekt me këtë temë. Këtu autori me mjete të pasura artistike, me një qëndrim emocional të goditur ngrihet kundër zakoneve anadollake, të sjella në Shqipëri prej pushtuesve turq, zakone këto të huaja për karakterin e popullit tonë. Martesë e Ahmetit me Zenepen, me gruan e vëllait të vdekur, që bëhet për hir të zakonit, sipas përfundimit të autorit, është një zakon barbar, që s'e pranon as morali dhe as natyra njerëzore. Një zakon i tillë vepron në shtëpinë e Ymer Agait, në një familje feudale dhe kjo ia shton më shumë vlerën realiste-edukative tregimit. Tregimi zbulon para lexuesit me forcë shprehëse dramën e thellë të heronjve të tij dhe cinizmin e bartësve të këtyre zakoneve barbare të përfaqësuar nga Ymer Aga dhe hoxha i fshatit. Me pak fjalë, me detaje të zgjedhura, duke ruajtur ngjyrat e ambientit dhe të kohës, shkrimtari realist ka arritur të krijojë personazhe plot jetë që veprojnë të gjallë para lexuesve. S'ka dyshim që ky tregim zë një vend të posaçëm në krijimtarinë e S.Spases të paraluftës.

Tregimet «Nusja», «Shemra», «Te korijeza», «A do ta shoh» kanë ngjashmëri tematike me «Nusen pa duvak»,

rrahin të njëjtin problem, por trajtojnë subjekte të ndryshme në forma të tjera. Në secilën prej tyre duket qartë pozita e shëndoshë e autorit, qëndrimi i tij kritik ndaj këtyre shfaqjeve të jetës së atëhershme.

Në krijimtarinë e paraçlirimit të S.Spases lexuesi do të gjejë edhe tregime si «Fati i Mitit», «Kristina», «Letër nga një e pa njohur» që janë interesante, po që nuk ngrihen në lartësinë ideoartistike të tregimeve të tjerë.

#### 4

Krijimtaria e S.Spases në periudhën që shqyrtoam, ka padyshim merita ideoartistike. Në prozën shqipe të paraluftës, ndryshe nga poezia, traditat qenë të pakta. Autorëve të rinj, që erdhën në vitet '30, iu desh të kapërcejnë jo vetëm vështirësitë që paraqet kjo gjini, por edhe zbrazësitat që kishte lënë e kaluara. Shkrimtari S.Spasse që një nga ata autorë, që kaloi në përgjithësi me sukses nëpër këtë rrugë. Ai i dha letërsisë sonë një numër veprash me dinjitet letrar për kohën e tyre dhe më pas. Qëndrimi negativ ndaj realitetit, kritika e ashpër, notat e protestës shoqërore, që ndihen në veprat e S.Spases e bëjnë autorin të radhitet mes shkrimtarëve përparimtarë. Në shkrimet e tij të paraluftës dallohen dy tipare themelore: humanizmi aktiv dhe fryma demokratike. I dalë nga gjiri i fshatarësisë së shumëvujtur, ai ia kushtoi veprat e tij më të mira jetës, halleve dhe përpjekjeve të popullit të thjeshtë. S.Spasse u bë në prozën tonë këngëtar i vërtetë i fshatit. Ai përshkroi jetën e mjeruar, prapambetjen, virtytet, zakonet, gazet dhe dertet e prindërve, motrave dhe vëllezërve fshatarë.

Është ndoshta kjo lidhje e brendshme e S. Spases me jetën e popullit që shkrimtari gjatë tërë periudhës së tij të parë qëndroi në opozitë me realitetin dhe kërkoi papushim të vërtetën.



Po para çlirimit S.Spasse, me gjithë përpjekjet për të gjetur rrugëdalje nga qorrsoaku i kohës, qëndroi në pozitë të një realisti me ideale pozitive, sado që utopike. Prej këndej rrjedhin dobësitë ideore që vihen re në një pjesë të veprave të tij: notat pesimiste, nihiliste, një farë konfuzioni ideor, mendimet abstrakte dhe filozofimet pa cak. Prej këndej vijnë figurat e errëta apo ekstravagante, tonet e afektuar sentimentale dhe romantike, proleksiteti, varfëria herë-herë e mjeteve artistike etj. Natyrisht, të gjitha këto nuk janë «gjyana» vetëm të tij, po shprehin si të thuash edhe nivelin dhe stadin e prozës sonë të kohës.

Shkrimtari Sterjo Spasse në veprat e tij të paraçlirimit shkoi drejt formimit të fizionomisë së vet artistike. Kjo duket në radhë të parë në përmbajtjen e re që ai solli në letërsi, në pamjet e ndryshme të jetës shqiptare, e veçanërisht të fshatit, që ai zbuloi para lexuesit, në trajtimin e një tog problemesh, për të cilat kemi folur gjerësisht më lart. Nga ana tjetër, profili i S.Spasse shihet dhe në punë të mjeshtërisë artistike. Ai di të tregojë bukur, rrjedhshëm, në mënyrë interesante, duke vënë në pah gjënë kryesore dhe duke e plotësuar atë me fakte e hollësira të dorës së dytë. Personazhet e krijuara nga S.Spasse nuk mund të themi se janë gjithnjë të qëlluar. Në fakt jo tek të gjithë ka arritur të na japë karaktere dhe tipa të caktuar. Ai po shkonte drejt krijimit të karaktereve të vërteta, të tipareve që do të mishëronin artistikisht fenomene të shoqërisë shqiptare. Përpjekje të tilla të mbara, për të individualizuar mund të shihen në disa figura: si ajo e Gjon Zaverit, ose te personazhet e tregimit «Nusja pa duvak», ku individualizmi artistik është i arrirë sa tek asnjë vepër tjetër e tij e periudhës së parë. Zakonisht autori i karakterizon personazhet me anë të situatave dhe veprimeve të ndryshme, mbështetet më shumë në ngjarje, dhe më pak në detalin, në hollësitat e personazheve dhe ambienteve.

Veprat e S.Spases në përgjithësi janë përshkuar nga një notë e këndshme lirizmi. Kjo duket veçanërisht në rrëfimet e heronjve, në përshkrimin e zakoneve të bukura fshatare, në digresionet, në vizatimin e peisazhit. Lirizmi i Spases është i vetvetishëm, pa sforcime dhe me masë.

Në punë të kompozicionit, të ndërtimit dhe të organizimit të materialit brenda veprës, S.Spasse është i aftë. Në këtë drejtim, mund të thoshim se ai shquhet si një nga prozatorët, që di t'i thurë veprat me një kompozicion të drejtë dhe të saktë, në përputhje me brendinë. Te Sterjo Spasse, që në periudhën e parë, vemë re përpjekje për një stil të vetin. Stili i Spases ka veçoritë e tij që e bëjnë të dallohet. Zakonisht proza është me periudha të gjata, e përbërë nga disa fjali kryesore e të dyta. Ai përdor në mënyrë të veçantë dy pikat, pas të cilave vijnë njëra pas tjetrës fjali të ndërvarura nga mendimi kryesor. Stili përgjithësisht është i figurshëm, por jo i krehur. Ndërtimet gjuhësore të Spases nuk janë punuar gjithnjë sa duhet.

Gjuha e Spases është toskërishtja letrare, por e pasuruar tek-tuk nga elementë gegë. Ai ka futur me kriter të drejtë në gjuhën e tij fjalë nga leksiku geg, pa e prishur në të shumtën e rasteve bukurinë dhe natyrshmërinë e frazës.

Këto janë disa nga çështjet ideoartistike, që dalin nga studimi i krijimtarisë së shkrimtarit në periudhën e paraçlirimit. Njohja me veprimtarinë e tij letrare të kësaj periudhe, na ndihmon të kuptojmë drejt zhvillimin e mëtejshëm pozitiv të S.Spases. Sipas mendimit tonë për qafimi shpejt dhe pa hezitime i metodës së realizmit socialist nga ana e shkrimtarit tonë, duhet kërkuar në radhë të parë në këtë të kaluar letrare. Lidhja e ngushtë me popullin dhe humanizmi aktiv, fryma demokratike dhe pakënaqësia

ndaj realitetit feudo-borgjez, e sollën S.Spassen në pozitë e socializmit.

Krijimtaria e begatë e S.Spases në vitet e pushtetit popullor, (romanet, tregimet, publiçistika e tij) dëshmon qartë, se sa shumë ka ecur autori i «Pse-së» në rrugën e pjekurisë artistike dhe të formimit të tij ideologjik.

1961.

## RRUGA E NJË SHKRIMTARI PATRIOT

Jeta dhe veprimtaria letrare e politike e shkrimtarit Haki Stërmilli janë të lidhura ngushtë me përpjekjet e popullit tonë për një Shqipëri të lirë e të përparuar, me ngjarjet më të rëndësishme të historisë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit të njëzetë. Akoma shumë i ri, Haki Stërmilli dha kontributin e tij modest në përpjekjet e fundit të rilindasve tanë për çlirimin e mbrojtjen e atdheut. Në lëvizjen demokratike të viteve 20, ai u bë një nga udhëheqësit e rinisë sonë përparimtare. Për disa vjet me radhë revolucionari i ri bëri jetën e emigrantit politik. Më vonë, ai u burgos dhe u persekutua nga regjimi i Zogut, duke kaluar kështu momente shumë të vështira, të cilat mundi t'i kapërcejë me ngjarjet që erdhën më pas. Lufta Nacionalçlirimtare i përtëriu dhe i çoi më tej idealet demokratike të Haki Stërmillit, ajo i hapi shkrimtarit tonë horizonte të reja veprimi dhe mendimi. Haki Stërmilli mori pjesë në epopenë e madhe të çlirimit që udhëhiqej nga Partia Komuniste Shqiptare dhe e arriti ta gëzojë Shqipërinë e lirë e ta shohë popullin zot të fateve të veta, ashtu siç kishte ëndërruar e luftuar për vite me radhë.

Rruga e jetës e Haki Stërmillit është rruga e një luftëtari të popullit, e një shkrimtari patriot e demokrat, ndërsa vepra e tij një pasqyrë e disa prej momenteve

sa dramatike aq dhe heroike të historisë e të jetës shqiptare.

## I

Haki Stërmilli lindi në 7 maj 1895 në Dibër të Madhe, në një familje patriote qytetare. Fëminia e tij kaloi nëpër rrugicat dhe oborret e ngushta të lagjes Dormohalle, lagjes më të varfër të Dibrës së Madhe. Në këtë qytet shqiptar, ai kreu shkollën fillore në një ruzhdie turke, po në të njëjtën kohë, këtu atij iu ndez së pari zjarri i dashurisë për Shqipërinë dhe gjuhën shqipe. Akoma fëmijë, Haki Stërmilli mësoi nga rilindasit vendas, nga Azis Menzelxhiu e të tjerë alfabetin e gjuhës amtare dhe u dha që atëherë me shpirt pas çështjes së madhe të çlirimit të atdheut. Ai jetoi atmosferën e përpjekjeve të fundit që bënte populli ynë për të shkundur zgjedhën e huaj dhe për të ruajtur njësinë e tij etnike nga fqinjët shovenë. Patriotët e shquar dibranë, si Hoxhë Vokrri, vllëzërit Strazimiri dhe veçanërisht i paharruari patriot Dervish Hima, me shembullin e tyre, kush nga afër e kush nga larg qenë mësuesit e parë të shqiptarizms për djaloshin e ri. Me ndihmën dhe përkrahjen e Dervish Himës, që ishte edhe mik i familjes së Stërmillasve, Hakiu, pasi mbaroi ruzhdien, ndoqi më tej shkollën në Selanik dhe kreu pastaj gjimnazin turk të Manastirit. Manastiri aso kohe, siç dihet, ishte një nga vatrat e lëvizjes sonë kombëtare. Pikërisht këtu patriotët shqiptarë, me në krye atdhetarin e njohur Bajo Topulli, kishin krijuar Komitetin e fshehtë të kryengritjes. Në Manastir kishte zhvilluar punimet e veta kongresi i alfabetit shqip. Këto dy ngjarje kishin bërë jehonë në jetën e rinisë shqiptare që mësonte në këtë qytet. Haki Stërmilli, i ushqyer që për së vogli me idetë e shqiptariz-

mit, në Manastir formohet si patriot dhe militon në lëvizjen kombëtare, duke kontribuar në çeljen e shkollave shqipe, në përhapjen e alfabetit dhe të librave në gjuhën amtare në krahinën e Dibrës.

Pas shpalljes së pamvarësisë, Dibra sikur të mos mjaftonin shekujt e robërisë turke, bie pre e një zgjedhe të dytë. Shovinistët serbë duke marrë nëpër këmbë të drejtat më elementare të vëllezërve tanë të këtyre viseve u sulën me tërbim mbi ta, i masakruan dhe i grabitën, e mbi të gjitha i pushtuan këto toka brez pas brezi shqiptare. Haki Stërmilli 18 vjeçar që dëshmitar i këtij ezodi tragjik dhe ashtu si mijëra dibranë, së bashku me familjen e tij, ai u detyrua të shpërngulet nga vendlindja dhe me vargun e pafund të muhaxhirëve, mori rrugën për në Shqipëri. Në fillim në Elbasan dhe pastaj në Durrës djalosli që sapo kishte kryer gjimnazin, punon si nëpunës i administratës së re shqiptare. Në vitin 1918 atë e shohim me punë në Mat, ndërsa pas Kongresit të Lushnjës, vëndoset në Tiranë, me detyrë si sekretar i parë të Ministrisë së punëve të Brendshme. Haki Stërmilli, i ndërgjegjshëm që puna e tij t'i shërbente interesave të vërteta të shtetit të ri shqiptar, e shfrytëzoi pozitën e rëndësishme në dobi të elementëve përparimtarë. Ai ishte ushqyer me idetë e Rilindjes Kombëtare dhe militonte në radhët e rinisë së përparuar të kohës, prandaj nuk kishte si të pajtohej me politikën e intrigave dhe kompleteve, me mjetet makiaveliste që përdorte Ahmet Zogu për të marë pushtetin e për të ruajtur rendin feudal në Shqipëri. Ai e kuptoi se Zogu donte të vihej në krye të shtetit të ri shqiptar, i prirë jo nga qëllime patriotike, po nga interesat e ngushta klasore, në aleancë me gjithë reaksionin e vendit. Egziston në Arkivin e shtetit një letër mjaft demaskuese që Haki Stërmilli i ka drejtuar Zogut, kur ky i fundit, për sa thamë më lart, e hoqi nga dikasteri që drejtonte dhe e la

për disa kohë pa punë. Kulmi i acarimit të marrëdhënieve të tyre arriti atëherë, kur pas atentatit që i bënë Zogut në parlament, Haki Stërmilli deklaroi botërisht: «Më erdhi keq që nuk e vranë».

Në këtë kohë në Shqipëri zhvillohej një luftë e madhe politike në mes forcave përparimtare dhe atyre reaksionare. Ishte çështja e vendosjes së formës së regjimit, çështja e fatit të mëtejshëm të shoqërisë sonë. Haki Stërmilli u radhit menjëherë me ato forca që luftonin kundër feudalëve dhe imperializmit. Ai u bë një nga përfaqësuesit e shquar të rinisë demokratike të kohës. Në fillim, si kryetar i shoqërisë «Djelmënia dibrane» dhe pastaj si anëtar aktiv i shoqërisë «Bashkimi», i propozuar nga vetë Avni Rustemi, i cili e çmonte karakterin dhe guximin e të riut dibran, Haki Stërmilli luftoi me të gjitha forcat për një Shqipëri demokratike, të pavarur e të përparuar, pa bejlerë e pa Zog, të lirë nga kthetrat e fuqive imperialiste e të fqinjëve shovenë. Këtë qëndrim të vendosur, i riu demokrat e tregoi veçanërisht në ngjarjet e Revolucionit të Qershorit të vitit 1924, kur me armë në dorë luftoi për ardhjen në fuqi të një qeverie demokratike, siç qe ajo e Fan S. Nolit. Me vdekjen e Avni Rustemit, Haki Stërmilli, ishte vënë në krye të shoqërisë «Bashkimi», duke u zgjedhur si sekretar i saj i përgjithshëm. Tani ai bëhet një figurë e njohur e rinisë përparimtare shqiptare që lufton për të realizuar idealet e udhëheqësit të saj Avni Rustemit.

Po veprimtaria e tij si drejtues i shoqërisë «Bashkimi» nuk vazhdoi gjatë. Me triumfin e «Legalitetit», në dhjetor të vitit 1924, Haki Stërmilli, si mjaft patriotë e demokratë, u detyrua të emigronte larg atdheut. Në fillim në Itali dhe pastaj në Francë, ai bëri jetën e vështirë të emigrantit politik, duke punuar nëpër fabrika si punëtor i thjeshtë. Më vonë, me detyra të caktuara, ai u end, nga një

vënd në tjetrin. Për afro një vit ai jetoi në Bashkimin Sovjetik, i dërguar atje me një grup të rinjsh shqiptarë nga Konareja. Qëndrimi në Bashkimin Sovjetik i vlejti Haki Stërmillit, nga një anë për t'u njohur për së afërmi me jetën e të parit vend të lirë të punëtorëve e të fshatareëve, me idetë e komunizmit dhe, nga ana tjetër, për t'u miqësuar me figura të shquara të lëvizjes komuniste shqiptare, si me Ali Kelmendin, Halim Xhelon, Naum Priftin, etj. Pas një viti, ai u kthye në Vienë, po atje u burgos, u persekutua dhe më në fund u dëbua nga Austria. Në këto rrethana, ai shkon në Jugosllavi.

Është viti 1929 dhe Zogu në vazhdim të pazarllëqeve që bënte me shovinistët jugosllavë kërkon prej tyre dorëzimin e emigrantit Haki Stërmilli. Autoritetet jugosllave ia dorëzuan atë Zogut, duke e shkëmbyer me dy emigrantë politikë jugosllavë që ishin futur aso kohe në vendin tonë. Ky akt i qeverisë jugosllave dhe, për më tepër, procesi që ngriti Zogu për të gjykuar Haki Stërmillin, bënë që në Evropë të organizohet një fushatë proteste, nga antifashistët e vendeve të ndryshme për lirimin e Haki Stërmillit nga burgu. Me anë letrash dhe telegramesh, opiniononi përparimtar europian, në mes tyre, edhe personalitete të tilla si Gj.Dimitrovi, shkrimtari H.Barbys dhe shkencëtari A.Ajshtajni protestuan për dorëzimin nga qeveria jugosllave të Haki Stërmillit dhe kërkuan pezullimin e gjyqit organizuar kundër tij. Megjithëkëtë valë protestash, sulltani i Tiranës, siç e quanin Zogun atëherë, e bëri veshin shurdhër dhe nuk e liroi Haki Stërmillin, po fakti që gjyqi i tij e dënoi atë vetëm me pesë vjet burgim, shpjegohet padyshim edhe me ndërhyrjen e opinionit publik ndërkombëtar.

Koha e qëndrimit në burg për Haki Stërmillin ka qenë një periudhë e vështirë, periudha më e rëndë në jetën e tij politike. I lodhur pas ravgimesh të gjata, i paformuar



plotësisht nga pikëpamja politike, me një botëkuptim akoma të pa përcaktuar mirë, i izoluar nga lëvizja demokratike që vepronte në Shqipëri dhe jashtë, Haki Stërmilli, kaloi në burg disa momente hutimi dhe pendimi, duke u pajtuar dashur padashur me gjëndjen e krijuar aso kohe në Shqipëri. Po megjithatë, duhet vënë në dukje se ky «dorëzim i përkohshëm», nuk i solli Haki Stërmillit asnjë dobi. Zogu nuk i fali asnjë ditë nga afati i burgimit, bile e burgosi rishtaz me ngjarjet e lëvizjes së Fierit, dhe kur u lirua nga burgu, ai vuajti për bukën e gojës, duke punuar si magazinier në një shoqëri tregtare private.

Në këtë gjendje të vështirë e gjeti shkrimtarin pushimi fashist. Për fashizmin, Haki Stërmilli kishte një urrejtje të hershme dhe rrezikun e kësaj mortaje ai e kishte parashikuar disa vjet më parë në një artikull, botuar në gazetën «Liria kombëtare». Zgjedha fashiste që ra mbi popullin tonë e vuri në lëvizje patriotin dhe antifashistin e vjetër. Për Haki Stërmillin, si për gjithë atdhetarët e vërtetë, kishte ardhur koha e luftës, populli nuk mund ta duronte çizmen e huaj: ai i bënte rezistencë fashizmit në forma të ndryshme. Krijimi i P.K.SH. e shndërroi qëndresën e popullit shqiptar në një luftë të organizuar, i dha asaj një perspektivë të qartë historike dhe kjo e bëri shkrimtarin patriot të hidhet në luftë pa rezerva. Qysh nga viti 1942, ai lidhet me Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe një vit më vonë, kalon në ilegalitet. Në fillim në qytet dhe pastaj, duke luftuar në radhët partizane, Haki Stërmilli punon pa u lodhur për organizimin e këshillave Nacionalçlirimtare, për afrimin e intelektualëve me Frontin Nacionalçlirimtar, për propagandimin e ideve të ndritura të luftës sonë. Prandaj në Konferencën historike të Labi-notit, ai zgjidhet dhe anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Megjithëse në një moshë pak a shumë të kaluar, i vrrarë nga jeta dhe persekutimet, me shëndet

të dobët, Haki Stërmilli u bëri ballë vështirësive të luftës, nuk u shkëput asnjëherë prej saj, po përkundrazi u gjend në mes rreziqesh sa herë që e desh interesi i popullit. Shkrimtari partizan mori pjesë nëpër beteja, marshoi i uritur e i zbatuar tok me partizanët, punoi në zona të vështira, kaloi me privacione të mëdha operacionin e dimrit, duke pasur, siç tregojnë ata që jetuan në këto çaste bashkë me të, një besim të patundur te P.K.SH., tek idealet e mëdha të luftës. Për këtë dëshmon edhe ditari i tij voluminoz që ka mbajtur n'ato vite, dëshmojnë shumë kujtime të shokëve.

Po edhe pse në kushte të vështira, Haki Stërmilli e vijonte punën e vet si shkrimtar. Sot, kur shfleton në Arkivin e Shtetit dorëshkrimet e tij të luftës, nuk mund të mos habitesh dhe në të njëjtën kohë të mos prekesh. Janë qindra e qindra faqe të mbajtura nga shkrimtari partizan në rrethana të ndryshme, të shkruara në Tiranë e Dibër, në Martanesh e në Skrapar, nëpër vatrat fshatare, apo rrëzë pyjeve; herë të shënuara sipër gjurit, herë mbi ndonjë sofër a stol të thjeshtë, po gjithnjë me automatikun pranë e çantën partizane, ku rrinin trazuar dorëshkrimet bashkë me fishekët. Duke studjuar dorëshkrimet e tij të luftës kuptojmë se ai ka punuar me një vullnet dhe ritëm pune të jashtëzakonshëm. Mjafton për këtë të përmendim romanin «Hafsh dhe hov zemrash», vepër me subjekt nga Lufta Nacionalçlirimtare shkruar prej autorit për afro një muaj, gjatë kohës së vështirë të operacionit të dimrit. E jo vetëm kaq, po në të njëjtën kohë, ai shkruante edhe ditarin, thurte subjekte për vepra të reja dramati-tike, etj.

Në Kongresin historik të Përmetit, Haki Stërmilli, për kontributin e tij të çmuar në luftë, zgjidhet përsëri anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Me këtë ngjarje që ligjëroi botërisht pushtetin e lindur nga gryka e

pushkës dhe me ngjarjet që erdhën më vonë, shkrimtari patriot Haki Stërmilli arriti të shohë me sytë e tij realizimin e ëndrrave shekullore të popullit shqiptar, kurorëzimin e idealeve të tij të vjetra e të reja, për të cilat ai kishte luftuar për më shumë se një çerek shekulli. Fatet e Shqipërisë tani ishin siguruar njëherë e përgjithmonë dhe me këtë bindje të patundur, ai mbyll faqen e fundit të ditarit, më 30 nëntor 1944, një ditë pas çlirimit të plotë të atdheut:

*«Tash po e mbyll këtë ditar me besim të formuem gjatë luftës. Ka në botë forca që mundin me e shue fare këtë popull, po s'ka asnji fuqi që të mundet me e përkul dhe me e robnue...»*

Në vitet e para të çlirimit Haki Stërmillin e shohim në qytetin e Peshkopisë si kryetar i Frontit Demokratik dhe N/Kryetar i Komitetit Ekzekutiv për qarkun e Dibrës. Ata që punuan me të në këtë kohë, rrëfejnë se me ç'entuziazëm dhe vendosmëri luftonte patrioti i flakët për ndërtimin e jetës së re. Ai e dinte shumë mirë se sa e egër kishte qenë shtypja e popullit nga bajraktarët dhe bejlerët në krahinën e Dibrës, se sa varfëri dhe injorancë kishte lënë në këto vise e kaluara e zezë. Prandaj zemra e tij gufonte nga gëzimi kur shihte popullin nën udhëheqjen e komunistëve të rrafshonte kullat e bajraktarëve, të ndante tokat fshatarëve, të hapte shkolla e dërgonte bijtë e vet për studime, të luftonte fanatizmin e zakonet e këqija e të ngrinte kudo jetën e re. Vetë Haki Stërmilli propozoi atëherë që të rrafshohet burgu i qytetit, simboli i fundit i pushtetit të vjetër dhe me materialet e tij të ndërtohej një kinoteatër për popullin. Dhe ashtu u bë vërtetë: kinoteatri u ngrit simbas idesë së shkrimtarit.

Populli i krahinës së Dibrës që e kishte njohur Haki

Stërmillin në çaste të vështira të historisë së tij e zgjodhi atë për dy herë me radhë përfaqësues në Kuvendin Popullor. Këtë besim dhe detyrë të lartë ai e meritoi plotësisht. Në vitet e pasçlirimit ai punoi si drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe më pas, si drejtor i Muzeumit të luftës Nacionalçlirimtare.

Për afro dhjetë vjetë që jetoi në Shqipërinë e lirë, Haki Stërmilli nuk rreshti së krijuari, ai shkruante vepra të reja, ripunonte të vjetrat, mbledhte folklorin dhe pasurinë gjuhësore të krahinës së Dibrës, merrej me publiçistikë. Ai bënte një punë të ndërgjegjshme prej shkrimtari dhe kishte besim se edhe pas shndërrimeve të mëdha që kishin ndodhur në Shqipëri do të krijonte vepra të denja për letërsinë shqipe. Po shëndeti i dobët nuk e la t'i përmbushte këto plane krijuese. Për një kohë të gjatë, ai lëngoi nga një sëmundje e rëndë. E megjithëse i sëmurë, disa kohë para se të vdiste, i pushtuar si gjithnjë nga një entuziazëm rinor, shkrimtari patriot ishte i pranishëm në Kongresin e II-të të P.P.SH. dhe dëgjoi raportin e shokut Enver Hoxha.

Më 17 janar 1953, Haki Stërmilli vdiq në moshën 58 vjeçare. Prof. Dhimitër Shuteriqi, duke shprehur dhimbjen e shkrimtarëve dhe të popullit tonë për këtë humbje do të shkruante:

«Haki Stërmilli vdiq në moshën kur njeriu mund të prodhojë shumë e shumë. Sëmundja na e rrëmbeu në vllugun e punës. Po vepra e tij do t'ia ruajë kujtimin në zemrat tona. Letërsia shqipe do të bëjë shumë përpara, po kurdoherë do të kujtohen ata që talentin e vunë në shërbim të popullit e ata që u përpoqën të ecin me një besim të një të ardhme të lumtur. Populli që e desh dhe e çmoi, duke e zgjedhur dy herë me radhë si përfaqësues të tij do t'ia ruajë me dashuri kujtimin gjatë brezave.»

## II

Shkrimtari Haki Stërmilli ka lënë një trashëgim të pasur letrar. Atij i takojnë një numër i konsiderueshëm veprash të botuara dhe të pabotuara. Për afro tridhjetë vjetë, ai krijoi me zell e pasion të madh për letërsinë shqipe. Që nga viti 1923, kur nisi të shkruajë tregimet dhe dramet e para e deri më 1953, shkrimtari nuk u nda asnjëherë nga letërsia. Ai shkroi tregime, drama, romane, mbajti ditare, bëri studime, mblodhi folklor, përktheu, u mor me publicistikë. Vepra e tij e botuar dhe në dorëshkrim arrin në disa mijëra faqe.

Shkrimtari Haki Stërmilli lavroi dy nga gjinitë më të vështira dhe të mbetura pas aso kohe të letërsisë shqipe: prozën e gjatë dhe dramën. Veprimtaria e tij letrare nisi me tregime, të cilat i shohim të botuara në shtypin e viteve '20. Të bie në sy fakti që ai e nis rrugën e letërsisë me tregime që trajtojnë subjekte patriotike, ku përshkruhen ngjarje e personazhe që kanë të bëjnë me terrorin dhe persekutimet e dibranëve nga shovinistët serbë e që vënë në dukje qëndresën e patriotëve, ndërgjegjen e tyre të lartë kombëtare, krenarinë dhe trimërinë e bashkatdhetarëve. Qysh nga kjo kohë, Haki Stërmilli do ta lidhë pjesën më të madhe të veprës së tij shumëvjeçare me Dibërën, me historinë dhe jetën e dibranëve, me psikologjinë dhe zakonet e tyre. Këtë tematikë trajtojnë tregimet e para të Stërmillit: «Andërr e trishtueshme», «Tinzitë e gozhdës», «Gati, gjithmonë gati», «Trimnia e grues shqiptare», etj.

Këto tregime, që janë sprovat e para të shkrimtarit, sado që lënë për të dëshëruar në përgjithësi nga pikëpamja artistike, prapë dëshmojnë me anët e tyre më të mira për talentin e autorit të ri.

Po veprat që e bënë të njohur në hapat fillestare shkrimtarin e ri ishin dramet «Dibrania e mjerueme»

(1923), «Dashuni dhe besniki» (1923) dhe «Agimi i lum-nueshëm» (1924), të cilat u botuan dhe u shfaqën në vi-tet '20. Të trija këto vepra kanë në themel të tyre temën patriotike. Të ndërtuara mbi episode të vërteta të kohës, disa herë me personazhe realë, marrë nga ngjarjet drama-tike të Dibrës, këto vepra demaskojnë armiqtë e Shqipërisë, synimet e tyre grabitqare ndaj tokave tona, forcojnë ndër-gjegjen kombëtare, duke lartësuar figura luftëtarësh e du-ke evokuar ngjarje heroike nga lufta e dibranëve për mbrojtjen e tokave amtare. Dramat e para, edhe pse kanë mjaft dobësi artistike, ndjekin vazhden e letërsisë së Ri-lindjes dhe në kohën kur dolën vlejten për edukimin e popullit me frymën e atdhedashurisë.

Në periudhën e emigracionit Haki Stërmilli nuk di-më të jetë marrë me krijimtari letrare, por ai ka zhvilluar një veprimtari të rëndësishme publicistike, duke bashkë-punuar me shtypin shqiptar jashtë, dhe në mënyrë të veçantë me gazetën «Liria kombëtare», organ i Konaresë. Në këtë gazetë ai ka shtypur artikujt «Një propozim», «Kriza ekonomike dhe penetracioni italian në Shqipëri» dhe «Mbi varr të një martiri», po nga procesverbali i gjy-qit, organizuar kundër tij, më 1929, marrim vesh se ai ka shkruar edhe artikuj të tjerë si «Malli për atdhe», «Kodi civil dhe poligamia», të cilët nuk na kanë rënë në dorë. Tre artikujt e parë, të botuar në «Liria kombëtare», të nënshkruar njëri me emër e dy me pseudonime, shquhen për frymën e tyre luftarake, për ndjenjat antif feudale dhe antiimperialiste, për urrejtjen e autorit ndaj Zogut dhe kli-kës së tij. Në artikullin «Një propozim» Haki Stërmilli demaskon me forcë të madhe rendin feudal, si një rend shoqëror i dënuar nga historia që të vdesë dhe u propozon shokëve të emigracionit që të gjithë së bashku të shkruajnë një libër, ku të përshkruhen mizoritë dhe antipatriotizmi i feudalëve shqiptarë. «Ky libër, — thotë ai, — mund të

shkruhet prej një grupi kolektivisht, prej shokëve që kanë dijeni mbi rrjedhjen e familjes e mbi jetën e tyre private e politike». Dhe meqë shokët janë të shpërndarë në vende të ndryshme, ai kërkon prej tyre të shkruajnë në fillim artikuj nëpër gazeta dhe pastaj të mblidhen në një libër, që t'i lihet si kujtim brezit të ri. Kështu, propozon që Halim Xheloja të shkruajë për bejlerët e Vlorës, Riza Cerova për ata të Beratit, Naum Prifti për bejlerët e Fierit, dhe ai vetë për kryetarin e kastës feudale, Ahmet Zogun.

Artikulli mbyllet me këto fjalë:

«Feudalët e Shqipërisë kanë ba deri më sot çdo të ligë që nuk e përfshin as logjika dhe kanë shkak-tue mjerimin dhe robnimin e popullit. Vepra e tyre ka qenë rrënuese dhe barbare. Prandaj historinë e popullit s'mund ta bajnë feudalët. Po të mbetet pu-na në dorë të Çekrezit ose të Pekmezit, në ndërgjegjen e Faik bej Konicës ose të Ferit bej Vokopolës, që thonë se merren me historinë e një kombi që e urrejnë, mjerë populli dhe Shqipëria e shkretë!»

Mjaft i fortë është edhe artikulli «Kriza ekonomike dhe penetracioni italian në Shqipëri», botuar në «Liria kombëtare», 10 maj 1928, disa muaj para se autori të arres-tohej. Duke folur për krizën ekonomike që ka tronditur vendet kapitaliste, Haki Stërmilli vë re se kjo krizë është bërë më e rëndë në popullin e varfër shqiptar. Në mes të tjerash, ai shkruan:

«Lëndët e para i marrin italianët; buka, vaji, shiten shumë shtrenjtë. Mbyllen dyqanet dhe tezgjahet nga shka-ku i krizës. Kjo është një periudhë e mynxyrshme. Zogu u jep toka italianëve për 99 vjet. Shqipëria është mbushur me spiunë italianë. Vendi po bie në thonjtë e fashistëve.» Ndërsa më poshtë, ai sikur profetizon me këto fjalë:

«Fashistët që nuk paskan marrë mësim nga dajaku i Luftës së Vlorës, le ta bajnë këtë provë të idhët, po duhet

ta dijnë se do t'u kushtojë shtrenjtë, bile shumë shtrenjtë se jo vetëm që do të humbasin kapitalet që kanë derdhë në Shqipëri, po dhe jeta do t'u mbarojë aty në mënyrë tragjike. Pra, në iu pëlqen, le të mos hjekin dorë nga Shqipëria...» Ky parashikim është bërë më 1928, afro 15 vjet përpara disfatës së turpshme të fashizmit në Shqipëri.

Për urrejtjen e thellë të autorit ndaj feudalizmit dëshmon dhe artikulli «Mbi varr të një martiri», në të cilin pasi dënohet akti i vrasjes nga Zogu i Ibrahim Harapit, ish-kryetar i Degës së «Bashkimit», thuhet: «Sikurse xhelati ka për profesion të satërojë, ashtu dhe regjimi feudal i tradhtarëve ka për mjeshtëri të vrasë, të presë, të mbysi, të torturojë. S'flasim ne, po faktet. Nuk themi ne nga vetja, po dëshmojnë vetë vorret e martirëve që janë rresh-tue e grumbullue prej Dragobisë e deri në Kakavijë dhe qysh prej buzës së Adriatikut e deri në rranzë të Korra-bit».

Në vitin 1935, Haki Stërmilli boton veprën në formë ditari, «Burgu», në të cilën na përshkruan me hollësi jetën e vështirë, që ka kaluar në burgun e Tiranës, si i burgosur politik. Ngjarjet nisin në muajin mars të vitit 1929, kur autori u arrestua në Manastir dhe mbyllen më 1935, kur ai lirohet. Para nesh kalon jeta plot peripeci e autorit; mësojmë mendimet e tij gjatë kësaj periudhe të rëndë, njihemi me jetën e errët të burgut zogist, me tipa e ngjarje të ndryshme. Autori na përshkruan me hollësi, si gjendjen e vet shpirtërore, ashtu edhe ambientin që e rrethon. Pavarësisht nga dobësitë dhe momentet kontradiktore që paraqet kjo vepër, për të cilat do të flasim më poshtë, «Burgu», në një mënyrë apo në një tjetër, padit regjimin e asaj kohë, demaskon pa mëshirë bejlerët dhe pushtetin feudo-borgjez, flet me urrejtje për politikën ndërhyrëse të imperializmit italian në Shqipëri, për synimet grabitqare dhe prapaskenat e shovinistëve jugosllavë kundër vendit tonë.



Me pasionin e vjetër të «bashkimaxhiut», Haki Stër-milli në shumë faqe të kësaj vepre godet bejlerët, i quan ata antipatriotë dhe parazitë. Sarkazmën e tij therëse e drejton kundra tyre, kur na përshkruan këtë skenë:

*«Sot erdh një bej që të vizitojë një bej të burgosun për vjedhje. Të dy bejlerët u përshëndetën italisht dhe vazhduan të kuvendojnë në gjuhën e fqinjëve tonë të Veriut. Njena palë italishten dhe tjetra serbishten e flitshin si t'ishin të rracës. Në këtë mes mungonte një pendë që të ligjëronte turqisht dhe një tjetër greqisht se atëherë do të kompletohesh kuadroja»:*

Në faqet e «Burgut» gjejmë mendime të guximshme me anën e të cilëve autori shprehet kundër politikës ndërhyrëse të fashistëve në shqipëri, kundër konçensioneve e privilegjeve që i bëhen imperializmit italian, të cilat, siç thotë autori, kanë për qëllim «të na robnojnë ekonomikisht dhe politikisht».

Është interesante të vihet në dukje se që në këtë vepër shohim shqetësimin e vazhdueshëm për pozitën dhe fatin e gruas shqiptare. Jo një herë, po disa herë do të gjejmë te «Burgu» raste ku autori na përshkruan përmes ngjarjesh konkrete padrejtësitë, që luhen në kurriz të gruas së shtypur e të robëruar. Ka të ngjarë që ideja, bile dhe subjekti i romanit «Sikur t'isha djalë», që u botua fill pas një viti që shkrimtari doli nga burgu, t'i jetë sugjeruar autorit në burg, nga kontakti i përditshëm me ngjarje dhe njerëz të ndryshëm.

Një meritë e shkrimtarit në këtë vepër është riprodhimi i atmosferës së burgut, përshkrimi me saktësi dhe në mënyrë shprehëse i ambientit ku ai jetoi për pesë vjet me radhë. Duke lexuar ditarin e ndien dhe e kupton qartë se në burgun zogist zotëronte dhuna dhe injoranca, shtypja dhe mjerimi... Sado që kemi të bëjmë me një kronikë të jetës brenda mureve të burgut, autori arrin të na skicojë

tipa të ndryshëm të burgosurish e të kapë momente psikologjike interesante. Nuk është e rastit që komunistët dhe antizogistët e burgosur, përshkruhen me simpati të hapur. Nga ana tjetër, të tërheqin vëmendjen edhe paraqitja e të burgosurve të tjerë, e kriminelëve ordinerë, veprimet e të cilëve shikohen të kushtëzuara nga rrethanat politike e shoqërore të kohës.

Nga «Burgu» marrim vesh se Haki Stërmilli, me gjithë konditat e vështira vazhdon të krijojë. Kështu aty, ai shkruan dramën «Tana», përkthen nga turqishtja romanin «Gjarpëni i dashunisë» të Musin Serezit, punon një fjalor, mbledh folklor, etj.

Vepra «Burgu», siç e thamë edhe më lart, është një vepër kontradiktore dhe komplekse në krijimtarinë e shkrimtarit tonë. Krahas mendimeve dhe konstatimeve të guximëshme që paraqet, ai pasqyron gjithashtu mjaft lëkundje, çaste tronditjeje dhe disa herë pajtim të plotë të shkrimtarit me gjendjen e krijuar aso kohe në Shqipëri. I shkëputur nga lëvizja revolucionare e demokratike e kohës, i topitur nga jeta e rëndë e burgut, duke qenë i papregatitur ideologjikisht dhe politikisht, ai e ndien veten të vetmuar dhe të dobët për t'i bërë ballë presioneve të momentit, vuajtjeve dhe vështirësive, që i krijonin ata, kundër të cilëve ai kishte luftuar dikur nga barrikada të kundërta. Në disa nga faqet e «Burgut», ne vëmë re me keqardhje se shkrimtari humbet perspektivën, pendohet për të kaluarën dhe kapitullon. Kjo rënie e autorit bie në kundërshtim jo vetëm me idealet për të cilat ai kishte luftuar vite me radhë, po ç'është më e keqja bie në kontradiktë edhe me vetë frymën e përgjithshme të librit, me urrejtjen që ai shpreh aty kundër bejlerëve dhe imperialistëve italianë, me simpatinë që tregon ndaj kundërshtarëve të regjimit. Prandaj ky qëndrim na duket se duhet konsideruar më shumë si një lodhje dhe hutim i çastit, që

nuk arrin t'i mposhtë bindjet e tij. Në thellësi ai mbetet antifeudal dhe antifashist, ai është për një Shqipëri pa bejlerë e pa të shtypur. Këtë gjë e vërtetoi shumë mirë qendrimi i tij i mëvonshëm, pjesëmarrja aktive në Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Një vit pasi del nga burgu, më 1936, Haki Stërmilli boton romanin «Sikur t'isha djalë», i cili, siç dihet, bëri mjaft bujë dhe i dha emër shkrimtarit. Tërthorazi vepra e re ishte një shprehje e qartë e qëndrimit mospajtues dhe kritik ndaj gjendjes së kohës, ndaj ligjeve dhe normave morale që sundonin në jetën tonë të atëhershme e që i kishin rrënjët në vetë sistemin feudo-borgjez.

Dalja e kësaj vepre nuk qe një fenomen i veçuar dhe i rastit. Romani u botua në një kohë, kur në vendin tonë vepronte lëvizja demokratike dhe grupet komuniste, kur në letërsinë shqipe me debutimin e një plejade letrarësh të talentuar, të prirë nga Migjeni, po forcohej drejtimi realist. Në këtë kohë aktivizohet shtypi përparimtar, veçanërisht me daljen e organeve «Bota e Re» dhe «A.B.C.», që u bënë tribunë e mendimit të shëndoshë dhe të letërsisë demokratike. Po në mënyrë të veçantë, romani «Sikur t'isha djalë» i Haki Stërmillit është i lidhur ngushtë me lëvizjen e fuqishme që u ngrit në shoqërinë shqiptare në mbrojtje të gruas. Opinioni ynë përparimtar aso kohe e quante çështjen e pozitës së gruas në shoqëri si një problem të madh social dhe kjo kishte arsyet e veta. Lufta për emancipimin e gruas ishte një nga trajtat e luftës politike që bënin elementët progresistë kundër rendit në fuqi. Të luftoje atëherë për çlirimin e gruas, për të drejtat e saj do të thoshte të ngriheshe kundër koncepteve konservatore dhe dogmave anadollake, bartëse të së cilave ishin klasat sunduese, ishte kleri dhe shtresat e tjera regresive të shoqërisë, do të thoshte tërthorazi të bije ndesh me opinionin zyrtar, që i mbronte këto me

ligje, kanune e zakone. E pra, në luftë kundër kësaj një-mëndësi, në mbrojtje të gruas, u ngritën shumë elementë progresistë, gazetarë, gra intelektuale. Nëpër faqet e shtypit përparimtar u rrah me forcë e me guxim gjendja e gruas shqiptare. Shkrimtarët Nonda Bulka e Sterjo Spasse, Andrea Varfi e Kristaq Cepa, publicistë si Ollga Plumbi, Selim Shpuza, Mila Gjokoreci, dënuan në shkrimet e tyre skllavërinë e gruas, kërkuan heqjen e çarçafit e të kafazit anadollak, ngritën zërin që t'i jepen asaj të drejtat si pjesëtare e barabartë e shoqërisë. Po meqenëse në vitet '30 nuk ishin akoma kushtet sociale për një pavarësi ekonomike të gruas, pa të cilën as që mund të flitet për një emancipim të plotë të saj, njerëzit përparimtarë kërkonin në konditat e atëhershme, sidomos për femrën myslimane, të fitoheshin disa të drejta, si heqja e çarçafit, e drejta për arsim të plotë, dënimi i martesave me para, prostitucioni, poligamia, etj.

Këto probleme gjetën pasqyrimin e vet edhe në lehtërsinë e kohës. Dihen novelat e vjershat e Migjenit të shkruara me këtë temë, tregimet e S. Spasses, skicat e N. Bulkës, etj. Po vepra që e pasqyroi më gjerë dhe që i bëri më shumë jehonë problemit të emancipimit të gruas që, pa dyshim, romani «Sikur t'isha djalë». Autori i ynë i mirënjohur, u bë zëdhënës besnik i kërkesave që paraqiste lëvizja shoqërore për mbrojtjen e gruas; ai me romanin e tij i bëri rezonancë zërit të mekur të vajzës shqiptare që vuante prapa kafazit, e shtypur nga zakonet dhe ligjet fanatike. H. Stërmilli kërkonte me të madhe lirinë e personalitetit të gruas.

Shkrimtarin gjithnjë e kishte tërhequr figura e femrës shqiptare. Qysh në tregimet dhe dramat e tij të para do ta gjejmë vajzën shqiptare, si luftëtare në luftërat për çlirim dhe mbrojtjen e atdheut. Në veprën e re, H. Stërmilli nuk merret me aspektin patriotik të jetës së gruas, po me

atë social; ai na tregon për pozitën e saj në kushtet e sundimit të feudoborgjezisë, kur atdheu është çliruar nga të huajt, po që femra vuan akoma nën prangat e fanatizmit. Fanatizma, sipas shkrimtarit ishte një nga *hallkat e skllavërisë njerëzore* dhe kjo duhej luftuar deri në fund. Romani «Sikur t'isha djalë» i shërbente kësaj lufte fisnike.

Historia e dhimbshme dhe revoltuese e Dijes, ishte historia e vajzës shqiptare pa të drejta, e vajzës së shtypur e të privuar nga jeta shoqërore dhe autori, duke ia paraqitur këtë lexuesit, diltë si mbrojtës i flaktë i saj dhe bën të thirrje që qarqet përparimtare të atëhershme ta zgjidhnin sa më parë e me guxim çështjen e pozitës së rëndë dhe të drejtave të gruas.

Romani «Sikur t'isha djalë» është shkruar në formë ditari dhe kjo mënyrë e ka bërë Dijen të na flasë vetë për jetën e saj. Nëpërmjet faqeve të ditarit, ne kemi rast të hyjmë në botën e heroinës, të njihemi me psikologjinë dhe mentalitetin e saj, me mendimet dhe ndjenjat e një vajze të mbyllur të kohës, të njihemi me ambientin mbytës dhe njerëzit që e rrethojnë. Duke lexuar shënimet e Dijes, ne marrim vesh për ligjet patriarkale dhe zakonet e egra që sundojnë në familjen e saj, për faktin që ajo qysh e vogël është bërë viktimë e këtyre zakoneve. E mbetur jetime, e rrethuar nga një njerëz shpirtkazzmë dhe një baba injorant dhe fanatik, atë e heqin nga shkolla para kohe dhe e mbulojnë me çarçafin e zi. Pas kësaj, ajo këput çdo lidhje me jetën e vërtetë, me botën e madhe dhe vihet në pozitën e një skllaveje të vërtetë. Jeta e Dijes kthehet në një dramë të vazhdueshme, sfilitëse, që të prek e të revoltton. Po jeta e vajzës së robëruar nuk është vetëm dramë, po dhe një luftë e pandërprerë që ajo bën për të mos iu nënshtruar ambientit dhe zakoneve të egra, për të fituar të drejtat e saj. Lufta e Dijes për fat të keq është e kufizuar, ajo nuk zhvillohet në terrenin shoqëror, po në terrenin e ngushtë

familjar, brenda mureve të shtëpisë, kundër njerks dhe të atit; po për lexuesin atëherë dhe sot, s'është zor ta kuptojë se prapa heroinës klithnin e protestonin mijëra e mijëra vajza të tjera, se akuzat dhe revoltat e Dijes i drejtoheshin jo vetëm prindërve të saj injorantë e fanatikë, po një opiniononi të tërë shoqëror, që hidhte hijen e zezë mbi jetën e gruas shqiptare; revolta e Dijes drejtohej tërthorazi edhe kundër pushtetit të errësirës, që nuk merrte asnjë masë për t'i dhënë fund kësaj skllavërie.

Heroinën e romanit të tij Haki Stërmilli nuk e mori nga ato pak vajza intelektuale të kohës, që luftonin në forma të ndryshme për të drejtat e gruas. Shkrimtari e zgjodhi heroinën nga ato rrethe, ku shtypja dhe vuajtjet e gruas shqiptare ishin më të mëdha, ku revolta dhe zemërimi i saj ishte më i thellë, atje ku luhej një dramë shekulllore. Autori ynë bënte të fliste me zë të lartë një vajzë të thjeshtë për të drejtat e gruas shqiptare. Sigurisht, Dija nuk do të dinte të fliste e të tregonte për jetën e skëtërrshme të saja e të mijëra shoqeve, nuk do të arrinte të shprehte ato mendime të guximshme dhe të godiste atje ku duhet, në qoftë se nuk do ta kishte ndihmuar autori. Haki Stërmilli, ndoshta ka qenë i ndërgjegjshëm për këtë. Ai e ka ditur që shumë mendime dhe konstatime të Dijes nuk do t'i shkonin pozitës shoqërore dhe nivelit intelektual të vajzës shqiptare të mbuluar me çarçaf, po prapë ai e bëri këtë me qëllim që të jehonin më fort mendimet dhe idetë e romanit, të mbroheshin të drejtat e gruas shqiptare.

Mendimet që shpreh Dija në ditar janë të guximshme dhe kapin shumë sfera të jetës shqiptare. Shpesh herë ato i japin veprës një karakter polemizues, heroina sulmon e mbrohet. Duke e parë nga kjo anë, mund të themi se me romanin «Sikur t'isha djalë», kemi të bëjmë me një vepër ku vendin kryesor e zë parashtrimi i ideve dhe i mendimeve, ndërsa përshkrimi i aksionit, i ngjarjeve dhe i tipave

paraqitet i kufizuar. Kjo është një nga trajtat që mori letërsia e jonë me prirje realiste në vitet '30. Parashtrimi i hapur dhe drejtpërdrejt i ideve në veprat letrare në këtë kohë, erdhi jo vetëm nga mungesa e një përvoje të pasur në fushën e prozës artistike, por edhe nga nevojat dhe kërkesat imediate të lëvizjes shoqërore. Duhej që idetë të tingëllojnë sa më fort dhe të ishin të qarta për të gjithë, në mënyrë që të nxiteshin njerëzit për t'u vënë në lëvizje. Këtë gjë bëri dhe Haki Stërmilli me romanin «Sikur t'isha djalë». Ai kapi një nga problemet kardinale dhe më aktuale të kohës dhe ia paraqiti këtë lexuesve nëpërmjet fatit të Dijes. Motivet sociale që zenë vendin kryesor në roman, dënimi që i bëri fanatizmit, fryma polemizuese, paraqitja me vërtetësi e ambienteve dhe mentaliteteve të kohës, revolta individuale e Dijes i japin romanit «Sikur t'isha djalë» thekse të realizmit kritik. Dihet se realizmi në letërsinë tonë u zhvillua relativisht vonë dhe një kontribut për këtë dha dhe Haki Stërmilli. Kontributi i tij bën pjesë në përpjekjet për një prozë realiste shqipe, e cila në fillim qe një prozë sentimentale e mpleksur me elemente të realizmit kritik. Një vepër e tillë është edhe romani «Sikur t'isha djalë».

Dija paraqet shumë mendime nëpër faqet e ditarit të saj. Ajo arsyeton drejtë, kur thotë se Shqipëria nuk mund të arrijë atje ku ëndërruan dëshmorët, po qe se femrës nuk i jepen të drejtat që i përkasin. Ajo nënvizon disa herë mendimin se gruaja është baza e shoqërisë njerëzore dhe se gruaja duke bërë një jetë të zbrazët, nën çarçaf, gjymtohet fizikisht dhe intelektualisht dhe në këtë rast shoqëria s'ka veç humbje. «Gjysmën e popullit shqiptar e ban femra, shkruan vajza e revoltuar, po ajo nuk gëzon asnjë të drejtë. Të gjitha të drejtat i ka mashkulli. Unë, po t'isha djalë, do t'i tregojsha botës mashkullore se dora që përkund djepin asht ajo që rrotullon boshtin e parë të fatit të

njerëzisë, sepse ajo dhe vetëm ajo e drejton jetën kah horizontet e ndrituna ose të errëta. Po mjerisht, s'jam djalë dhe si femër nuk mund me e nxjerrë zanin.»

Ajo ngrihet me zemërim kundër çarçafit, kundër këtij «thesit të zi», që ka paralizuar jetën e gruas shqiptare. «Nuk besoj të ketë njeri me tru të shëndoshë, — shkruan Dija, — që të mundet me shfaqë një arsye për me e vleftësue çarçafin, këtë shpikje të çuditshme që nuk ka, pa dyshim; as bazë morale, as dhe fetare dhe që asht sajue nga fantazia e sëmurë e disa njerëzve tru ndryshkur dhe ziliqarë.»

Arsyetimet e guximshme të heroinës arrijnë gjer atje, sa ajo ngrihet edhe kundër kodit civil, kur pohon se kodi është formal, mbasi nuk përfshin masa kundër atyre që e mbajnë femrën nën robëri. Në këto rrethana, ajo kupton një gjë të rëndësishme, kur thotë: «Lufton bota e re me të vjetrën, po fiton ajo që duhet shembë një orë e ma parë. Duhet të luftojmë, në daçim të rrojmë si njerëz...»

Dija nuk pajtohet për asnjë çast me gjendjen në të cilën ndodhet gruaja shqiptare, përkundrazi ngre krye e revoltohet, kritikon e godet, thërret e demaskon fajtorët, ata që janë përgjegjës për gjendjen e saj e të shoqeve të saj. Po revolta e Dijes është individuale. Ajo kudo na paraqitet vetëm, zëri i saj është një zë në shkretëtirë, asnjë nuk e dëgjon. Atëherë ajo bën sakrificën më të madhe: kërkon që të martirizohet dhe me vdekjen e saj të tërheqë vëmendjen e shoqërisë që të shqetësohet për fatin e gruas shqiptare. Në fillim Dija donte të vdiste pa ndonjë qëllim, pastaj desh të martirizohej për hir të dashurisë, kurse në fund, duke u bërë e ndërjegjshme për luftën që kishte nisur, kërkon që me vdekjen e vet të bëhet flamur i një lëvizjeje të gjerë shoqërore për çlirimin e gruas.

Njerëzit që e rrethojnë Dijen janë ose armiq të saj ose njerëz të pafuqishëm për ta ndihmuar. Ajo ka të bëjë me



një baba dhe një njerjë, robë të zakoneve dhe ligjeve konservatore, fanatikë dhe kundërshtarë të rreptë të emancipimit të gruas. Jeta e Dijes në mes tyre është një kalvar i pafund. Ata e mundojnë vajzën e tyre lirisht, pa pasë asnjë ndalesë nga ambienti, nga shoqëria dhe shteti. Bile janë xhandarët ata që e kapin Dijen dhe Shpendin dhe i fusin në burg. Kuptohet se autori do të tregojë tërthorazi se fanatikët, si prindët e Dijes, i përkrah dhe i mbron ligji.

Njeriu më i afërt i Dijes në roman na paraqitet Shpendi. Dashuria e saj me Shpendin zë pjesën më të madhe të veprës. Ajo është një dashuri e sinqertë, e pastër, herë-herë sentimentale, me ngjyra të kohës. Lidhja e dy të rinjve kalon nëpër sprova të vështira dhe mplekset me problemin e çlirimit të gruas. Shpendi na vizatohet në roman si një djalë besnik e me ndjenja fisnike, po njeri me natyrë sentimentale, që me gjithë ndonjë përpjekje që bën, nuk arrin të ngrihet në nivelin e mendimeve të përparuara të kohës. Është për të ardhur keq që një djalë si Shpend Rrëfeja, të mbetet në roman vetëm në rolin e një dashnori besnik dhe të tregohet i pafuqishëm për ta ndihmuar Dijen në arenën shoqërore.

Edhe njerëzit e tjerë që e rrethojnë Dijen nuk janë në gjendje ta ndihmojnë atë efektivisht. Irena, shoqja e saj e ngushtë, një vajzë e dashur dhe e pastër nga shpirti, nuk shkon më larg me ndihmën e saj, se sa ta ngushëllojë dhe t'i japë mësimë në gjuhë të huaj. Hamiti që tregohet i afërt e i kujdesshëm ndaj Dijes, arrin vetëm ta qortojë të atin e saj për trajtimin e keq që i bën së bijës. Po a mjaftonte kjo për ta ndihmuar në luftën që ajo i kishte shpallur botës së fanatikëve?

Një figurë që tërheq vëmendjen në roman është ajo e daj Haxhiut, prapa të cilit herë-herë fshihet vetë autori. Daj Haxhiu predikon lirinë e femrës, sipas mësimëve fetare të sektit bektashian. Me pikëpamjet e tij liberale, ai

është kundër dogmave fetare dhe koncepteve anadollake të fanatikëve që pengojnë zhvillimin e femrës. Po, pavarësisht nga botëkuptimi i kufizuar i daj Haxhiut dhe nga qëndrimi i tij pasiv, ai disa herë shfaq mendime të guximshme, që ngjallin besim te Dija në luftën që ajo bën. Ai thotë se brenda 10-15 vjetëve do të shembet bota e vjetër dhe do të krijohet një botë e re. S'ka dyshim se këto mendime e të tjera si këto janë ide të autorit, i cili për shkak të censurës së rreptë i ka shprehur nëpërmjet një fetari.

Por duhet thënë se Dija, megjithëse jeton në mes të njerëzve, prapë mbetet vetëm. Në këto rrethana ajo bëhet akoma më e dashur për lexuesin. Dija të bën për vete, jo vetëm me dramën e saj, me fatin tragjik që pëson, po edhe me guximin dhe vendosmërinë e patundur.

Po romani «Sikur t'isha djalë», me gjithë të metat dhe mungesat, qe një sukses për prozën tonë të kohës dhe mbeti një nga romanet më popullore të letërsisë shqipe. Dhe kjo erdhi jo vetëm për shkak të vlerave ideore, por edhe nga meritat artistike dhe aftësitë e Haki Stërmillit si prozator. Ai ka ndërtuar nëpërmjet historisë së një vajze të thjeshtë shqiptare; një roman mjaft të këndshëm, me një trajtë origjinale, me mjete shprehëse interesante. Duke e njohur nga afër jetën tonë të atëhershme, duke depërtuar deri prapa mureve dhe kafazeve, ku jetonte vajza shqiptare, Haki Stërmilli krijoi një vepër me frymë e ngjyrë kombëtare. Në mënyrë të veçantë, ai ka ditur të na rijapë të gjallë dhe me kolorit atmosferën dhe ambientet fanatike, zakonet e doket e familjeve myslimane në Shqipërinë e Mesme. Këto janë nga faqet më të bukura dhe artistikisht më të goditura të romanit. Një sukses për autorin dhe për prozën tonë të atyre viteve është realizimi i figurës së Dijes, si një personazh i gjallë e i dashur, që mbetet një figurë e paharruar.

Në roman, sado që këto jepen nëpërmjet ditarit të heroinës, gjejmë skena realiste nga jeta, ngjarje dhe momente të goditura me funksione ideoartistike. Kështu p.sh. lexuesit i mbeten në mend skena e ardhjes në shtëpinë e Dijes të fshatarit që sjell dru, bisedat e vajzës me shoqet, skenat e ceremonive familjare, largimi i Dijes nga shtëpia dhe skena e kapjes nga xhandarët, etj. Ngjarjet dhe mendimet e veprës janë dhënë me një kompozicion të drejtë, me një stil të rrjedhshëm e të punuar, me një leksik e frazeologji të pasur. Nga kjo pikëpamje Haki Stërmilli jep një kontribut të çmuar në historinë e romanit shqiptar.

Romani «Sikur t'isha djalë» është bërë tanimë një veper popullore në mes lexuesve. Në kohën kur doli, ai shënoi një ngjarje në jetën tonë letrare dhe kjo shpjegohet për arsye, jo vetëm të problemeve aktuale që shtronte vepra, por edhe për frymën realiste dhe vlerat e saj artistike. Suksesi i bujshëm i romanit u duk në jehonën që i bëri shtypi dhe në letrat e shumta që iu dërguan autorit. Bile pati dhe vjersha që iu kushtuan fatit tragjik të heroinës. Të gjithë, në një mënyrë apo në një tjetër vinin theksin në vlerën sociale të veprës. Romani u quajt «libër i ditës», «ilaç i kohës», «një gërmim i imtë i jetës sonë». Nga jehona që bëri vepra në rininë e kohës, sidomos tek vajzat e reja, të tërheq vemendjen letra që i drejton autorit një vajzë dibrane, nën pseudonimin «Flaka» (pas «Flakës» fshihej shoqja Nexhmije Xhuglini — Hoxha). E reja revolucionare, duke marrë shkas nga romani «Sikur t'isha djalë», me idetë e guximëshme që çfaq dhe optimizmin që ka për të arthmen, e çon më tej revoltën e Dijes dhe mendimet e autorit. Ndërmjet të tjerash, ajo shprehet me këto fjalë të guximshme:

«Do të vijë dita që na, pa qenë nevoja të bërtasim «Sikur t'isha djalë», të bashkuem nën flamurin e «lirisë» do të gjejmë vetë rrugën e drejtë, rrugën e shpëtimit.»

Dhe vërtetë, nuk kaluan veç disa vjetë dhe ngjau ajo për të cilën shprehej bindja në letrën e vajzës së re: mijëra e mijëra luftëtarë e luftëtare, e bashkë me ta edhe autori i romanit «Sikur t'isha djalë» u ngritën në këmbë dhe të prirë nga flamuri i PKSË u hodhën në luftën e madhe të çlirimit. Kjo që lëvizja e fuqishme Nacionalçlirimtare që zhdukuri njëherë e përgjithmonë nga atdheu ynë çdo lloj shtypje, çliroi popullin dhe i hoqi gruas prangat e robërisë. Dhe tani që robëria e gruas shqiptare ka kaluar në histori, romani «Sikur t'isha djalë» mbetet një dokument i gjallë, që akuzon dhe dënon një epokë të tërë të mynxyrëshme. Nga kjo pikëpamje romani «Sikur t'isha djalë» është dhe sot një vepër e dashur dhe e çmuar nga të gjithë brezat e lexuesve.

Romani «Sikur t'isha djalë» zë një vend të nderuar në historinë e letërsisë shqipe, si një nga sukseset e para të romanit shqiptar, si vepra më e mirë e shkrimtarit patriot Haki Stërmilli.

Puna që bëri Haki Stërmilli si shkrimtar në vitet e pasçlirimit, që një punë pothuajse e heshtur dhe modeste. Themi kështu, sepse veç dramës «Trashëgimtarët tanë», disa fragmente nga ditari i luftës «Shtigjet e lirisë» dhe disa artikujve publicistikë, shkrimtari ynë nuk botoi gjë tjetër. Po në të vërtetë, ai punonte pa u lodhur e pa u ndier duke shkruar vepra të reja e duke ripunuar të vjetrat. Kështu Haki Stërmilli shkroi romanin «Kalorësi i Skënderbeut», vepër me subjekt nga koha e Skënderbeut, dramën «Suta» dhe «Luftëtarët tanë», kushtuar ngjarjeve të Luftës Nacionalçlirimtare në Dibër, ripunoi romanin «Hafsh dhe hov zemrash», vepër që e kishte shkruar gjatë jetës partizane, kushtuar heroizmit të rinisë sonë antifashiste, u mor me mbledhjen e folklorit dibran dhe pregatiti një përmbledhje përrallash nën titullin «Rranzë vo-

trës dibrane» që konsiderohet si një kontribut i çmuar në mbledhjen e prozës sonë popullore. Ai, siç shihet, me gjithë moshën dhe shëndetin jo të mbarë, punonte shumë dhe në mënyrë sistematike. Po nga ana tjetër, shkrimtari ynë i nderuar ishte i ndërgjegjshëm për vështirësitë që haste puna e tij krijuese në konditat e reja. Letërsia jonë kishte ecur përpara për nga konceptimi ideoartistik. Realiteti i ri për t'u shprehur e mishëruar në art nga pozita të shëndosha, kërkonte zotërimin e një metode të re krijuese, siç ishte metoda e realizmit socialist. Haki Stërmilli me entuziazmin që e karakterizonte i hyri me mish e me shpirt kësaj pune dhe fryt i përpjekjeve të tij të sinqerta qe drama «Trashigimtarët tanë», e para vepër e këtij lloji në letërsinë tonë të re për fëmijë. Drama, natyrisht si provë e parë e autorit në konditat e reja nuk doli pa të meta, po shkrimtari e mori prapë në dorë dhe pak kohë para se të vdiste na e la të ripunuar. Ky gjest s'ka si të mos na emocionojë edhe sot e të na shtojë respektin. Ai deri në fund deshi të tregohej i denjë ndaj letërsisë sonë të re, desh të mos mbetej prapa nga koha, siç nuk kishte mbetur kurrë gjatë tërë jetës së tij. Ky qe edhe kujtimi i fundit që na la Haki Stërmilli.

1965.

## DORËSHKRIMET E LUFTËS NACIONALÇLIRIM- TARE TË HAKI STËRMILLIT

Është për nder të letërsisë sonë, që një shkrimtar i njohur si Haki Stërmilli u radhit me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, që udhëhoqi PKSH dhe kaloi nëpër rrugët e luftës me armë në dorë deri në çlirimin e atdheut. Edhe pse i moshuar, ai bëri jetën e vështirë po heroike të partizanit, përballoi vuajtje dhe privacione të mëdha, duke mos harruar për asnjë çast dhe detyrën si shkrimtar. Kështu ai kreu një punë të dendur letrare, duke shkruar me qindra faqe, në kushte jo të zakonata, me besim të patundur në fitoren e popullit. Shkrimet e luftës të Haki Stërmillit përbëjnë, do të thoshim një nga faqet autentike të historisë së krijimtarisë sonë letrare. Shkrimtari partizan shkruante çdo ditë, në çfarëdo rrethanash, duke e bërë këtë, i nxitur, jo aq nga forca e zakonit si krijues se sa nga emocionet e forta që i zgjonte lufta heroike, përjetimi i thellë i ngjarjeve të mëdha. Heroizmi ishte i përditshëm, masiv, kishte një shpërthim të paparë të energjive të popullit, të forcës, guximit, të mençurisë së masave. Një shkrimtar patriot, si Haki Stërmilli, e quante për detyrë t'i fiksonte këto mbresa e ngjarje flakë për flakë. Pasqyrë e gjallë e këtij qëndrimi militant është ditari «Shtigjet e lirisë», ku lufta jonë jepet e jetuar drejtpërdrejt nga shkrimtari.

Por, veç ditarit, që mbajti në mënyrë të rregullt, Haki Stërmilli bëri një punë të mirëfilltë krijuese. Në kohën e luftës, gjatë jetës partizane, ai shkroi dhe romanin «Hafsh dhe hov zemrash» si dhe pjesët teatrale «Luftëtarët tanë».

(dramë me tre akte) dhe «Suta» (tragjedi me pesë akte), të cilat i la në dorëshkrim dhe gjenden në Arkivin e Shtetit. Të tria këto vepra janë frymëzuar nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe kanë në themel ngjarje nga kjo epope e lavdishme.

Romanin «Hafsh dhe hov zemrash» e shkroi, siç na dëshmon dhe në ditarin e tij, në ditët e rënda të Operacionit të Dimrit të vitit 1944. Tamam në këtë kohë, i fshehur në një shtëpi të vogël në fshatin e largët Okshtun të malësisë së Dibrës, i hyn punës për të hartuar një roman. Pa përfillur të ftohtët dhe urinë, izolimin dhe mungesën e kushteve elementare, duke shkruar herë në pyll që kërciste nga dëbora, herë në kasollen e akullit, ai e kreu veprën në më pak se një muaj (17 janar — 10 shkurt).

Romani zë rreth 200 faqe dorëshkrim dhe është shkruar me laps, në fletë të madhësive të ndryshme. Nga ditari marrim vesh se në rrethanat në të cilat gjendej, halli më i madh i autorit ishte pamundësia për të gjetur letër, se s'kishte ku të shkruante dhe këtë punë e bënte herë mbi gjunjë, herë mbi një trung të prerë. Këto hollësi e të tjera që të preknin, flasin jo vetëm për një vullnet të jashtëzakonshëm, po tregojnë se ç'besim të thellë i frymëzonin idealet e PKSHP në një nga momentet më të rënda të luftës. Ishte kjo bindje e ndërgjegjshme dhe entuziazmi i madh që bënë të mundur në ato kondita, t'i hynte punës së vështirë për të thurur një roman dhe për t'ia dalë mbanë, brenda mundësive të tij.

Në ditari ka shënuar mes të tjerash për këtë roman: «Ky ka me qënë libri i shokëve e shoqeve të luftës, libri i vuajtjeve të popullit tonë, libri i heroizmave të një brezi, që u zhvillua e u formua nga urrejtja kundër fashizmit».

Nga leximi i veprës del se autori ka synuar të përfshijë aspektet kryesore të Luftës Nacionalçlirimtare, të japë luftën partizane dhe qëndresën antifashiste në qytet.

Për këto, ai u ka dhënë ngjarjeve një shtrirje të gjerë, duke i nisur nga viti 1938 e duke i mbyllur me çlirimin e atdheut. Aksioni është lokalizuar kryesisht në Tiranë dhe në disa zona të Shqipërisë së Mesme.

Në qendër të romanit ka vënë studentin Fatos Malaj, të birin e një patrioti, i cili, nga një i ri i zakonshëm, duke kaluar nëpër rrugën e luftës revolucionare, i edukuar nga idealet e PKSH, bëhet një luftëtar i ndërgjegjshëm për çështjen e madhe të popullit. Njëpërmjet fatit të ndërlikuar të heroit, ai rreh të pasqyrojë luftën e rinisë shqiptare, problemet dhe gjendjen e saj shpirtërore gjatë pushtimit, veprimtarinë klandestine, qëndresën nëpër burgje, luftën guerile e jetën partizane. Duke e kaluar heroin nëpër situata të vështira plot peripeci, autori, nxjerr në pah figurën e të riut revolucionar, vetitë e çmuara, si: ndërgjegjen e lartë e besimin në kauzën e luftës, guximin dhe vendosmërinë e rinisë. Fatosin, ai është përpjekur ta zbulojë sidomos duke i kundërvënë Petritin, që përbën figurën antagoniste në roman. Petriti përfaqëson të riun ambicioz e intrigant, të mbushur me vese, për të cilin çështja e luftës së popullit është krejt e huaj. Qëndrimi i tij prej tradhtari të kamufluar e dëmton punën e organizatës së rinisë komuniste dhe i sjell telashe të mëdha Fatosit.

Linja e luftës në roman është gërshetuar me një linjë dashurie. Kjo është dashuria e Fatosit me Lulen, e dhënë në sfondin e marrëdhënieve të reja që kishin krijuar përpjekjet dhe ideali i përbashkët.

Interesante paraqitet figura e Hajdar Malajt, përfaqësuesit të brezit të vjetër. Ai është patrioti popullor që sheh te PKSH udhëheqësen e vërtetë të luftës për çlirimin e atdheut. Në këtë figurë mund të gjejmë mjaft elementë autobiografikë të vetë shkrimtarit.

Në roman veprojnë një mori personazhesh, pjesa më e madhe e të cilëve janë episodikë dhe anësorë. Vëmen-



djen kryesore autori ia ka kushtuar përshkrimin të ngjarjeve. Ngjarjet janë dhënë me dramacitet, plot me të papritura, me situata herë-herë të jashtëzakonshme dhe nga kjo pikëpamje romani e tërheq lexuesin. E shkruar në valën e luftës, autori ka arritur të ngërthejë atmosferën e saj, frymën heroike dhe hovin e rinisë. Ai tregon luftën nga pozita të drejta, si luftë masash, me synime të qarta, me udhëheqës të vërtetë dhe i çjerr maskën pseudopatriotizmit borgjez, të përfaqësuar nga Arifi, Diku, Qazimi, etj.

Romanin e përshkon një patos i gjallë, patosi që përftoi lufta popullore e prirë nga komunistët. Autori shkruan si luftëtari për bashkluftëtarët e tij, me dashuri e me besim, ai di për kë shkruan e pse shkruan.

Në mënyrë të veçantë, vepra ka vlera njohëse. Ajo përfshin një material të gjallë jetësor që flet për një njohje nga autori të kronikës së ngjarjeve të luftës dhe të njerëzve të saj. Prej kësaj rrjedh dhe vlera edukative e veprës. Ajo ka një ide të shëndoshë e një temë premtuese. Po romani, natyrisht s'është edhe i kryer. Në kushtet që u shkrua, në kohën kur lufta ishte në vazhdim, vepra s'kishite se si të plotësonte ato kërkesa që do ta bënë të realizuar. Në të vërtetë, autori vetëm sa ka hedhur ngjarjet në letër dhe ka bërë përpjekjet e para për mbarështrimin e materialit. Domsdo dhe personazhet sapo janë skicuar. Mendimet dhe idetë e shëndosha jo gjithnjë kanë gjetur mishërimin e duhur artistik. Veç kësaj, para shkrimtarit, në rrethanat e reja historike, dilnin detyra të ndërlikuara ideoartistike. Atij i mungonte ajo përgatitje e formim ideoartistik, për t'i bërë ballë problemeve që nxirrte realiteti revolucionar. Konceptimi romantiko-sentimental, skeptizmi, vendi i madh që zë intriga e ndonjë e metë tjetër, tregojnë se autori s'arriti dot t'i thyejë kornizat e vjetra. Përmbajtja e re, problemet komplekse të luftës popullore, u konceptuan në mënyrë pak anakronike dhe u dhanë në

trajta herë-herë të vjetëruara. Prej kësaj shpjegohet karakteri kronikal i veprës, fryma agjitative, mungesa e karaktereve, fryma sentimentale, etj.

Na e merr mendja se shkrimtari ishte i ndërgjegjshëm për këto dobësi e kufizime dhe, ndoshta, do ta kishte marrë përsëri në dorë për ta punuar më tej, në qoftë se nuk do të kishte ndodhur vdekja e parakohshme. Po pavarësisht nga kjo, romani përbën një moment të rëndësishëm në rrugën e krijimtarisë së shkrimtarit tonë të nderuar. Ai dëshmon se me ç'dashuri e sinqeritet i përqafoi idetë e mëdha të luftës dhe ç'përpjekje bëri për t'i pasqyruar ato në një veper letrare, ashtu siç dinte dhe me mundësitë që kishte. Romani është një dokument me vlerë në historinë e përpjekjeve për të krijuar një letërsi të re në zjarrin e luftës.

Edhe veprat dramatike «Luftëtarët tanë» e «Suta» kanë në themel të tyre temën e luftës. Autori i zhvillon ngjarjet në krahinën e Dibrës, në ato ambiente ku dikur pat vendosur ngjarjet e dramave të tij të para. Po ndryshe nga ajo kohë, ai pasqyron luftën e dibranëve në kushtet e zgjimit të ndërgjegjes popullore. Konfliktet e ngritur janë reale dhe burojnë nga lufta e popullit kundër pushuesve dhe parisë. Fabulat janë të thjeshta. Në pjesët më të mira autori ka arritur të krijojë dramacitet. Nga personazhet bien në sy figurat e femrave luftëtare. Po që të dyja veprat mbeten në kufijtë e përpjekjeve interesante, që flasin për synimet e reja të autorit edhe në fushën e dramaturgisë.

Epopeja e madhe e Luftës Nacionalçlirimtare zgjoi te Haki Stërmilli një frymëzim të ri. Veprat në dorëshkrim të kësaj kohe e dëshmojnë këtë më së miri. Ato e sjellin këtë frymëzim të zjarrtë në ditët tona dhe rrisin te ne ndërrimin ndaj shkrimtarit patriot.

1974

## DITARI PARTIZAN «SHTIGJET E LIRISË».

Ndër shkrimtarët tanë që morën pjesë me armë në dorë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare më i moçmi ishte Haki Stërmilli. Themi më i moçmi, sado që ai nuk i kishte mbushur të pesëdhjetat, sepse shkrimtarët e tjerë partizanë qenë të rinj ose sapo i kishin kapërcyer vitet e rinisë. Haki Stërmilli ka meritën e madhe, që ndryshe nga mjaft shkrimtarë të brezit të tij, nuk u kufizua vetëm me punën letrare, por sa herë e desh momenti historik u radhit me ato forca që luftonin për lirinë dhe përparimin e atdheut. Lëvizja Nacionalçlirimtare ishte një përpjekje vigane që bënte populli shqiptar me armiqtë e tij të përjetshëm dhe luftëtari i vjetër Haki Stërmilli s'kishte se si të mos merrte pjesë në të. I nisur nga përvoja e tij politike, ai nuk e pati vështirë të njihte që në fillim të luftës miqtë dhe armiqtë e vërtetë të lirisë, t'i hiqte maskën të ashtuquajturve «ballarë e udhëheqës të kombit». Historia dhe përvoja e tij e hidhur tregonin se klasat sunduese e kishin gënjer gjithnjë popullin dhe se kish ardhur tamam koha që masat të nxirrnin nga gjiri i tyre udhëheqës të vërtetë. Për këtë Haki Stërmilli ishte i bindur dhe kjo u provua me formimin e PKSH, tek e cila shkrimtari patriot pa farkëtuesen e fitoreve të popullit. Komunistët, ai i cilësonte udhëheqës krejt të rinj, udhërrëfënës të vërtetë të popullit që nuk kanë asgjë të përbashkët me krerët dhe ideologët e feudo-borgjezisë. Në mënyrë të veçantë, ai çmonte lartë rolin e madh të shokut Enver Hoxha, si udhëheqës i popullit

shqiptar në Luftën Nacionalçlirimtare. Vetë shkrimtari hyri që në fillim në radhët e luftëtarëve të lirisë dhe nën udhëheqjen e PKSH luftoi për triumfin e idealeve të Lëvizjes.

Haki Stërmilli u bashkua pa rezerva me Lëvizjen Nacionalçlirimtare menjëherë pas Konferencës historike të Pezës. Në korrik të vitit 1943, ai u hodh në ilegalitet dhe bëri jetën partizane deri në çlirimin e vendit.

Sigurisht, kontributi i Haki Stërmillit si militant i lëvizjes është i rëndësishëm, po gjëja më e çmuar, do të thoshnim që ai na ka lënë, si kujtim të asaj epoke të lavdishme, është ditari «Shtigjet e lirisë». Megjithëse nuk përmbledh gjithë periudhën e luftës dhe ngjarjet e përshkruara nuk përfshijnë tërë krahinat e vendit, ditari përfaqëson denjësisht mbarë Luftën Nacionalçlirimtare që bëri populli shqiptar. Ditari fillon nga 30 korriku 1943 dhe mbyllet më 30 nëndor 1944. Ngjarjet e shënuara në të zhvillohen në Tiranë e në rrethin e saj, në Çermenikë, Martanesh, Peshkopi, Dibër të Madhe, Berat, Malësia e Elbasanit, etj. Natyrisht, shkrimtari s'ka patur mundësi të jepte gjithë kronikën e Luftës Nacionalçlirimtare, por në përshkrimin e ngjarjeve që ka jetuar vetë, ai ka meritën t'i ketë parë këto në kuadrin e tërë luftës. Lexuesi ndjen, goftë dhe në një episod të vogël, jehonën e epopesë së madhe popullore; ndjen që lufton gjithë populli shqiptar, se kjo lëvizje është e organizuar dhe ka ideale të qarta, se atë e drejtojnë udhëheqës të zotë e largpamës, se kjo përpyekje vigane që bën vegjëlja është lufta e saj finale mbi armiqtë shekullorë. Ditari «Shtigjet e lirisë», nuk është një kronikë e thjeshtë ngjarjesh dhe autori i tij nuk ka luajtur rolin e kronistit, po duke njohur odisenë e historisë shqiptare dhe shpirtin e popullit shqiptar, ai është munduar që çdo ngjarje a personi t'i japë një kuptim social-historik. Kur e mbyll faqen e fundit të ditarit, ajo që të mbetet në

mendje është besimi i thellë i shkrimtarit në fitoren e pashmangshme të luftës sonë, optimizmi në perspektivën e saj. Nga ana tjetër, është gjithë merita e autorit se duke iu shmangur frazave të bukura, stolisjeve të jashtme, fantazisë, ai na e ka paraqitur Luftën Nacionalçlirimtare thjeshtë, qartë dhe me vërtetësi. Për lexuesin është fat që këtë ditar e ka mbajtur një luftëtar i vjetër i kauzës së popullit, po dhe një shkrimtar që kish bërë emër të mirë në fushën e letrave shqipe. Të dyja këto anë të personalitetit të Haki Stërmillit në ditar janë shkrirë në një. Shkrimtari nuk e ndan asnjëherë veten nga të tjerët. Ai na paraqitet kudo si luftëtar në mes luftëtarëve dhe nga kjo pozitë e ky kënd vështrimi na i pasqyron ngjarjet dhe njerëzit në luftë. Duke qenë i lidhur politikisht e shpirtërisht me luftëtarët e lirisë, ai është bërë zëdhënës i tyre, interpret besnik i ndjenjave dhe mendimeve të tyre. Shkrimtari e ka paraqitur momentin e madh historik, ashtu siç do ta përshkruante çdo partizan.

Në ditarin e tij, mbi të gjitha na ka treguar për heroizmin e madh të popullit gjatë atyre viteve të stuhishme. Ky heroizëm, nënvizon shkrimtari, është masiv dhe i përditshëm; atë e sheh tek të mëdhenjtë e tek të vegjëlit, ai ndodhet në qytet e në fshat, në mal e në fushë; kudo dhe në çdo kohë që populli manifeston me një forcë e bukuri të rrallë patriotizmin e vet. Heroizmi është aq i madh e i shpeshtë, sa shkrimtari habitet e shtanget dhe, me gjithë dëshirën e zjarrtë që ka, nuk arrin të na e japë tërë madhështinë e heroizmit popullor. Po prapë, ato momente e raste që ai ka mundur të fiksojë, na krijojnë një ide të qartë për rrugën e luftës nëpër të cilën kaloi populli nën udhëheqjen e PKSH. Në ditar shquhet figura e madhërishtme e partizanit; shkrimtari i quan partizanët viganë, njerëz legjendarë, që nuk i mposht as plumbi, as uria, as të ftohët, bile dhe vdekja nuk bën asnjë efekt, sepse një bie, një-

qind të tjerë zënë vendin e tij. Partizanët nuk e përfillin vdekjen para lirisë së atdheut. Haki Stërmilli shquan me kënaqësi se burimi i këtij heroizmi është Partia, ajo është forca që ka vënë në lëvizje masat. «Komunistët, shkruan autori, janë tipa të çuditshëm dhe të pamposhtur». Ai i quan ata njerëz krejt të rinj, me botëkuptim të lartë, me shpirt të madh, prijësa të denjë të popullit. Në sajë të tyre, Lufta Nacionalçlirimtare është bërë një shkollë e madhe, ku populli ka njohur forcën e vet dhe ka përqafuar të vërtetën. Atë që nuk bënë dot pesë shekuj, populli e bëri nën udhëheqjen e komunistëve gjatë pesë vjetëve të Luftës. Partia, nënvizon Haki Stërmilli, gjeti thesare në thellësinë e shpirtit të shqiptarëve dhe i vuri këto në shërbim të një ideali të madh. Dhe si shfaqje të kësaj kthese të madhe në jetën e popullit shqiptar na përshkruan vrullin revolucionar, zgjimin e ndërgjegjes klasore, krijimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ngritjen e pushtetit të ri, aktet heroike, etj. Për të na treguar të gjitha këto, shkrimtari u ka dhënë në ditar më shumë vend fakteve e ngjarjeve, se sa përgjithësimeve e sintezave historike. Po duke u njohur me ngjarje e fakte të gjalla të kohës, lexuesi nuk e ka vështirë të nxjerrë vetë konkluzione të drejta. Haki Stërmilli, i nisur nga realiteti i gjallë i luftës, nxjerr në pah një nga tiparet më të rëndësishme të saj, tregon se përpjekja vigane që po bën populli, nuk është vetëm luftë për çlirimin kombëtar, por dhe një revolucion shoqëror drejtuar kundër «kështjellës mijëvjeçare të feudalizmit» e jo vetëm kundër feudalizmit... Ai ka bindjen e patundur se pas kësaj ndeshjeje të madhe historike, e kaluara nuk do të kthehet më kurrë. «Unë besoj, shkruan autori i ditarit, se nuk do të kthehet e kaluemja, edhe sikur të rroposet lamshi i dheut, pse populli do ta kundërshtojë». Kjo ndodh, shpjegon Haki Stërmilli, se populli shqiptar kësaj here i ka hyrë një luftë të ndërgjegjshme, jo vetëm kundër të huajve, po dhe

kundër klasave shtypëse. Shkrimtari partizan vë re me gëzim se në procesin e luftës së ashpër, klasat sunduese vijnë gjithnjë duke u demaskuar dhe se ato me tradhtinë e tyre ndaj interesave të atdheut e kanë humbur njëherë e përgjithmonë besimin e popullit. Në qendër të goditjes së vet, ka vënë Ballin Kombëtar, të cilin e merr si përfaqësuesin e interesave të bejlerëve, tregtarëve e gjithë tradhtarve të vendit. I ndriçuar nga mësimet e PKSH ai na e përshkruan Ballin Kombëtar si një organizatë që s'ka asgjë të përbashkët me popullin dhe që është krijuar nga pushtuesit për kundërpeshë. Fytyrën e vërtetë të Ballit, Haki Stërmilli e sheh që në mbledhjen e Mukjes, ku të dërguarit e tij dijnë të thonë vetëm fjalë të bukura, po ai e njih akoma më mirë në luftë e sipër, kur Balli e hedh fare maskën dhe vihet në shërbim drejtpërdrejt të pushtuesit. Po kështu në ditat demaskon pa mëshirë bajraktarët dhe krerët e disa krahinave të Veriut, veçanërisht ata të Dibrës. Ai sheh me kënaqësi se si këta armiq të maskuar, nuk i ndjek më pas populli, nuk i beson më. Kjo gjë e entuziazmon pa masë demokartin e vjetër, «bashkimaxhiun» e dikurshëm.

Po Haki Stërmilli, sa gëzohet për zgjimin e përgjithshëm të popullit, aq trishtohet për gjendjen e tij të mjeruar, sidomos të fshatarësisë së viseve të Veriut. Ai revoltohet nga prapambetja dhe varfëria, nga injoranca dhe sëmundjet e tmerrshme që kanë pushtuar prej shekujsh vatrat fshatare. Momentet, ku ai na përshkruan jetën e mjerë të malësorëve janë nga pjesët më prekëse të ditarit. Po shkrimtari nuk vajton para kësaj gjendje dramatike, përkundrazi, nga kjo gjë merr shkas për të forcuar besimin në drejtësinë e qëllimeve të shenjta të luftës dhe për të shtuar urrejtjen ndaj armiqve. Pikërisht, te fshatarësia e mjeruar dhe e shtypur, Lëvizja Nacionalçlirimtare gjeti një nga mbështetjet e saj kryesore. Dhe shkrimtari luf-

tëtar shpreh në ditar bindjen e thellë se, ashtu siç thosh PKSH, do të vinte doemos koha kur fshatarësia shqiptare do të çlirohej dhe do të vihej në rrugën e përparimit e begatisë. Jeta e vërtetoi plotësisht këtë dëshirë e ëndërr fisnike të tij, ashtu siç çoi në vend dhe një ëndërr tjetër të zjarhtë të autorit. Dikur Haki Stërmilli me romanin «Sikur të isha djalë» pat ngritur zërin e revoltuar për emancipimin e gruas shqiptare dhe pat ëndërruar për ta parë atë zonjë të fateve të veta. Kur lexon ditarin e tij, nuk ke si të mos bashkohesh me gëzimin e tij të sinqertë që arriti ta shohë gruan luftëtare dhe të barabartë në mes të barabartëve. Dhe sado që për çudi, ai nuk na e përmend fare në ditarin e luftës Dijen, ne prapë e kuptojmë se autori tërthorazi do të thotë se rruga për çlirimin e vërtetë të gruas nuk është rruga që ndoqi Dija, po rruga që përshkuan mijëra partizane, rruga e Margarita Tutulanit, e Shejnaze Jukës dhe e shoqeve të tyre për të cilat ai shkruan në ditar.

Epopeja e Luftës u bë një shkollë e madhe dhe për vetë shkrimtarin. Megjithëse në moshë të kaluar, u bëri ballë vështirësive dhe u gjend në mes rreziqesh, sa herë që e kërkoi interesi i popullit. Ai mori pjesë në luftime të ndryshme, marshoi i uritur dhe i zbathur tok me partizanët, bëri jetën e tyre të thjeshtë e plot sakrifica, duke mos pranuar asnjë lehtësi e privilegj. Atij iu desh të punojë në zona të vështira, të kalojë përmes vuajtjesh të mëdha Operacionin e Dimrit, duke pasur, siç dëshmon ditari dhe shokët e tij që jetuan këto çaste bashkë me të, një besim të thellë te partia, te qëllimet e luftës. Ja se çfarë na tregon shkrimtari Qamil Guranjaku në përshkrimin «Tetë ditë pa bukë»:

«Shiu binte pa pushim dhe shuente zjarret tona. Ne rrinim jashtë. Zjarri shuej e na ndiz përsëri. Po në mëngjez mbeteshin vetëm thëngjillat e hirit që ishin ndrrue



në baltë. Me gjithë se binte shi për kiamet, disa partizanë gërhitshin nëpër gjumë. Ishin kaq të raskapitur, sa nuk e ndijshin fare shiun që u binte përsipër dhe ujin që u shkonte nën të si rrëke. Në rrazë të një ahu të madh qëndronte Haki Stërmilli me një batanije në kokë dhe një qiri në dorë. Mallkonte me gjithë fuqinë e tij, se donte të shënonte diçka. Po shiu e shponte dhe batanijen dhe i pikonte mbi fletët e ditarit. Dha e dha, e ma në fund e mbylli fletoren, se nuk ish punë që bahesh...»

Kështu punonte Haki Stërmilli gjatë luftës, po edhe pse në këto kondita, ai e vijonte punën e vet. Sot, kur shfleton dorëshkrimet e tij të asaj kohe, nuk mund të mos habitesh e të mos prelesh. Janë qindra faqe të mbajtura në rrethanat më të ndryshme. Ai na e thotë vetë në ditar se gjithë pasuria e tij gjatë luftës ishte një valixhe e vogël, ku s'kishte tjetër brenda, veç ditarit, shkrimeve dhe... veglave të rrojes. Duke studjuar sot dorëshkrimet e luftës, kuptojmë se ai ka punuar me një vullnet dhe ritëm pune të jashtëzakonshëm. Mjafton për këtë të përmendim faktin që aso kohe, në periudhën e vështirë të Operacionit të Dimit, ai shkroi romanin «Hafsh dhe hov zemrash...».

Në Kongresin historik të Përmetit, ku u ligjërua pushteti i popullit dhe me ngjarjet e mëdha që erdhën më vonë, ai arriti të shohë me sytë e vetë realizimin e ëndrrave shekullore të popullit shqiptar, kurorëzimin e idealeve për të cilat ai kishte luftuar më shumë se një çerek shekulli. Fatet e Shqipërisë tani ishin siguruar njëherë e përgjithmonë dhe me këtë bindje të patundur e mbyll faqen e fundit të ditarit, kur shkruan më 30 nëndor 1944, një ditë pas çlirimit të plotë të atdheut :

*«Tash po e mbyll këtë ditar me besim të formuem gjatë luftës. Ka në botë forca, që munden me e shue fare këtë popull. Por s'ka asnjë fuqi që të mundet me e përkulë dhe me e robnue këtë popull...».*

Ditari «Shtigjet e lirisë» nuk ka vetëm vlerën e një dokumenti të gjallë, por është dhe një vepër me merita letrare. I shkruar me patosin partizan dhe herë-herë me nota poetike, me një gjuhë të zhdërvjellët e stil tërheqës, ai të prek e të bën për vete. Ditari ngërthen plot episode e ngjarje të përshkruara me një thjeshtësi sugjestive dhe vërtetësi të madhe. Është meritë e shkrimtarit që ka ditur të ruajë në vepër atmosferën e kohës, të fiksojë vrullin revolucionar të atyre viteve të stuhishme. Për lexuesin ngelen të paharruara portretet e udhëheqësve të luftës dhe të partizanëve të thjeshtë, të cilët ndonëse të vizatuar me vija të shpejta janë paraqitur bukur dhe në mënyrë bindëse. Heroizmi i madh i popullit në luftë me armiqtë e tij shekullorë i kanë frymëzuar autorit plot faqe të bukura, ku mendimet dhe ndjenjat e tij kanë gjetur një shtrirje të gjerë.

Duke lënë pas këtë ditar, Haki Stërmilli, na ka dhënë një vepër që s'ka të çmuar. Me «Shtigjet e lirisë» shkrimtari partizan do t'u tregojë ngaherë brezave të rinj për epopenë e lavdishme që kreu populli ynë nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare.

1966.

## ROMANI «KALORËSI I SKËNDERBEUT» I H.STËRMILLIT

Në mes veprave të pabotuara që na ka lënë shkrimtari Haki Stërmilli, është dhe romani historik «Kalorësi i Skënderbeut». Romani, sikurse dëshmon dhe dorëshkrimi, u nis para lufte, më 1938, dhe u krye, pas një ndërprerje të gjatë, prej afro 12 vjetësh, më 1950. Kjo është vepra e fundit e rëndësishme që krijoi shkrimtari ynë i mirënjohur.

Në themel të romanit të ri, Haki Stërmilli ka vënë një temë historike: luftën e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër pushtuesve turq. Ngjarjet e veprës pra, na çojnë në shekullin e XV-të. Por për të thurur romanin, autori nuk ka marrë gjithë epokën. Vemendja e tij është përqëndruar kryesisht, në periudhën e viteve 1451-1456. Duke e shtrirë subjektin në këtë periudhë të mbushur plot ngjarje të rëndësishme, kjo i ka dhënë dorë autorit të ndërtojë një vepër interesante. Për këtë, ai ka shfrytëzuar fakte të njohura historike, duke i kombinuar këto, me fantazinë e tij krijuese, i udhëhequr nga ide të shëndosha patriotike. Në vija të përgjithshme ai e ka konceptuar drejt figurën e Skënderbeut dhe luftën e tij. Heroi ynë është paraqitur si një udhëheqës në krye të popullit që lufton kundër rrezikut turk, duke u mbështetur, në radhë të parë, në masën e fshatarësisë së lirë, në luftë me krerët separatistë, për të realizuar detyrën e vështirë historike të krijimit të një shteti të përqëndruar shqiptar.

Shkrimtari nuk ka marrë përsipër të shkruajë një roman epike, ku të zbulojë në mënyrë të gjithanshme figurën e madhërishtme të heroit tonë dhe ngjarjet më të rëndësishme të kohës. Detyra që ai i ka ngarkuar vetes, përta i përket përmasave, ka qenë modeste. Duke hyrë në brëndësi të epokës, nëpërmjet historisë dhe traditës popullore, është munduar të nxjerrë prej andej disa nga ndodhitë dramatike, të ravigjetojë heronjë të njohur e të panjohur të kohës, të evokojë atmosferën e atyre viteve. Kuptohet, pra, pse shkrimtari ka zgjedhur si protagonist të romanit jo një figurë historike, po një kalorës, një nga pjesëtarët e Gardës pretoriane të Skënderbeut, kalorësin Mark Spani. Nga ana tjetër, po për këtë arsye, ai nuk është marrë aq me jetën politike e shoqërore të epokës, se sa me jetën private të njerëzve, me sfera familjare e intime, të cilat tërthorazi reflektojnë atmosferën e kohës. Kjo duket veçanërisht në vëmendjen e madhe që ai i ka kushtuar dashurisë së Mark Spanit me vajzën e bukur, Mira Mirashi, dashuri që është vënë në qendër të romanit. Rreth kësaj vajze vërtiten e ndërthuren ngjarje e interesa të ndryshme. Dashuria e tyre është një dashuri tipike kalorësiake, e shoqëruar plot me peripecira e sakrifica, me të papritura e fatkeqësi, me rivalitete e me të tjera tipare karakteristike për kohën e mesjetës.

Merita kryesore e romancierit është përpjekja që bën për të na e paraqitur heroin, nga një anë dashnor besnik e zemërzjarrtë, trim e kavalier, nga ana tjetër luftëtar të devotshëm të kauzës së madhe të atdheut, kalorës besnik ndaj Kryezotit të Krujës. Megjithatë, duke çmuar aq sa ka mundur të bëjë shkrimtari, lexuesi i sotëm do të kërkonte prej tij që këtë hero, pjesëtar të Gardës së Skënderbeut, ta shihte, ashtu sikurse i ka hije trimit, në radhë të parë në luftë kundër armikut, duke u lënë sa më pak vend aventurave të tij dashurore. Por autori, i tërhequr prej këtyre të

fundit, ka hedhur më shumë dritë në ngjarje e tipare të heroit që, veç vlerës njohëse për kohën, zor se mund të kishin ndonjë vlerë tjetër për lexuesin e sotëm. Po prapë, duke çmuar te heroi i romanit disa nga cilësitë e tij të qenësishme, dhe në radhë të parë patriotizmin dhe besnikërinë e tij të patundur ndaj Skënderbeut, Mark Spani mbetet një fytyrë pozitive. Këtë e bën më të qartë dhe dashuria e pastër që ai ka me Mira Mirashin. Mira është një figurë e hirshme në roman që të bën për vete me shpirtin e saj të dliërë; ashtu si dhe i ati, Zef Mirashi, një luftëtar i thjeshtë i lirisë, ajo ia ka blaturu ëndrrat dhe dëshirat e veta atdheut. Prandaj, kur ajo bie në duart e Selim Pashës, preferon më mirë të vdesë, se sa të bëhet gruaja e tij. Me besim në kauzën e shenjtë për të cilën lufton Kryezoti, Mira u bën ballë intrigave të Zanfinës, i demaskon ato dhe jep kontributin e saj në luftën për mbrojtjen e atdheut kundër agresorëve turq.

Figura e Skënderbeut, ndonëse episodike, ndihet në fatin e ngjarjeve dhe personazheve të romanit. Autori ka vepruar drejt, duke mos e trazuar Kryezotin me intrigat dhe aventurat dashurore, që ndodhin në vepër. Skënderbeu qëndron i madhërisëm sipër tyre, në ballë të popullit. Populli atë e quan diell që ngroh çdo zemër shqiptare. Ai i njeh emrat e zemrat e të gjithë luftëtarëve. Mendime të tilla thonë malsorët nëpër kuvende, luftëtarët para betejave, njerëzit e thjeshtë rreth vatrës. Ata e ndiejnë se Skënderbeu është i tyre dhe ata janë të Skënderbeut.

Populli në roman është paraqitur me ndërgjegje të lartë patriotike. Njerëzit e thjeshtë janë vizatuar me vetira më të mira se krerët, më atdhetarë e më fisnikë se ta, të patrembur para armikut më të fuqishëm të kohës. «Me ikë prej turkut — thotë një malësor — kishte me qenë baraz si me u trembë prej gomarit».

Është populli i thjeshtë ai që e mbështet Kryezotin në

gjithë veprimtarinë e tij historike. Ai përbën fuqinë dhe shpresën e Skënderbeut, ai është syri dhe grushti i çeliktë i udhëheqësit. Ushtrinë e Skënderbeut e mbushin malësorët e thjeshtë. Këta janë dhe njerëzit e Gardës së tij besnike. Populli lufton dhe vigjëlon në çdo kohë për Kryezotin. Nga kjo pikëpamje, një vlerë të rëndësishme ideore merr në roman figura e farkatarit Hilë Veshkuqit. Ky është një njeri i thjeshtë, po patriot, që në një moment të caktuar, në sajë të atdhedashurisë, di të shkëputet nga ndikimi negativ i Zanfinës dhe arrin t'i shpëtojë jetën Skënderbeut, duke zbuluar komplotin e Pyllit të Krrabës. Po kështu, është një shqiptar i thjeshtë jeniçeri Qerim, i cili i fshehur pas këtij emri, bën që të dështojnë planet djallëzore të Selim Pashës.

Për ndërgjegjen e zgjuar të popullit na tregon qëndrimi i lartë që mbajnë masat e malësorëve të Dibrës ndaj tradhtisë së Mojsi Golemit. Kur malësorët marrin vesh tradhtinë e turpshme të Golemit, shkëputen menjëherë prej ndikimit të tij, ata s'duan t'ia dinë për famën e hershme të heroit, po e dënojnë me të madhe aktin e ulët të Mojsiut dhe shtrëngojnë radhët rreth Kyetrimit të Krujës.

Haki Stërmilli ka mundur të përvijojë qartë dy tendencat karakteristike të kohës së Skënderbeut: prirjen gjithnjë e më të fortë të popullit për t'u bashkuar në luftë kundër qenit turk, nën udhëheqjen e heroit, dhe tendencat përçarëse të krerëve, për t'u shkëputur nga Skënderbeu, për t'u shmangur nga rruga e drejtë e historisë. Këtë të fundit, shkrimtari është përpjekur ta mishërojë në figurën e Mojsi Golemit dhe të shoqes së tij, Zanfinës. Duke bërë këtë gjë, ka pohuar një të vërtetë historike, sepse është e njohur botërisht tradhtia e Mojsi Golemit dhe roli intrigues i së shoqes në këtë ngjarje të shëmtuar. Autori thotë disa të vërteta tok, kur tregon episode e hollësi që flasin për lidhjet e Mojsiut e Zanfinës me pashën turk të Sfetigradit, për

komplotin e Pyllit të Krabës, për disfatën e Beratit e për ngjarjet që pasuan më vonë. Shkrimtari e ka paraqitur drejtë zemërimin e merituar që ngjalli në masën e malësorëve tradhtia e kreut të tyre. Populli përpjekjen e Mojsiut për t'i zënë vendin Skënderbeut e përqesh, duke e quajtur si përpjekje «me u mat me hijen e vet». Malësorët thonë: «Mojsiut i ka këcye mendja mbi kësulë e don me kapë qi-ellin me dorë. Këto vjetët e fundit ka nisë me i përqeshë petkat e veta.»

Në roman gjenden dhe momente të tjera, që hedhin dritë të vërtetë në historinë e Mojsiut, po në përgjithësi zbërthimi dhe zbulimi i figurës së Golemit është i njëanshëm e tendencioz jo për mirë. Shkrimtari nuk ka arritur dot t'i bëjë një analizë klasore qëndrimit separatist të feudalit të Dibrës, që e çoi në tradhti. Këtë gjë, ai e ka zëvendësuar me një arsye të dorës së dytë, me xhelozinë e të shoqes, Zanfinës ndaj motrës së Skënderbeut, Mamicës, e cila sikurse dihet ishte martuar me ish-të shoqin e saj, Muzak Topinë. Kjo e ka shtyrë autorin t'i japë në dorë Zanfinës një rrjetë të tërë intrigash, që kapërthejnë gjithë ngjarjet e romanit. Kështu, krijohet përshtypja sikur nuk janë interesat klasore ato që përcaktojnë fatin e njerëzve e të ngjarjeve, po intrigat e xhelozitë për interesa personale. Sigurisht, këto të fundit në mesjetë kanë luajtur rolin e tyre, po këto gjithnjë kanë qenë pasqyrim i konflikteve të thella shoqërore-politike. Autori e ka mbivlerësuar aq shumë rolin e Zanfinës, saqë personaliteti i njohur i Mojsiut është dhënë shumë i zbetë dhe në një dritë, do të thoshnim, të rreme. Po kështu, me ngjyra aventureske është vizatuar dhe dashuria (!!) e Selim Pashës, komandantit të kështjellës së Sfetigradit, për Mirën. Megjithëse ekzistonte një lloj paqe e përkohshme, e padeklaruar në atë periudhë në mes turqve e shqiptarëve, prapëseprapë, hyrjet e daljet në kështjellën e Sfetigradit është vështirë

të justifikohen, qoftë për të dhënë ngjyrat historike të kohës.

Figurën antagoniste të Gjergj Topisë në roman do ta quanim një figurë fatkeqe që nuk i shton ndonjë vlerë veprës. Autori është munduar ta vejë atë në rolin e një kalorësi rival dhe duke qenë rivali i heroit të romanit, ai përpiqet me pa të drejtë t'ia bëjë të urrejtshëm lexuesit. Rivaliteti për vajzën e bukur në mes të kalorësve në kohën e mesjetës ka qenë një gjë krejt e zakonshme dhe s'ishte nevoja që një figurë, si ajo e Gjergj Topisë, të vihej në rolin e intrigantit e të komplotistit, e një njeriu plot vese e pa asnjë virtyt.

Siç shihet, në roman veprojnë një mori personazhesh. Aksioni zhvillohet në vise të ndryshme të vendit, veçanërisht në Krujë e Dibër. Ngjarjet janë të shumta dhe pasojnë njëra-tjetrën me shpejtësi. Para lexuesit ndërthuren disa linja e plane të ndryshme. Kuptohet se shkriktari ka pasur përpara një varg detyrash të ndërlikuara ideoartistike dhe jo të gjithave ua ka dalë mbanë. Po prapë, vepra flet për seriozitetin dhe dëshirën fisnike të autorit që t'i japë lexuesit një roman edukativ, me vlerë patriotike e njohëse. Ai ka arritur të ndërtojë një roman që tërheq vëmendjen, qoftë për idenë e shëndoshë të vënë në themel të tij, qoftë për disa nga personazhet, qoftë dhe për një varg ngjarjesh të përshkruara hijshëm. Romani ka plot faqe të shkruara bukur që të bëjnë për vete. Lexuesit i mbeten në mendje figura, si ajo e Mark Spanit dhe e Mirës, e Hillës apo e Qerimit. Kurse për personazhet e tjerë, zor se mund ta themi këtë. Bile, është një veti e përgjithshme e shkriktarit që i kushton më shumë vëmendje përshkrimit të ngjarjeve, se sa botës së brendshme të personazheve. Ai merret pak me psikologjinë e tyre, rrëmon në mënyrë të pamjaftueshme në këtë sferë. Kjo ka sjellë që dhe shumica e personazheve të kenë mbetur të pa individualizuar.



Romani është shkruar me një gjuhë të punuar me kujdes e ndonëse nuk është sa duhet emocionale, prapë leximi bëhet i lehtë e i këndshëm. Për këtë ndihmon dhe thurja tërheqëse e subjektit. Vepra është shkruar sipas modeleve e romaneve historike të shkrimtarëve romantikë. Shumë episode janë përshkruar në plan romantiko-sentimental. Personazhet shpesh herë nuk ndjekin një zhvillim realist. Aksionin kryesor të veprës e përcaktojnë më të shumtat e herës intrigat, rastësia, aventurat, keqkuptimet. Këto bien në sy veçanërisht sot, kur letërsia shqipe ka ecur mjaft. Romani u shkrua në një kohë kur letërsia jonë e realizmit socialist po bënte hapat e para. Pra, nuk mund të mos merret parasysh kjo rrethanë. Megjithatë «Kalorësi i Skënderbeut» tregon se autori i tij, duke ndjekur vazhdën e shëndoshë të krijimtarisë së vet, është përpjekur me veprën e re të hedhë një hap përpara dhe kjo duhet parë në konceptin e drejtë historik të rolit të popullit, në evidencimin e atyre tipareve të Skënderbeut që i shërbejnë edukimit të brezit të ri, në goditjen që i jep klasës feudale. Rritja e autorit duhet parë dhe në pasurimin e mjeteve shprehëse, në perfeksionimin e aftësive prej tregimtari, marrë në krahasim me krijimtarinë e mëparshme.

1967

## MENDIMI TEORIKO-LETRAR NË VITET '30

Është me mjaft interes njohja nga afër e traditës së shëndoshë që kemi në fushën e mendimit teoriko-letrar në mesin dy luftrave botërore e sidomos në vitet '30. Dihet se kjo traditë i paraprin mendimit tonë të sotëm dhe i takon asaj merita që, për herë të parë, shtroi teorikisht dhe propagandoi në letërsinë shqipe disa nga elementët e estetikës materialiste, madje dhe marksiste.

Lufta e ashpër ideologjike që u zhvillua aso kohe në shoqërinë shqiptare preku, dhe nuk mund të mos prekte, dhe sferën e mendimit teoriko-letrar. Idetë revolucionare që rezatonte lëvizja komuniste në Shqipëri gjetën vend dhe në konceptet estetike të njerëzve të letërsisë.

Kritika letrare, që në vitet e fundit të Rilindjes vetëm sa u duk në horizontin e letërsisë shqipe, gjatë periudhës së pavarësisë shkoi drejt konsolidimit si gjini më vete. Për këtë një kontribut të çmuar dhanë forcat përparimtare që u morën me kritikë dhe përgjithësisht me probleme teoriko-letrare.

Puna e Fan Nolit kishte hedhur një gur themeli për një mendim të shëndoshë estetik në letërsinë tonë. Me introduktet e tij, ai kishte sjellë në mendimin shqiptar mjaft koncepte të drejta estetike duke iu kundërvënë vetvetiu koncepteve estetizante të Faik Konicës dhe pikëpamjeve idealiste-mistike të Gjergj Fishtës mbi artin. Militimi aktiv i Nolit në lëvizjen patriotike dhe demokratike e kishin ndihmuar shkrimtarin për të formuar një ideal

të shëndoshë estetik. Këtë ideal ai e kishte bërë të qartë nëpërmjet analizave e mendimeve që kishte shfaqur mbi veprat e përkthyer. Me to ai kishte treguar se ishte për funksionin shoqëror të artit, për prioritetin e brendisë dhe unitetin e saj me formën, për një analizë të veprave letrare të lidhur ngushtë me epokën dhe vendin, ai kishte çmuar rolin e ideve në krijimtarinë e artistit, ishte përpjekur t'i analizonte veprat të kushtëzuara nga botëkuptimi i shkrimtarit.

Të gjitha këto mendime të vyera, nuk mund të mos përbënin një mbështetje të mirë për shkrimtarët që u angazhuan në luftën ideologjike të viteve '30. Dhe është një koincidençë e rastit, por që merr kuptim në stafetën e luftës për konsolidimin e një mendimi të shëndoshë estetik, që në vitin 1932 Noli shkruan introduktin e tij të fundit (introduktin mbi «Don Kishotin») dhe tamam në këtë vit botohet dhe artikulli i parë nëpërmjet të cilit brezi i ri letrar hedh parullën për një letërsi realiste. Është fjala për artikullin e Nonda Bulkës «Horizonte të reja për letërsinë kombëtare», ku shtrohet si një domosdoshmëri historike nevoja e pasqyrimin me vërtetësi të jetës nëpërmjet trajtimit të problematikës sociale. Ai e shpallte anakronike atë letërsi që nuk merret me temat shoqërore të kohës, pasi letërsia, arsyeton ai, «s'është gjë tjetër, veçse shprehja, pasqyra e gjallë, e thellë dhe e vërtetë e ambientit shoqëror». Për këtë arsye, Nonda Bulka kërkon që letërsia shqipe të marrë drejtime të reja, ku në qendër të vëmendjes të vihet mjerimi i punëtorit dhe i bujkut, të paraqiten kontrastet e forta të shoqërisë shqiptare. Dhe si shembull pasqyrimi e trajtimi të tematikës së re, ai u jep shkrimtarëve shqiptarë realistët më të shquar bashkëkohorë Gorkin dhe Rolanin, Shoun dhe Drajzerin, Mannin dhe Sinklerin.

Është merita e brezit të shkrimtarëve të rinj, që me gjithëse u mungonte përgatitja e plotë teorike dhe qenë të

rinj në moshë e në letërsi, prapë këto nuk i penguan, për të shtruar teorikisht nevojën e një letërsie realiste, për ta tërhequr vëmendjen e shkrimtarëve nga «drejtimet e reja letrare». Duke përfituar nga disa mundësi të vogla që u krijuan për shtypin përparimtar aty nga mezi i viteve '30, ata e shfrytëzuan këtë për të shpallur e argumentuar mendimet e konceptet e tyre letrare e estetike. Në revistat «Flaga», «Rilindja», «A.B.C.» e veçanërisht në revistën «Bota e re» u botuan një numër artikujsh teoriko-letrarë mbi karakterin shoqëror të letërsisë dhe domosdoshmërinë e lidhjes së saj me jetën e kohës, si kusht kryesor për të ekzistuar një letërsi e vërtetë. Për ta një gjë e tillë nuk mund të arrihej pa i dhënë letërsisë një drejtim realist. Bile duhet thënë se, ndonëse një pjesë e këtyre shkrimtarëve të rinj kishin ndikime nga simbolizmi dhe letërsia romantike-sentimentale, prapë këto nuk i penguan të shtronin drejt thelbin e mjaft problemeve dhe të ngrinin si një nevojë imperative krijimin e një letërsie realiste. Artikujt e Dhimitër Shuteriqit, Nonda Bulkës, Andrea Varfit, Misto Treskës, Sterjo Spasses, etj. përbëjnë një kontribut qenësor, që brezi letrar i viteve '30 dha në fushën e mendimit tonë teoriko-letrar. Mendimet e tyre qenë e vetmja forcë që iu kundërvu dhe luftoi kritikën klerikalo-borgjeze, e cila me teoritë e veta anakronike orvatej ta shkëpuste letërsinë nga jeta e gjallë, ta mbante lidhur pas zinxhirëve të klasicizmit e romantizmit reaksionar. Shkrimtarët e rinj përparimtarë shpallën me guxim se «Duhet të jemi realistë sa të jetë e mundur më shumë...» e «... të paraqisim jetën ashtu siç është...», se «duhet të nisemi nga jeta» dhe «të mos kufizohemi me ndjenjat e dhimbjet vetiake», po të jepen ëndrrat, idealet, shqetësimet e përgjithësisht jeta e turmës, ku shkrimtari merr pjesë. «Bota e re», duke zbërthyer detyrat e shkrimtarëve shkruante se «Shkrimtari ka për detyrë të qajë ha-

llet e bujkut, e bariut, e nëpunësit, e zanatçiu, e proletaria-  
tit...». Autorët e këtyre mendimeve janë të ndërgjegjshëm  
se pasqyrimi me vërtetësi i jetës së popullit, nuk mund të  
arrihet me metodat e perënduara letrare, me forma të vje-  
tëruara e të kapërcyera. Për ta është e qartë se detyrën e  
një letërsie kombëtare nuk mund ta kryente arti klasik,  
as romantizmi apo edhe një letërsi sentimentale. Misionin  
e saj kombëtar letërsia shqipe do ta përmbushte vetëm du-  
ke u bërë një letërsi realiste. Prandaj, shkrimtarët e rinj iu  
vunë punës për të sqaruar rrethet letrare dhe opinionin  
shoqëror se ç'është realizmi dhe cilat janë parimet kryesore  
të kësaj metode krijuese. Duke vënë në dukje se shkrimta-  
rët e kësaj metode i bashkon botëkuptimi, mënyra e pasqy-  
rimit të jetës, problemet e temat, ata në të njëjtën kohë  
sqaruan se parimet e pasqyrimin realist nuk preknin indi-  
vidualitetin e krijuesve. Me këtë mënyrë shkrimtarët për-  
parimtarë hapnin horizonte të reja për letërsinë shqipe në  
një kohë kur shtypi kleriko-borgjez dhe vetë kritika zyrtare  
jepnin alarmin «për shterpësi letrare» dhe e vështro-  
nin me pesimizëm të ardhmen e letërsisë sonë. Duke e shkë-  
putur letërsinë nga jeta e problematika e saj sociale, duke  
i mohuar një ideal të gjallë shoqëror, duke e lidhur atë  
pas formave të vjetra ose duke u joshur pas izmave të  
letërsisë dekadente, kritika klerikalo-borgjeze e fuste le-  
tërsinë shqipe në qorrsovak. Kurse shkrimtarët e rinj,  
duke qenë të lidhur me lëvizjen komuniste e demokratike,  
sillnin në letërsinë tonë, në rrethanat e reja historike, një  
ideal të rëndësishëm shoqëror që do të ishte burimi i gjal-  
llesës së artit të vërtetë.

Shkrimtarët e rinj nuk kërkonin një pasqyrim të çfar-  
doshëm të jetës shqiptare, po një pasqyrim nga pozita të  
caktuara, të nisur nga një qëllim i rëndësishëm. Me këtë,  
ata shpreheshin për një letërsi tendencioze, për tendencio-  
zitetin në krijimtarinë letrare. Tendencioziteti nënkupton-

te, jo vetëm të kritikuarit e shoqërisë feudo-borgjeze dhe zbulimin me guxim të së vërtetës, po dhe përcaktimin ideo-emocional të pozitës e të anësisë së shkrimtarit në pasqyrimin e fenomeneve social-psikologjike. Shkrimtari, simbas tyre, nuk bën fotografim të realitetit, por e pasqyron jetën nëpërmjet ndërgjegjes shoqërore. Kuptohet se këtu është fjala për idealin shoqëror të shkrimtarit, për botëkuptimin që duhet ta udhëheqë atë në veprimtarinë krijuese. «Shkrimtari e artisti — shkruante Dhimitër Shuteriqi — nuk është si një pllakë fotografie, ku jeta vizatohet me përpikmërinë e saj më të imtë, ay e shikon jetën nëpërmes ndërgjegjes që ka formuar...»

Edhe çështjen e lirisë së krijuesit autorët e rinj e shtrojnë drejtë kur e lidhnin me realitetin konkret historik. Liria e krijimit nuk kuptohet si diçka absolute dhe e pakufizuar, por e kushtëzuar nga rrethanat social-historike.

«Liria, — pohonin ata — në një vepër letrare është e domosdoshme. Po duhet një liri e kufizuar dhe jo e plotë». Për ta, shkrimtari është luftëtar i një ideali dhe krijimtarinë e vet duhet t'ia nënshtrojë interesave të luftës për triumfin e këtij ideali.

Kritika përparimtare në vitet '30 u përpoq të sqarojë teorikisht e t'i hapë rrugën një letërsie realiste në vendin tonë. Prandaj në artikujt e botuar u fol jo vetëm mbi nevojën imperative të realizmit, si metodë krijuese për shkrimtarët shqiptarë, për temat «e virgjëra», siç e cilësonin ata problematikën e mprehtë shoqërore, por u shfaqën mendime dhe për gjinitë letrare, që do të ndihmonin për ta vënë letërsinë shqipe në rrugën e realizmit. Pa mohuar rolin e llojeve të vogla letrare, si të vjershës e të tregimit, ata shpjeguan se zhvillimi i një letërsie realiste nuk mund të kuptohet pa prioritetin e prozës së gjatë e të dramës, si dy gjini që kanë mundësi më të mëdha pasqyrimi të jetës. Ata kërkonin që realiteti shqiptar të dilte në letërsi përmes

tablosh të gjera dhe këtë mund ta arrinin kryesisht format e epikës narrative, ashtu siç kërkonin dhe zhvillimin e dramës, nëpërmjet së cilës do të mund të jehonin fuqishëm idetë e reja, mbasi për ta teatri «nuk ishte vetëm vend dërimi, po në radhë të parë shkollë e turmave».

Brezi letrar i viteve '30, duke u angazhuar në luftën ideologjike të kohës, u mor dhe me çështje teorike që kishin të bënin me disa nga parimet kryesore të artit realist. Në radhë të parë atyre iu desh të vënë në dukje se arti është një fenomen shoqëror dhe se ka karakter klasor. Një pohim të tillë të qartë e bënin në një kohë kur kritika borgjeze-klerikale propagandonte me të madhe në shtypin letrar koncepte idealiste, duke e paraqitur artin si diçka në vetvete, jashtë marrëdhënieve klasore dhe larg qëllimeve politike. Mendimit për ta zhveshur artin nga funksioni shoqëror dhe për t'i hapur rrugën formalizmit në letërsinë shqipe, iu kundërvunë pikëpamje estetike materialiste mbi artin. Kritika përparimtare shpjegoi se art jashtë shoqërisë nuk ka dhe nuk mund të ketë. Ajo luftoi kundër mendimeve për një art formalist dhe apolitik që predikonin Branko Merxhani, Vangjo Nirvana, Gjergj Kuka me shokë.

«Art për art, — shpallte kritika përparimtare, — është në vetvete një sofizëm nga më të bukurat. Është një sofizëm sepse arti nuk është një gjë që ka një jetë më vete; arti ka një jetë vetëm me krijonjësin, me njeriun, po dhe ky nuk ka një jetë më vete; çdo njeri është përfaqësuesi i shoqërisë ku lind dhe i kulturës e edukimit që merr, ka sigurisht dhe gjëra që janë vetëm të tijat, po që të tëra i ka futur në kallëpin e shoqërisë dhe të edukimit që merr. Nga ky kallëp do të dalë një prodhim shoqëror, prandaj si çdo prodhim tjetër, shoqëria e bën artin për nevojat e saj».

Kritika përparimtare, duke e parë artin si fenomen shoqëror, e trajtoi drejtë dhe raportin e brendisë me formën. Ndryshe nga mendimi zyrtar që i jepte prioritet formës

dhe e absolutizonte atë ajo e vuri theksin në brendinë dhe kushtëzoi vlerën e një vepre artistike, në radhë të parë nga brendia. Mendimi përparimtar vuri në dukje rrezikun e formalizmit dhe të këqijave që rridhnin prej tij; shtroi nevojën e një brendie të shëndoshë si kusht i domosdoshëm për një letërsi të vërtetë. «Ne, — shkruante një nga letrarët përparimtarë, — duke dashur të bëjmë një punë të mirë, duhet të shikojmë dhe të bëjmë atë që shërben».

Brendinë, kritika e lidhte me detyrën e shkrimtarit që «të qajë hallet e popullit», që motoja e tij të jetë «bota që e rrethon» dhe me artin e vetë «të japë kohën në të cilën rron». Prandaj kritika përparimtare u ngrit kundër veprave pa ide, kundër atyre krijimeve që s'paraqesin «kohën dhe jetën që rrojmë», «jetën e turmës ose të paktën një pjesë të saj». Ajo kritikoi ata poetë që shpreheshin me vargje «të errëta, romantike, subrealiste», ata që «nuk kanë drejtim» dhe orientoi letrarët e rinj që të frymëzohen nga «Bota e këngës popullore, nga idealet e reja». Por, duke vënë theksin te brendia, te mendimi me vlerë shoqërore që duhet të karakterizojë çdo vepër serioze, kritika përparimtare nuk harronte e as nuk nënvleftësonte formën, si komponenti tjetër i domosdoshëm, pa të cilin nuk mund të kuptohet asnjë krijim artistik. «Vetëm kur ndjenja e mendimi janë të bashkuara me artin, — pohonte Nonda Bulka — kemi një vepër të vërtetë artistike». «Nuk mjafton të kesh një ide, po duhet ta thuash dhe bukur». — këshillonte letrarët e rinj «Bota e re».

Shkrimtarët përparimtarë u morën në vitet '30 dhe me problemin e karakterit kombëtar dhe popullor të letërsisë. Kjo përbënte një çështje teorike dhe praktike njëkohësisht. Për kritikën borgjeze-klerikale gjithë thelbi i këtij koncepti reduktohej në anën e jashtme. Me karakterin kombëtar dhe popullor të letërsisë së një vendi, ajo kuptonte përshkrimin e zakoneve e të dokeve, të ngjyrave lokale e të



atmosferës së lashtësisë, me një fjalë paraqitjen e elementëve folklorikë dhe etnografikë. Fulvio Kordinjano dhe Ernest Koliqi, duke u marrë me këtë problem nga pozita idealiste e metafizike, futnin në mendimin shqiptar të kohës koncepte të huaja e të shtrembëra, çoroditnin opinionin, largonin vëmendjen nga thelbi i problemit.

Kritika përparimtare nocionet mbi karakterin kombëtar dhe popullor të artit i shikonte në thellësi dhe gjerë. Ajo nisej nga mendimi që elementët folklorikë dhe etnografikë përbëjnë anën e jashtme dhe jo qenësore në një vepër, se ato janë elemente plotësues dhe të përkohshëm, se këto koncepte nuk kishin të bënin vetëm me çështje forme e mjetesh shprehëse, siç donin ti paraqitnin. Për kritikën përparimtare bazën e karakterit kombëtar e popullor e përbënin pasqyrimi me besnikëri i jetës dhe aspiratave të popullit, dhënia e shpirtit të tij, paraqitja e atyre tipareve qenësore që e kanë shoqëruar popullin gjatë tërë historisë së tij.

Në kushtet e shoqërisë shqiptare të viteve '30, kur kontradiktat klasore sa vinin e ashpërsoheshin dhe hendeku në mes popullit dhe klasave sunduese thellohej, nocioni mbi karakterin kombëtar merrte një përmbajtje të re. Karakteri i përgjithshëm kombëtar e popullor i letërsisë sonë të Rilindjes nuk ekziston më. Tani vija e demarkacionit në mes letërsisë përparimtare e demokratike dhe letërsisë borgjeze-klerikale ishte e qartë. Vetëm letërsia që merrej me problemet e vërteta të shoqërisë shqiptare dhe i shikonte nga pozitë e interesave të popullit dhe me sytë e popullit, mund të kishte karakter të mirëfilltë kombëtar dhe popullor.

«Duke folur për popullin, — theksonte Dhimitër Shuteriqi aso kohe, — literatura bëhet tamam kombëtare. Është i gënjeshtërt ay mendim që thotë se literatura bëhet kombëtare duke u marrë me heronjtë e një kombi... kombin

e formojnë tërë masat e tij. Literatura për të qenë kombëtare nuk merret vetëm me heronjtë, se ata rrojnë të ndritur edhe në histori d.m.th. pa literaturë, kjo duhet të merret me popullin e kombit në fjalë...».

Shkrimtarët e rinj më të avancuar në vitet '30, kishin në përgjithësi një koncept të drejt mbi popullin; me popullin ata kishin parasysh njerëzit e punës, të shtypurit e të shfrytëzuarit, ata që përbënin shumicën e kombit. Dhe sipas tyre letërsia duhet të shkruante në radhë të parë për këta dhe duke bërë këtë, kjo do të përcaktonte, jo vetëm karakterin e saj popullor, por dhe atë kombëtar. Është meritë e këtyre shkrimtarëve që duke e marrë letërsinë si fenomen shoqëror, ata kërkonin që letërsia të ecte me kohën, të zhvishej nga format e vjetra, të hidhte poshtë rekuizitën e së kaluarës e të përqafonte koncepte të përparuara estetike, gjë që do të krijonte mundësinë për t'u pasqyruar në veprat letrare shpirti i popullit, aspiratat e tij, bota dhe psikologjia shqiptare. Kjo është arsyeja që në konceptet e tyre mbi karakterin kombëtar e popullor të letërsisë, ata nuk përjashtonin kurrsesi formën, po përkundrazi. Shkrimtarët e rinj mendonin se fryma shqiptare e popullore e letërsisë shfaqej nëpërmjet larmisë së formave kombëtare, të mjeteve karakteristike shprehëse, të mënyrës së paraqitjes, në përputhje me psikologjinë e një-mëndësinë e popullit. Për këtë kritika përparimtare shtronte nevojën e demokratizimit të formës, kërkonte një shprehje të qartë e të kuptueshme për masën e lexuesve.

Këto ishin në vija të përgjithshme disa nga çështjet teoriko-letrare që ngritën shkrimtarët e rinj përparimtarë në vitet '30. Problemet qenë të vështira, të ndërlikuara dhe të shumta. Barra që u ngarkonte çasti historik ishte e rëndë. Shumë prej tyre u mungonte pregatitja e nevojshme ideoestetike dhe jo për të gjitha çështjet që ngritën ata ishin të qartë. Për më tepër qenë të rinj në moshë dhe

në letërsi, po të gjitha këto nuk i penguan që me guximin e ideve prej të cilave frymëzoheshin të luftonin me kundërshtarë të përgatitur e me autoritet për kohën. Nga ana tjetër, kjo luftë zhvillohej në kushtet kur lëvizja komuniste e demokratike kishte dobësi që tanimë njihen, dhe kur presioni i ideologjisë borgjeze ishte i fortë e i gjithanshëm.

Po megjithatë, shkrimtarët e rinj kryen një punë prej pionieri. Duke propaganduar koncepte të drejta estetike, duke folur për nevojën e një drejtimi realist të letërsisë, duke hedhur dritë mbi disa parime kryesore të artit, ata luftuan me guxim kundërshtarët e tyre ideologjik.

Puna e tyre e çmuar krijoi në historinë e mendimit estetik shqiptar një traditë të shëndoshë që ruan vlerën aktuale dhe sot e gjithë ditën. Mbi të gjitha, ata hodhën farën e besimit për një letërsi të re dhe këtë e shprehte bukur Nonda Bulka kur shkruante:

«Me dashka ose padashka, një letërsi e tillë do të agojë. Një yll po perëndon, një tjetër është në ndriçim e sipër. Shqipëria djaloshare filloi të lindet. Shqipëria plakë po heq shpirt. Natyra ka caktuar ligje që njeriu nuk i heq dot. Bota ecën përpara dhe vitet rrokullisen. Një brez i vjetër ikën e venitet. Kodi i pashkruar dhe i pandryshueshëm i natyrës kështu thotë dhe kështu do të bëhet».

1972.

## SATIRA E CHRI-CHRI-ut

Vlerat e letërsisë sonë demokratike akoma nuk janë zbuluar dhe njohur plotësisht nga publiku i gjerë. Dihet se shumë krijime të shkrimtarëve tanë përparimtarë nuk patën fatin në kohën e tyre të botoheshin në libra, po mbetën të shpërndara nëpër faqet e shtypit. Botimi i këtyre shkrimeve në përmbledhje të veçanta, që po vazhdon prej disa vjetësh, është një inisjativë shumë e mirë. Kjo ka shërbyer jo vetëm për të pasuruar fondin e letërsisë sonë, por i ka dhënë në dorë masës së lexuesve vepra me vlera artistike dhe njohëse. Këtë e dëshmojnë fare mirë dy librat e Nonda Bulkës (Chri-Chriut) «Kur qante e qeshte bilbili», (1962) dhe «Maska të çjerra». (1966). Dhe themi një të vërtetë, po të pohojmë që në krye, se krijimtaria e shkrimtarit Nonda Bulka, pjesa më e madhe e së cilës është përmbledhur në këto vëllime, përbën një nga faqet më të bukura të letërsisë sonë realiste të viteve '30. Nonda Bulka është një nga pionierët e asaj letërsie, që me Migjenin në krye u vu në opozitë të hapur me shoqërinë feudoborgjeze dhe i parapriu letërsisë sonë të realizmit socialist. Këtë përshtypje kemi kur lexojmë përmbledhjen e re me shkrime të «vjetra»: «Maska të çjerra». Vetë titulli i librit na prezanton karakterin e shkrimeve që përfshihen në të. Janë fejtone, skica satirike, tregimthe, të shkruara e të botuara gjatë më shumë se një dekade (1932-1944). Mjaft prej tyre kanë në themel çështje të ditës, probleme të kohës kur u krijuan, po edhe pse janë shkruar shumë vite më parë,

prapë e kanë ruajtur vlerën e vet ideoartistike. Kur lexon ato, të bën përshtypje talenti gjithnjë i freskët i autorit, po më tepër të tërheq vëmendjen pozita mjaft e përparuar nga e cila ai i ka dhënë këto vepra. Duke qenë nën ndikimin e lëvizjes demokratike të kohës dhe i ushqyer nga ide revolucionare, Nonda Bulka me shkrimet e veta u bë zëdhënës i aspiratave të popullit të shtypur. Shumë ngjarje dhe fenomene të kohës ai i ka parë shpesh herë nga lartësia e perspektivës historike dhe prej këndeje rrjedh ai tendenciozitet aq i qartë e aq pozitiv që përshkon veprën e tij tej e mbanë. Shkrimtari e ka përcaktuar pozitën e vet: në radhë të parë ai përpiqet të mohojë botën e vjetër, të tallet e të dënojë çdo gjë që është kundër aspiratave të popullit dhe interesave të Shqipërisë. Fryma satirike, ato nota të fuqishme ironie dhe sarkazma që gjejmë në veprën e N. Bulkës nuk janë një gjë e rastit. Sarkazma e tij i ka bërë jehonë qëndrimit të papajtueshëm të popullit ndaj rendit të feudo-borgjezisë.

Nuk ka sferë të jetës shqiptare dhe të problemeve që preokuponin atëherë botën që të mos kenë tërhequr vëmendjen e shkrimtarit tonë. Atë e shqetëson fati i popullit, i Shqipërisë, i kulturës sonë, fati i njerëzimit, i paqes, i qytetërimit. Për të është e qartë se në botë ka të shtypur dhe shtypësa dhe në mes tyre zhvillohet një luftë për vdekje, se detyra e tij si shkrimtar është të ndihmojë për triumfin e së drejtës dhe e së vërtetës, të marrë anën e atyre që vuajnë e luftojnë, se bota duhet ndërtuar ndryshe nga ç'është. Ai e thotë hapur se armiqtë e popullit dhe të përparimit janë borgjezia, imperializmi, fashizmi, feja, dhe se gjersa të ekzistojnë këto, njerëzimi gjithnjë do të ketë telashe e të këqia të mëdha. Duke dashur të thotë se shoqëria e vjetër është ndërtuar mbi baza të padrejta, autori me ironi ia vesh këtë si faj perëndisë, dhe i quan gabime të saj («Të gjitha gabime»). Një ndërtim i tillë i shtrem-

bër i botës sjell kriza të herëpashershme që e bëjnë popullin të vuajë («Fajtori»). Edhe krizat qeveritare në Shqipëri ishin refleksi i gjendjes së rëndë që kalonte vendi. («Lajme telegrafie»). Paraja në shoqërinë borgjeze është zot i çdo gjëje («Floriri»). Përderisa është në fuqi një zot i tillë, s'ka si të ekzistojë drejtësia e vërtetë, domosdo që do të ketë shtypje, vuajtje, luftë («Intervistë me malësorin»). Për të fshehur punët e tyre të këqia, ata që drejtojnë fatet e kësaj bote të padrejtë, kanë veshur të gjithë maska dhe autori i quan karnavale («Maska të çjerra»). Sipas autorit gjithë historia e përbotshme mund të përmbledhet në gjashtë fjalë: «I vogli shtypet nga i madhi» («Historia e botës në gjashtë fjalë»). Ky është ligji që sundon në shoqërinë me klasa.

Sa aktuale tingëllon sot satira e N. Bulkës ndaj manevrave dhe lodrave demagogjike të fuqive imperialiste për çarmatimin! Ai e quan këtë ironi të shekullit. Kjo ndodh dhe në ditët tona, me të vetmin ndryshim se sot imperializmi e lot këtë farsë bashkë me revizionistët modernë.

Një vend me rëndësi në shkrimet e N. Bulkës zë lartësimi dhe mbrojtja e traditave të popullit tonë. Ai ngrihet me zemërim si kundër denigruesve të jashtëm, ashtu dhe atyre të brendshëm. «Redaktori i enciklopedisë italiane» e quan Shqipërinë një krahinë turke, në një kohë kur Zogu e klika e tij e konsiderojnë Italinë fashiste aleaten e tyre të madhe! («Gjysmë ore jo shqiptar»). Faik Konica mundohet të hedhë baltë mbi fytyrën e Naim Frashërit, në një kohë kur është ministër i Zogut në SHBA («Faik Konica kundër Naimit»). Si njeri rast dhe tjetri, do të thotë autori tërthorazi, janë shfaqje të të njëjtit fenomen: shoqëria e vjetër i fyen popujt e vegjël dhe i mohon edhe vlerat më elementare.

Shkrimtari është marrë dhe me çështje të tjera, si me demaskimin e fashizmit në Gjermani dhe të imperializmit

japonez; godet antisemitizmin; tallet me konferencën e përbotshme ekonomike; vë në lojë ministrat e «baballarët e kombit», duke mos kursyer ironinë e tij therëse edhe ndaj Musa Jukës, që ishte atëhere xhandar për shtypin dhe letërsinë përparimtare; u çjerr maskën ideologëve, gazetarëve, diplomatëve të borgjezisë që duan t'u hedhin hi syve njerëzve. Në shumë shkrime penda e mprehtë e shkrimtarit realist është kthyer në një armë goditëse kundër armiqve të popullit, të Shqipërisë dhe të progresit. Kudo ne ndiejmë patosin e autorit, dashurinë e tij të thellë ndaj çdo gjëje popullore, demokratike dhe urrejtjen e fuqishme ndaj botës së vjetër, ndaj ligjeve të saj, ndaj moralit dhe filozofisë së saj obskurantiste.

Forma e shkrimeve të Nonda Bulkës është diktuar nga nevojat imperative të kohës, nga problemet që e shqetësonin shkrimtarin, nga idetë që ka dashur t'u kumtojë lexuesve. Kryesisht Nonda Bulka është shkrimtar satirik. Satira e tij e fortë është refleksi i qëndrimit mospajtues ndaj shoqërisë feudo-borgjeze. Vetëm me armën e humorit, vetëm me anën e të qeshurit, ai mund të tallte dhe godiste botën e vjetër. Gazi i Nonda Bulkës, ishte gazi shpotitës i popullit që edhe në momentet më të vështira të historisë së tij ka ditur jo vetëm të luftojë, por edhe të qeshë me armiqtë e vet. Prandaj të marra së bashku, fejtonet e skicat e N. Bulkës mund t'i quajmë një kronikë satirike të kohës, po jo një kronikë të thjeshtë. Talenti i shkrimtarit ka ditur të bëjë përgjithësime të rëndësishme dhe t'i japë këto përmes mjetesh artistike me vlerë. Shumica e shkrimeve nuk kanë subjekt, atyre shpesh u mungon fabula. Vlera e fejtoneve dhe skicave qëndron tek ajo që thotë dhe si e thotë, te mendimi i mprehtë dhe ideja e guximshme. Në 'to nuk ka rëndësi fabula, aksioni, thurja tradicionale, por forca ideoemocionale, do të thoshim, ajo që mohon ose pohon me të madhe. Dhe mjetet që ai përdor për të para-

qitur këtë formë letrare dhe publicistike, ky gërshetim mjetesh nuk është një gjë e rastit: duke trajtuar probleme vitale e delikate, duke dashur të kumtojë ide të guximshme, duke i shtjelluar këto nga pozita luftarake, Nonda Bulka i ka lënë mënjanë stërholimet letrare dhe shpesh herë i ka paraqitur gjërat hapur, troç, në mënyrë që ato të bëjnë sa më shumë rezonancë. Nga kjo vjen, ndoshta, dhe mungesa e karaktereve, e tipave të plotë. Ata janë të porsa skicuar dhe, në qoftë se flasim për një figurë të plotë dhe unike në gjithë shkrimet e tij, ky është vetë autori, të cilin e ndiejmë të gjallë, të afërt, të mprehtë pas çdo shkrimi.

Nonda Bulka ka ditur t'i përdorë me zhdërvjelltësi dhe me vend mjetet figurative. Alegoria, simboli dhe metaforat e ndryshme në shkrimet e tij kanë një përmbajtje konkrete dhe ide të caktuara. Me gjithë gjuhën figurative, prapë ai ka mbetur i qartë dhe i kuptueshëm. Kurse stili është mjaft origjinal: energjik dhe elegant, ai ruan një lloj ritmi që është karakteristik për mënyrën e tij, di të komunikojë lehtë me lexuesin.

Fejtonet dhe skicat satirike të N. Bulkës mbeten një kontribut i shquar në zhvillimin e letërsisë sonë realiste; ai e çoi më tej traditën e Çajupit e të Nolit dhe e afroi atë me letërsinë e ditëve tona. Nga ana tjetër, shkrimet e tij na japin një shëmbull pozitiv të lidhjes së shkrimtarit me aktualitetin, të vështrimit të problemeve të mëdha të ditës nga pozitat e përparuara të kohës.



## TRASHËGIMI LETRAR I QEMAL STAFËS

Trashëgimi letrar i Qemal Stafës, sado i paktë, bart në vetvete një pjesë të botës së tij ideoemocionale. Shkrimet që ai na ka lënë janë vetëm shkëndia të flakës, që i përfitonin idetë e larta, të cilat e udhëhiqnin në jetë, shkëndia të shpirtit të zjarrtë revolucionar, të emocioneve të thella, të interesave të gjithanshme, gjithnjë me prirje nga e vërteta komuniste dhe lufta për kauzën e komunizmit.

Qemali nuk arriti dot të shprehte gjithë sa dëshironte. Kënga e tij u këput që në hovet e para, tek merrte fluturim. Dhe ajo mbeti përjetë këngë hovesh të para.

Qemali nisi të debutojë në letërsi, në një moshë fare të re, kur ishte pothuajse ende fëmijë. Duke qenë nga natyra i zgjuar e i hollë, i ndjeshëm e studjues, vrejtesë e këmbëngulës, talenti i tij spikati dhe ai krijoi qysh herët shkrime letrare që tërhoqën vëmendjen. Kontakti i drejt-përdrejtë me jetën e vështirë të popullit, përqafimi i ideve revolucionare, leximi i letërsisë përparimtare, i hapën atij horizonte të reja dhe i ushqyen talentin.

Provat e para janë hartimet e bukura që shkroi në bangat e shkollës. Këto punë modeste u çmuan që atëherë nga mësuesit dhe shokët e tij. Ndonjë prej tyre, bëri jehonë dhe jashtë klasës.

Pas hartimeve, me punë këmbëngulëse, Qemali kaloi në krijime të vërteta letrare. Disa, dhe këto qenë pak, i bo-

toi në shtypin përparimtar të kohës, kurse pjesa më e madhe mbeti në dorëshkrim.

Që në fillim, Qemali e mori letërsinë me dashuri e seriozitet. Ai e kuptoi me kohë se letërsia nuk është një mjet argëtimi. Që në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, ai shkruante: «Arti i deritanishëm, që veç trajtës së bukur nuk ka tjetër cilësi, nuk i përmbush nevojat tona. Ç'më duhet mue një poezi e bukur në trajtë, por e vorfën në idena!»

Prandaj shkrimtari, sipas Qemalit, në rast se synon që vepra e tij të ketë vlerë e t'u shërbejë njerëzve, duhet që në themel të saj të vejë ide të shëndosha, të pasqyrojë realisht shoqërinë e ndarë në klasa, të luftojë padrejtësitë shoqërore, të bëjë hero të vetin njerëzit e popullit. Dhe kur lexon shkrimet e Qemalit, e ndien se tema kryesore e tyre është mjerimi i popullit shqiptar, pakënaqësia dhe revolta ndaj rendit shfrytëzues të kohës.

Le të kujtojmë skicën e njohur «Qortimet e vjeshtës», që me të drejtë mund ta merrim si kredon letrare të tij. Duke na dhënë fatin e mjerë të një gështenjapjekësi plak, nëpërmjet skenash të thjeshta, po shprehëse, me detaje të gjetura, me një notë dhimbjeje e proteste feminare, mban hapur anën e njerëzve të thjeshtë dhe ngrihet me zemërim kundër padrejtësive shoqërore. Ideja e shëndoshë që e përshkon gjithë skicën del akoma më e qartë në fund, kur mbyllet me këto fjalë:

«U largova me një premtim dhe një dënim në zemrën time. Dënova shoqërinë njerzore, premtova...»

Nota kryesore e krijimeve të Qemalit është revolta, qëndresa. Autori i ri tërhiqet jo aq nga mjerimi, se sa nga lufta për të mos u pajtuar me padrejtësitë shoqërore. Ai kërkon të japë figura njerëzish, që nuk mposhten para vështirësive e që me stoicizëm u qëndrojnë besnikë idealeve të veta. I tillë është detari i skicës «Nënshtypje kaltër-

sie», i cili i rrahur dhe i kalitur nga furtunat e jetës, me besim të patundur në forcat e veta, refuzon çdo mëshirë e lëmoshë «Ai nuk kërkon mëshirë — shkruan autori. — Porsa dallon një gjurmë të lehtë keqardhjeje mbi fytyrën time, qesh e këndon me za. Përmes gojës së tij më flasin mijëra burra, që bajnë të njajtën jetë». Qemali do t'u paraqesë bashkëkohësve të tij shembullin e njeriut, tek i cili spikat forca dhe qëndresa.

Simpatia për njerëzit që ndiqeshin e burgoseshin nga qeveritarët, e ka shtyrë të ravijëzojë portretin e një të burgosuri në skicën letrare «Rreze frëngjijash».

Mjaft interesant e i përshkuar nga një koncept materialist paraqitet shkrimi «Portreti i Skënderbeut». Pasi karakterizon drejt figurën e Heroit Kombëtar, nënvizon ndërmjet të tjerash se udhëheqësi i vërtetë i popullit duhet t'i shembëllejë Skënderbeut dhe se pas një prijësi të tillë çdo njeri është gati të vdesë. Aluzioni i autorit për kohën është i qartë; përpara personalitetit të madhërisëm të Skënderbeut, feudali i Matit, Ahmet Zogu, që ishte vetëshpallur mbret e që shtypte popullin, s'ishte gjë tjetër veçse një karnaval.

Për ide mjaft të përparuara në një moshë fare të re, dëshmon shkrimi i njohur «E vjetra shembet, kohët po ndryshojnë; një jetë e re po lulëzon gjërmadhash». Aty është sintetizuar gjithë botëkuptimi i komunistit të ardhshëm.

Ai shpall me guxim që në bangën e shkollës se: «...asht gja e domosdoshme ta ndryshojmë ndamjen e sotme të pasunisë (gja e vjetër) e ta zavendësojmë me një ndamje të dytë e të njëjshme (gja e re). Rusët e kanë ba që me kohë: shembull ky se e vjetra shembet. Edhe na do ta bajmë».

Ky shkrim të habit për thellësinë e mprehtësinë e mendimeve, për një formim të parakohshëm. Ishte vetëm pesë-

mbëdhjete vjeç kur shprehej kështu e kërkonte në emër të brezit të ri që po vinte, ndryshime në themel të shoqërisë shqiptare.

«Vetëm të rinjtë mund ta organizojnë një shoqëri të re shqiptare — shkruan Qemali («Qëllimi ynë»), — thomi të rinjtë, pse tue mos pasun lidhje me të shkruemen, vetëm ata janë në gjendje me i shikue çështjet me syun e kohës sonë. Thomi të rinjtë, pse vetëm ata janë në gjendje me i shti në punë energjitë e tyne të reja për një punim sistematik, pse janë të zhveshun prej mbeturinave të kohëve të kalueme».

Megjithëse ishte shumë i ri, këto mendime e radhisin me brezin e shkrimtarëve përparimtarë të viteve '30. Ai, si nga idetë, ashtu dhe nga trajtat që mori letërsia aso kohe, ishte i afërt me ta. Kështu, në këto vite, Qemali nën shembullin e Migjenit e të vëllait, Veliut, që shkruante me pseudonimin Platonicus, lëvroi llojet e vogla të prozës tregimtarë, shpesh alegorike e konçize, me anën e të cilave goditeshin shfaqje negative të jetës shoqërore. Qemali botoi disa nga ato, duke ngritur probleme shoqërore, si nevojën për të luftuar kundër fanatizmit e robërimit të gruas shqiptare («Kënga e shtëpisë përdhecke», «Skamje»), demaskoi bestytnitë e sharlatanizmat e klerit («Shkronjat shpëtimtare») etj.

Qemali është më tepër poet se sa prozator. Krijimet e tij më të pjekura artistikisht janë vjershat. Po edhe prozat, nga mënyra se si janë shkruar, nga nota poetike që i përshkon, nga gjuha figurative e lakonike, mund t'i quanim me të drejtë proza poetike.

Vjersha e parë që njohim është «Kanga e kumbanores». Duke vënë në qendër të vjershës figurën e një plaku të munduar nga vuajtjet e uria, ai zbulon para lexuesve kontrastin e fortë shoqëror të kohës: ndërsa një grusht njerëzish, «thurin andrrime rreth kumbonës», «mejtton ai fëmijët

që bukë papra kërkajnë». Kuadri poetik i kësaj vjershe është një copë e gjallë e jetës shkodrane në vitet e rënda të regjimit feudo-borgjez e të obskurantizmit fetar.

Shpirti i shqetësuar i poetit, pakënaqësia e tij ndaj realitetit të përbindshëm është pasqyruar në vargjet e vjershës «Perëndimi». Ai shqetësohet e njëkohësisht revoltohet nga vuajtjet që u shkakton jeta e padrejtë njerëzve. Nga një anë ngrihet kundër parimeve etikomorale të shoqërisë borgjeze, po nga ana tjetër dënon jetën e vogël, shpirtin mikroborgjez që i pengon njerëzit të përqafojnë të vërtetën. Vjersha, ndonëse herë-herë është e vagëlluar, prapë gjallërohet nga besimi i poetit në forcën e «turmës madhështore», nga adhurimi i tij ndaj «Vobeksisë». (të varfërve N.J.)

«...nalt horizonte ngadhnyese na presin». Ky është laitmotivi i vjershës «Shokut të prangavet», të cilën ia kushton Vasil Shantos. Ai i këndon luftëtarit të revolucionit, shokut të luftës së përbashkët kundër «fëlliqësinës agallare». Vargjet i përshkon një patos i zjarhtë revolucionar, që e ka burimin tek urrejtja ndaj botës së vjetër dhe besimi për jetën e re që do të lindë përmes luftës.

Krijimi më i mirë dhe një nga vjershat më të bukura të poezisë sonë revolucionare është, padyshim, vjersha «Hijes së tim vëllai». Megjithëse e shkruar në një çast të rëndë, siç ishte vdekja e të vëllait, në të nuk ndihet fryma elegjiake. Poeti nuk vajton për fatkeqësinë që i ka rënë, po himnizon figurën e të vëllait revolucionar. Me një patos të vetëvetishëm, evokon nga pozitat e një poeti qytetar momentet kryesore të jetës së Veliut e njëkohësisht vepërimtarinë e tyre të përbashkët revolucionare. Ai i drejtohet jo aq vëllait, sa shokut të ideve. Sepse të dy vëllezërit kishin marrë me kohë rrugën e luftës, të dy e kishin urreyer e dënuar këtë «shekull të ndyrë që ka shkëlqim gënjeshtar...», të dy nuk ua kishin vënë veshin atyre që thoshin

«lodhja e juej asht e kotë». Ata kishin ecur përpara me guxim, të vendosur në rrugën e tyre. Por një ditë, papritur, ai ndjeu se Veliu u shkëput nga radhët, vdekja i rrëmbeu shokun dhe vëllanë. Këtë ngjarje ai e konsideroi si rënien e një luftëtari në betejë e sipër dhe zevendësimin e tij nga një shok i ri. Në këto çaste të vështira, nuk u ligështua, po duke shtrënguar më fort flamurin ndër duar, u betua solemnisht:

*Flamurin,  
që n'zi të bukës me lot qendisi nana  
e që t'pashë unë se vajtove,  
mos druej, pa krah ai kurrë s'do të jesi,  
bri timit' pror kryenalt' ka me value.*

Këtë betim e mbajti, sepse tre vjet më vonë, i radhitur në gardën e komunistëve të parë, i prirë nga flamuri i Partisë Komuniste, ai u vu në krye të luftës së rinisë dhe ra heroikisht në fushën e nderit.

Duke dhënë frymën e fundit në luftë të paepur me armiqtë e popullit, ai linte pas emrin dhe veprën e një heroi e bashkë me to dhe këngët e hoveve të tij të para.

Në të gjitha shkrimet e Qemalit ndihet zemra e tij e madhe, shpirti i zjarrtë revolucionar, duket talenti i ushqyer nga vuajtjet dhe lufta e popullit.

Nuk ka dyshim se trashëgimi letrar i Qemalit, ashtu si jeta dhe lufta e tij do të mbeten gjithnjë burim frymëzimi për brezat e rinj të lexuesve.

## REVISTA LETRARE KLANDESTINE «LIRI»

Lufta Nacionalçlirimtare si një fenomen i madh historik në jetën e popullit tonë, nuk mund të mos ndikonte dhe në letërsinë shqipe. Ajo, padyshim, krijoi ato rrethana objektive që shënuan një kthesë rrënjësore në karakterin e letërsisë, duke i dhënë asaj një përmbajtje dhe ideal të ri. Idealet e larta të Lëvizjes Nacionalçlirimtare i çelën letërsisë horizontet e perspektivës historike, tërhoqën vëmendjen e shkrimtarëve patriotë nga çështja e madhe e çlirimit të atdheut, i dhanë krijimtarisë së tyre një frymëzim të vërtetë.

Djepi i letërsisë së re, siç dihet, u bë shtypi i partisë dhe përgjithësisht shtypi ynë i luftës. Rreth këtyre organeve, në kushtet e ilegalitetit, u grumbulluan forcat e shëndosha letrare dhe në to, panë dritën e botimit shumë nga krijimet e tyre. Një rol të dorës së parë, për tërheqjen dhe organizimin e letrarëve, luajtën dy organet qendrore të luftës sonë: gazeta «Zëri i popullit» dhe revista «Kushtrimi i Lirisë».

Partia u mbështet kryesisht në forcat e reja letrare, nga një anë, në ata shkrimtarë të cilët qysh në vitet '30 kishin përqafuar idetë përparimtare dhe qenë lidhur me grupet komuniste dhe, nga ana tjetër, në letrarë të rinj, që lufta për çlirim u zgjonte frymëzimet e para. Për këta të fundit, për organizimin dhe drejtimin e tyre, partia i kish vënë detyra organizatës së Rinisë komuniste shqiptare. Në një sërë dokumentash të asaj kohe, sidomos në

udhëzime e qarkore të KQ të R.K.SH. del mjaft qartë kujdesi që është treguar për tërheqjen e rinisë letrare në organizmat e luftës dhe aktivizimin e saj me shkrime në shtypin klandestin. Dihet që revista «Kushtrimi i Lirisë» zhvilloi një punë të madhe në qëndër për të vënë në jetë këtë porosi të partisë, duke grumbulluar rreth vetes forcat letrare të rinisë. Por lëvizja letrare ilegale e rinisë nuk u kufizua vetëm në qëndër. Përpjekje, që paraqesin interes për historinë e letërsisë sonë të luftës, pati dhe në ndonjë nga qytetet kryesore të vendit. Në këtë rast vëmendjen tonë e ka tërhequr lëvizja letrare ilegale e rinisë shkodrane në vitet 1943-44 dhe organi i saj, revista «Liri».

Në pranverë të vitit 1943, me inisjativën e Qarkorit të rinisë komuniste, u ngrit grupi letrar me të rinj komunistë që merreshin me letërsi. Nga raporti i Qarkorit të Rinisë Komuniste të Shkodrës, dërguar KQ të PKSH., më 2 shtator 1943, marrim vesh se grupi letrar *«ka punue një tubë shkrimesh për botim, shkrime të punuem fare mirë, ka ba një konferencë të gjanë të rinisë antifashiste që merret me letërsi dhe kanë zgjedhë një këshillë... Ky grup ka fillue me u lidhë me masat e rinisë që merret me letërsi»*.

Në fillim, veprimtaria e grupit u kufizua vetëm në propagandimin e ideve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, duke i nxitur të rinjtë letrarë të frymëzoheshin nga lufta për çlirim, të bojkotonin shtypin fashist, të stigmatizonin manevrat dhe kurthet që ngrinin pushtuesit dhe veglat e tyre. Pastaj, të rinjtë e grupit letrar, hartuan shkrime me frymë antifashiste, të cilat i lexonin në rrethet e ndryshme të rinisë ose i daktilografonin e i shpërndanin ilegalisht së bashku me traktet dhe thirrjet e partisë.

Puna e parë e organizuar e grupit qe një botim për-



kujtimor që nxori më 22 gusht 1943, kushtuar tre heronjve të Shkodrës, me rastin e përvjetorit të parë të rënies së tyre. Kjo është një përmbledhje me shkrime letërore, që çelet me një hyrje të shkurtër, ku thuhet ndërmjet të tjerash se «Dëshmorët tanë nuk i qajmë, po be-tohemi për hakmarrjen dhe me vendosje, vetmohim e punë të ngrehim edhe ma nalt flamurin për të cilin ata ranë». Më tutje vjen vjersha «Tre dëshmorët» e Ll. Siliqit e V. Balës dhe tri shënime biografike për heronjtë. Poetët e rinisë në vargjet e tyre nuk i vajtojnë dëshmorët, po duke i cilësuar ata si «pishtarë lirie» e «flamurtarë të lirisë», ngrejnë lart frymën heroike dhe bëjnë thirrje për luftë kundër pushtuesve:

*E kriste pushka e tym e flakë barotit,  
shkëndija t'zjarrta zemrat djaloshare,  
shpërthejshin e këtë dhe t'gjinisë shqiptare  
dëshmort' me gjak arbnuer lajshin si motit.*

*E sot që mbushë janë malet me luftarë,  
e sot qi populli mbarë lshohet n'luftim,  
t'kujtojmë të tre dëshmorët der n'ngadhnjim,  
pishtarët e Lirisë; në kambë shqiptarë!*

(«Tre dëshmorët», Ll.Siliqi, V. Bala)

Në këtë broshurë pa dritën e botimit për herë të parë vjersha e Kolë Jakovës «Tre heronjtë», një nga krijimet më të bukura të luftës. Vjersha nuk nënshkruhet si të tjerat, por hapet me shënimin: «Dhe kështu populli u këndoi tre bijve të denjë të tij: Tre heronjve». Vjersha përshkohet nga një notë e theksuar patriotike dhe shquhet për frymën e thellë popullore. Me patos dhe mjete të thjeshta poetike, duke u mbështetur në traditën gojore, autori ka arritur

të na portretizojë figurën heroike të tre heronjve e në mënyrë të veçantë, atë të Perlatit. Në vargjet e kësaj poezie ndihet atmosfera epike e asaj dite lufte.

Menjëherë pas këtij botimi përkujtimor, grupi letrar i rinisë me ndihmën e drejtë të Qarkorit të Partisë, fillon punën për nxjerrjen e një reviste letrare klandestine. Numri i parë dhe i dytë dolën së bashku në muajt gusht-shtator 1943. Revista u pagëzua me emrin «Liri». Në kopertinë ishte vizatuar një skicë e thjeshtë: në sfond, majë malesh, të ndriçuar nga rrezet e diellit, kurse në plan të parë, një pushkë e një pendë. Gjithësej revista doli në katër numra, e shaptilografuar, me një tirazh 200-300 kopje. Numri i fundit që ai i tetorit të vitit 1944. Revista pati disa herë ndërprerje të gjata, për shkak të kushteve të rënda të ilegalitetit dhe të ndjekjeve që u bënë drejtuesve të saj. Me punën e revistës u morën kryesisht Llazar Siliqi, Muntaz Shehu, Xhavit Jukniu, Vehbi Bala e Aleksandër Banushi dhe bashkëpunuan Bilal Parruca, Arif Gjyli etj.

Përmbajtja dhe karakteri i lëndës së revistës varej kryesisht nga detyrat që vinte përpara lufta kundër pushtuesve. Është kuptimplote që të gjithë numrat e revistës u kushtoheshin dëshmorëve të rinisë. Kështu, në rast se numri i parë e i dytë, u kushtojë dëshmorëve në përgjithësi «të qytetit kreshnik të Shkodrës», i treti dhe i katërti respektivisht u kushtojë udhëheqësve të rinisë shkodrane, që dhanë jetën për liri, Esat Gjyli dhe Manush Alimani.

Për vetë natyrën e revistës, shkrimet që zotrojnë në të janë në radhë të parë shkrime letrare si: vjersha, skica, tregime të shkurtëra, etj. po nuk mungojnë edhe shkrime publicistike e thjeshtë politike. Mjaft interes paraqesin dhe rubrikat «Nejse...» si dhe «Posta e redaksisë».

Botuesit e saj i kanë vënë vetes për detyrë, që t'i japin lexuesit një organ të përshkuar nga fryma luftarake e ditës, nga ideja, siç thuhet në «Fjala e jonë paraprake»,

që «ta shtojë e ndezi edhe ma tepër ndër gjokset tona të rinj flakën e lirisë dhe hakmarrjes».

Si revistë letrare, «Liri» qysh në numrin e parë, boton artikullin programatik «Randësia dhe roli i leteraturës revolucionare», ku jepen parimet ideo-estetike, prej të cilave duhet të udhëhiqen shkrimtarët revolucionarë. Aty çmohet lart roli i letërsisë në luftën e popullit për çlirim: «Në qoftë se aksionet, lufta e gjakut e forcojnë, e bashkojnë popullin tonë, broshurat, revistat, traktet çdo gja tjetër letrare me frymë revolucionare e bajnë koshient atë për luftën që po ban dhe i dëftojnë rrugën, që duhet të ndjeki deri në çlirimin e plotë, deri në fitoren e fundit». Në artikull hidhet ideja e madhe që «luftëtarët e lirisë... bashkë me pushkën duhet të kenë dhe librin», por «jo libra që mpijnë trutë e popullit e të rinisë, siç ban fashizmi, po vepra të leteraturës revolucionare... që e mësojnë rininë e popullin si me lëftue me pushkë e me pendë kundër zgjedhës tiranike të fashizmit barbar...», sepse «ç'kuptim tjetër mund të ketë literatura, në se nuk përdoret për një qëllim të lartë, në qoftë se nuk vihet në shërbim të shtresave të gjana popullore?»

Drejtuesit e revistës kanë një koncept të shëndoshë klasor mbi letërsinë kur pohojnë se «në të gjitha kohët. kemi pasë dy korente letrare: njeni që shfaqte mendimet e klasës që sundonte dhe tjetri mendimet e klasës që shtypeshe». Ata përpiqen t'ua bëjnë sa më të qartë rinisë, e veçanërisht letrarëve të rinj, se aktualisht edhe në Shqipëri «kemi korentin letrar të fashistëve, që me gënjeshtër, demagogji, përdhunime e frikësime duen me mbajtë nën zgjedhën e tyre tiranike popuj e kombe; dhe korentin e letërsisë revolucionare të popujve liridashës, që me gjak po vulosin parimet e lirisë... e po provojnë se liria nuk dhurohet, po fitohet me mund, sakrifica e gjak.»

Duke u nisur nga këto rrethana historike, revista vë

përpara letrarëve të rinj detyrën që «shkrimet tona duhet të jenë të mbushura me flakë e barot, si bombat e plumbat që qëllojnë zemrat e fëlliqura të fashistëve barbarë», se «shkrimtarët ose poetët nuk duhet të shkruajnë vetëm për të shkruar, por duhet të bahen interpret të zjarrtë e besnikë të ndjenjave të turmave të gjana popullore». Në luftën e madhe që kishte filluar, revista kërkon nga letërsia që ta «pregatitë popullin tonë për në kryengritjen e përgjithshme...», që ajo të ketë si mision pregatitjen e opinionit publik «me rrokë armët kundra fashizmit», se vetëm në këtë mënyrë do të arrihet «me siguri një Shqipni pa fashizëm, pa tradhtarë e kompromisaxhinj, një Shqipëri independente, demokratike, popullore».

Siç shihet, revista ka dalë me një program mjaft të qartë, mbështetur në koncepte të shëndosha politike dhe estetike, dhe nga kjo pikëpamje, ajo bën jehonë e propagandon qëndrimin e partisë sonë në këtë fushë qysh në atë kohë. Përveç këtij artikulli bazë, në organin e grupit letrar gjejmë thirrjen drejtuar rinisë së Shkodrës: «Të gjithë fuqitë tona duhet t'i shkrijmë për qëllimin e shenjtë të lirisë. Edhe literatura është një mjet i fuqishëm për të luftuar armikun», prandaj, i këshillon letrarët e rinj, që të mos botojnë «ndër organet e fëlliqura fashiste», por «duhet të botohen në organet e vetë popullit». Revista shpreh besimin se këto shkrime «kanë me vu themelet e një letërsie të re në një Shqipëri të lirë...»

Për orientimin e shëndoshë të organit letrar tregojnë dhe mendimet e këshillat që u jepen talenteve të reja në rubrikën «Posta e redaksisë».

Redaksia, e udhëhequr nga idetë e partisë, përpiqet t'i ushqejë letrarët e rinj me koncepte dhe mendime të drejta mbi artin dhe jetën. Kështu, duke i dhënë këshilla një letrari të ri, ajo kërkon që «subjektet zgjidhni nga realiteti i përditshëm dhe shkruani... sa ma shkurt e qartësisht.

Shkrimet tona duhet t'i lexojë e t'i kuptojë i shkolluemi e i pashkolluemi, malësori e katundari» ose «Prodhimet tona duhet të shkruhen edhe ma tepër në frymën e Luftës Nacionalçlirimtare.» Duke kritikuar novelën e një të riu, si shumë romantike, redaksia vë në dukje në postën e saj se «kemi nevojë për shkrime revolucionare, që të na çelin sytë e të na ngrohin zemrat...». Ajo shtron detyrën që lehtësia t'i bëjë jehonë propagandës së luftës dhe shton se «Të tilla shkrime janë shumë të vlefshme për ne». Në postën e redaksisë ngrihen mendime interesante, kur shkruhet: «Jemi të një mendimi me ju mbi nevojën e punimit të dramatikës. Nxisim, pra, të rinjtë tanë letrarë që të pasurojnë letërsinë e re revolucionare të Luftës Nacionalçlirimtare edhe me shkrime të tilla». «Teatri asht shkolla e popullit» ose «Femna e jonë duhet të marri pjesë aktive edhe n'anën letrare. Duhet të përdori pendën, njashtu si shoqet e saj të Jugut dijnë të përdorin dhe pushkën».

Është e natyrshme që këtë program të drejtë, revista u përpoq ta zbatojë vetë, me botimin e një sërë krijimesh letrare, që u përgjigjeshin drejtpërdrejt kërkesave të luftës. Nëpër faqet e saj u botuan rreth dhjetë vjersha, pesë tregime dhe një sërë artikujsh publicistikë, mbi bashkimin, objektivat dhe detyrat e rinisë shqiptare, mbi rolin e gruas, mbi vëllazërimin e popujve në luftë, mbi dëshmorët etj. Tema qëndrore në të gjitha shkrimet e botuara, pavarësisht nga trajta e tyre, është patriotizmi, thirrja për luftë, himnizimi i heroizmit, i vetmohimit të rinisë. Autorët e tyre tërhiqen dhe shkruajnë me emocion për luftëtarët e çetave, për dëshmorët dhe nënat e tyre heroina, për forcën e vitalitetin e idealeve të luftës, demaskojnë mizoritë dhe dredhitë e pushtuesve e të veglave të tyre.

Bashkëpunëtorët e revistës qenë kryesisht letrarë të rinj, të lidhur me Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe të ush-

qyer me idetë e saj. Ata e nisnin rrugën e letërsisë duke i botuar krijimet e para pikërisht në një organ letrar klandestin dhe kjo qe fatlume për të ardhmen e tyre. Më aktiv nga këta qe Llazar Siliqi, krijimet e të cilit zenë pjesën më të madhe të shkrimeve letrare në revistë. Është me interes të vihet në dukje se lidhja shpirtërore e poetit me luftën e popullit, që në hapat e para, ushtroi një ndikim mjaft pozitiv në formimin e tij si artist. Toni militant i poezisë së Llazar Siliqit e ka burimin e parë qysh në këtë kohë, kur nisin të ravijëzohen, ndonëse akoma zbetë, disa tipare të profilit të tij poetik, si patosi luftarak, vetëdija e lartë qytetare, karakteri agjitativ, fryma e aktualitetit, etj. Vjershat e poetit të ri të marra të gjitha së bashku tingëllojnë si një thirrje për luftë të vendosur, thirrje për hakmarrje:

*Anëmbanë Shqipënisë  
zjarri i luftës të shpërndahet,  
sot rinia le të bahet  
flamurtar i popullit tonë:  
të na prijë përgjithmonë  
të mbjellë farën e Lirisë!*

(«Të punojmë»)

Për autorin e ri, që jeton atmosferën e zjarrit të luftës është e qartë se liria nuk mund të arrihet pa bashkimin e popullit kundër fashizmit, prandaj:

*Bashkim çeliku! E turri bish s'i ndalet.  
Bashkim t'patranshëm! E shmanget tradhtija.  
Bashkim, o vllazën! Dhe pshtohet Shqipnija.  
Bashkim — buçasin kodrat edhe malet.*

(«Bashkim»)

Si kushtrim tingëllon vjersha «Çetat t'i shtojmë», drejtuar brezit të tij, për t'iu përgjigjur detyrës së çlirimit të atdheut, që të radhitet në çetat e lirisë. Në vjershën «Bje, oh, bje» flitet për qëndresën heroike të rinisë përpara torturave që bëjnë fashistët, kurse te «Dëshmorit Esat Gjyli» dhe «Shokut Manush Alimani» poeti i ri himnizon dëshmorët e rinisë dhe ngre lart idenë se lufta për çlirim kërkon sakrifica deri në vetmohim.

Veç vjershave, Llazar Siliqi ka botuar dhe disa tre-gime me subjekt nga lufta si «Me katundarët», «Një ditë në çetë», «Vashat shqiptare». Ato janë më shumë skica dhe reportazhe letrare, po tërheqin vëmendjen për brendinë e re, për faktin se në to bëhen përpjekje për të futur në lë-tërsi ngjarje të ditës, frymën heroike të Lëvizjes Nacional-çlirimtare. Po kjo vërehet edhe në tregimet e Vehbi Balës dhe Bilal Parrucës, ku nëpërmjet episodeve të ndryshme pasqyrojnë luftën e rinisë kundër fashizmit.

Poezia në këtë revistë u lëvrua dhe nga dy autorë të tjerë të rinj, nga Vehbi Bala dhe Aleksandër Banushi. Edhe vjershat e tyre u shkruan nën ndikimin drejtpërdrejtë të Lëvizjes, të frymës heroike që ngjall lufta e komunistëve, burrëria e vetmohimi i tyre kundër armiqve të popullit. Ata i thurin vargje poetike dëshmorëve dhe ftojnë rininë të ndjekë shembullin e tyre. Me një ton marcial, Vehbi Bala në vjershën «N'fushata vraponi» bën thirrje për t'u hedhur në luftë:

*N'fushata vraponi, o burra, vraponi,  
kët' popull t'robnuemun nga i huaji*

*çlironi!*

*Me grushta çelikut,*

*t'i japim armikut*

*përmbysjen e fundit, për vdekje e dëbim».*

Një frymë të këtillë ka dhe vjersha «Kushtrim për liri» e Aleksandër Banushit, ku ndërmjet të tjerash shkruan:

*Rini fammadhe, rini krenare,  
çetave trime n'mal u ke pri,  
fillove luftën sot çlirimtare,*

*luftë për liri!*

Një nga krijimet e botuara në këtë organ, që ngjall interes, na duket vjersha «Një nanë heroike» e Vehbi Balës. Kjo është ndërtuar mbi një motiv konkret: është historia prekëse e njëkohësisht heroike e një nëne të varfër, që nis të birin në çetë të luftojë për çlirimin e atdheut dhe, kur ai bie në luftë me armiqtë, ajo nuk jepet, po shkon në çetë dhe ngjesh armët e tij. Vjersha ka momente të goditura dhe përgjithësisht e përshkon një notë dramaciteti, me tone optimiste:

*«Shkoni nanën ma lajmoni,  
se u flijue për liri,  
Por me lot mos m'vajtoni!»  
U mek sysh e ma s'u ndi.*

Kur i tregojnë nënës për vdekjen e të birit, poeti thotë se ajo «qëndroi trime... dhe mbështolli n'zemën krejt Shqipninë».

Duke bërë bilancin e krijimtarisë letrare të botuar në këtë organ, mund të themi se gjinia që u lëvrua më shumë qe poezia, kryesisht vjersha e shkurtër me karakter agjitativ dhe nota patetike. Meritat e kësaj poezie nuk janë sigurisht arritjet artistike, se sa afirmimi i ideve të luftës, pozita e shëndoshë, fryma revolucionare nga u nisën autorët e rinj për t'iu përgjigjur detyrave historike që u vinte



përpara partia. Dhe duke qenë e këtillë, ajo luajti një rol të rëndësishëm për edukimin revolucionar të popullit e veçanërisht të rinisë, në ish-qarkun e Shkodrës dhe në ndonjë rast dhe jashtë tij.

Revista letrare klandestine «Liri», megjithëse pati një jetë të shkurtër e pengesa të shumta, ajo u bë organizatore dhe nxitëse e talenteve të reja në fushën e letërsisë në një nga qendrat më të rëndësishme të vendit, siç është Shkodra. Duke e filluar rrugën letrare nga faqet e kësaj reviste, pjesa më e mirë e bashkëpunëtorëve të saj e lidhën krijimtarinë e tyre me fatin e popullit dhe kjo u siguroi përgjithmonë një drejtim të shëndoshë në letërsi. Me një nisje të tillë, ecja më vonë në rrugën e gjerë të realizmit socialist nga këta autorë, qe një vazhdim logjik dhe një proces krejt i natyrshëm.

Idetë e PKS, të pasqyruara në këtë organ, puna e saj organizuese, i udhëhoqi talentet e reja të ecin në rrugën e popullit dhe u hapi horizonte të pakufishme krijimi. Ky, pa dyshim, është dhe rezultati më i rëndësishëm që arriti revista letrare klandestine «Liri».

1971

## REALITETI DHE FRYMËZIMI NË DIMENSIONET E NJË ROMANI

Hasan Petrela ka disa vjet që ka debutuar në letërsi. Pas tregimeve dhe skicave të para, ai botoi më 1959 novelën «Në mëshirën e njerëzve». Në këtë vepër u duk më qartë talenti i tij prej prozatori, rrëfeu disa tipare të vetat, sidomos aftësinë për të shkruar thjesht, cilësi kjo që së bashku me të tjerat i siguruan veprës një sukses të merituar.

Hasan Petrela është nga ata të pakë shkrimtarë të rinj që punon në heshtje dhe pa u ngutur. Në këtë rast, sipas mendimit tonë, nuk kemi të bëjmë vetëm me çështje temperamentit, po edhe me një qëndrim serioz ndaj letërsisë. Kështu, pas afro katër vjetësh nga botimi i librit të parë, shkrimtari i ri paraqitet tani me librin e dytë, romanin «Të munduarit». Ai që ka ndjekur nga afër krijimtarinë e tij, nuk mund të mos i bien në sy përparimet e dukëshme që ka bërë autori me veprën e re.

Duhet ta themi që në krye, se romani «Të munduarit» është një vepër me vlerë ideo-artistike që dëshmon edhe një herë për talentin e tij, për një ngritje të mjeshtërisë artistike, për faktin që sjell një zë të vetin në prozën tonë të gjatë.

«Të munduarit» i kushtohet së kaluarës së popullit tonë. Autori, në të vërtetë, nuk është hera e parë që merret me këtë temë. Ai përgjithësisht priret nga temat e së kaluarës dhe kjo vihet re si në tregimet e tij, ashtu edhe tek

novela «Në mëshirën e njerëzve», ku është përshkruar jeta e rëndë e popullit të thjeshtë gjatë sundimit të feudo-borgjezisë. Po në veprën e re, ai është shtyrë akoma më larg dhe e çon lexuesin në dhjetëvjetshin e parë të shekullit tonë. Ngjarjet e romanit kanë adresë të qartë historike dhe gjeografike; ato zhvillohen në vitet 1909-1911, në Shqipërinë e Mesme dhe pikërisht në fshatin Petrelë. Kemi të bëjmë, pra, me një roman historiko-shoqëror, sado që aty nuk vepron asnjë personazh historik. Po e quajmë kështu sepse vepra, qoftë nga disa tipa të krijuar, qoftë nga ngjarjet që zhvillohen në të, qoftë nga dhënia e ngjyrave të kohës, ruan vërtetësi historike dhe kjo është nga meritat kryesore të shkrimtarit. Koha në të cilin është vendosur aksioni i romanit mund të mos jetë trajtuar për herë të parë në prozën tonë, por problemet që janë futur n'orbitën e tij dhe ambjentet autentikë të Shqipërisë së Mesme, e bëjnë romanin nga kjo pikëpamje origjinal dhe interesant. Shkrimtari është munduar të pasqyrojë nga kjo kohë, një aspekt të paprekur pothuajse fare në prozën tonë të re: të tregojë fshatin e atëhershëm shqiptar si një vend të mjeruar nga pushtuesit shekullorë dhe si nyje kontradiktash të thella shoqërore, duke lënë dashur pa dashur, në hije luftën për çlirimin kombëtar. Lidhur me këtë del çështja se sa mund të përfaqësohet kjo kohë në letërsi duke e parë vetëm nga aspekti shoqëror. Për mendimin tonë është e drejtë e autorit ta zgjedhë e të trajtojë temën në bazë të materialit që disponon dhe qëllimeve ideoartistike që i ka vënë përpara. Por, në rastin konkret, kur shkrimtari shkruan për shoqërinë shqiptare të fillimit të shekullit, ai duhet medoemos të reflektojë në një mënyrë a në një tjetër edhe problemin kardinal të kohës, luftën për çlirimin kombëtar. Shkëputja e të parës nga e dyta, pasqyrimi i njerit aspekt të izoluar nga tjetri do ta bënte veprën të humbiste nga vlera ideore dhe nga vërtetësia historike.

Pa një shtrirje dhe thellim në ngjarjet më të rëndësishme të kohës, të cilat janë të lidhura dialektikisht me sho-shoqen nuk mund të kemi vepër realiste, aq më shumë një roman realist. Para një problemi të kësaj natyre përafërsisht jemi edhe në romanin «Të munduarit». Autori këtu, nuk i ka vënë vehtes për detyrë të përshkruajë lëvizjen për çlirimin kombëtar, por të tregojë luftën për egzistencë të fshatarësisë sonë të fillimit të shekullit, kur vuante nën kthetrat e feudalizmit dhe të shushunjave të para kapitaliste. Marrë në këtë aspekt, romani në përgjithësi e përlligj qëllimin e autorit, por përta i përket anës tjetër, faktit sa lidhet ky aspekt i jetës shqiptare me problemin e lëvizjes për çlirim kombëtar, kemi vërejtje të rëndësishme personazhesh, pjesa më e madhe e të cilëve mbahet mend nga lexuesi. Sekretet e kësaj qëndron në vërtetësinë e tyre si figura artistike. Autori i ka krijuar duke u mbështetur në jetën e gjallë dhe jo në skena të paracaktuara. Karakteristikat e tyre nuk janë dhënë nëpërmjet epitetesh apo me komente retorike dhe evokime të përgjithshme. Personazhet e Hasan Petrelës, sidomos disa, janë të tipizuar dhe të individualizuar. Karakteret e tyre zbulohen herë përmes analizave psikologjike e herë me anë të veprimeve të ndryshme. Ku më shumë e ku më pak, lexuesi ndihen në roman se ka të bëjë me figura artistike që kanë një botë të brëndshme, logjike kjo e kushtëzuar nga klasa që i përkasin, nga niveli, temperamentet, nga mosha, etj.

Personazhet që spikatin në roman dhe jepen më të plotë janë Rema, Kupi, Sabria dhe sidomos sheh Brahimi. Në të vërtetë rreth këtyre vërtiten gjithë ngjarjet e veprës. Po ndërsa tre të parët janë figurat pozitive, i katërti është figura negative antagoniste.

Rema dhe Kupi përfaqësojnë fshatarësinë e shtypur e të sfillitur, tek ata autori ka paraqitur ato breza të fshatit, që provuan dhe mbajtën mbi kurriz të gjitha të këqiat e rendit ekonomik e politik feudal.

Rema është i riu fshatar i fillimit të shekullit, djalë i zgjuar e punëtor, trim e i ndershëm, po me kufizimet e kohës e të ambientit, i prapambetur e plot bestytini. Figurën e tij autori e nxjerr akoma më mirë në relief, duke e vënë në kontrast me Halimin, të birin e sheh Brahimit. Teksa Halimi bën një jetë parazitare, Rema si hyzmeqar i shtëpisë punon e rropatet gjithë kohën për një copë bukë. Ai e ndien gjithnjë sipërinë e tij mbi të birin e të zot, por s'ka se ç'të bëjë dhe i nënshtrohet fatit të rëndë. I vetmi gëzim në jetën e Remës është dashuria me Sabrien. Dashuria e tyre është nga faqet më të bukura të veprës.

Rema është protagonist i romanit. Ai lidh të gjitha ngjarjet që zhvillohen në të dhe sado që zbulohet si karakter prapëseprapë lexuesi ngelet i pakënaqur. Duket sikur kësaj figure i mungon diçka, diçka e rëndësishme. Për mendimin tonë kjo vjen ngaqë Rema nuk është tipizuar plotësisht. Autori, duke mos dalë jashtë kufijve të fshatit konkret, duke mos u shkëputur sa duhet nga faktet, nuk ka arritur t'i mveshi të gjitha ato karakteristika të domosdoshme, që do ta bënin atë tamam një figurë përgjithësuese për kohën. Kështu, figura e Remës lë përshtypjen sikur i mungon në masën e duhur ndjenja klasore, bile herë-herë i mungon atdhedashuria. Rema na përshkruhet po aq i prapambetur e i përlur, po aq injorant dhe larg ideve të lëvizjes kombëtare, sa edhe gjithë personazhet e tjerë. Kuptohet se autori, për ta tipizuar plotësisht këtë figurë, duhej të shikonte më larg dhe t'i kapërcente kufijtë e një fshati.

Një personazh që tërheq vëmendjen e lexuesit në roman është edhe Kupi. Ai ka disa veti të përbashkëta me shokun e tij Remën, po prapë ata ndryshojnë. Kupi është njeri me temperament të gjallë, i rrëmbyer, trim dhe i vendosur. Nga ana tjetër, ai është ambicioz dhe me sedër të madhe. Te Kupi, autori është munduar të na japë deri

diku disa cilësi, që s'ia ka dhënë dot Remës, të na ravigjëzojë të riun e pakënaqur të kohës, figurën e kryengritësit rebel. Ai ngre krye, po urrejtja e tij është e papërcaktuar mirë, një pakënaqësi e përgjithshme, pa drejtim të saktë. Dhe këtu qëndron dobësia e kësaj figure. Kupi del komit dhe vihet kundër sheh Brahimit krejt rastësisht dhe aksidentalisht. Ai i rrëmben shaminë e kokës Sabries dhe kjo e bën hasëm me Babë Shehun. Kuptohet se edhe në krijimin e kësaj figure, autori nuk është thelluar sa duhet. Për ta ngritur vlerën ideoartistike të figurës së Kupit, duheshin gjetur motive më të thella, motive sociale. Këto do t'i jepnin një drejtim më pozitiv urrejtjes dhe shpirtit kryengritës të Kupit dhe do t'i shtonin vlerën njohëse dhe edukative romanit. Sadoqë autori është munduar nga fundi të vejë në gojën e Kupit fjalë kundër sheh Brahimit, ato prapëseprapë nuk i kanë vlejtur tipizimit të figurës. Në mbetemi gjithnjë me përshtypjen se në roman, shkrimtari i ka kushtuar më shumë vëmendje grindjeve të Kupit me Remën, se sa armiqtësisë klasore në mes Kupit dhe sheh Brahimit.

Bartës i ideve patriotike të kohës në roman paraqitet Xhafer Ademi. Ai, edhe pse është një figurë episodike dhe vepron në vepër vetëm nga fundi, ka rëndësi ideore dhe merr një kuptim simbolik, po të kemi parasysh që romani është i varfër nga kjo anë. Xhafer Ademi është nga ata patriotë të lëvizjes sonë kombëtare, që propagandon idetë e Rilindjes. Ai i hap sytë Remës dhe e bën të kuptojë se nuk duhet të luftonte kundër kryengritësve, po kundër turqëve. Figura e tij e gjallë dhe e vizatuar me dashuri nga autori nuk harrohet lehtë nga lexuesi.

Në qoftë se flasim për vlerat e romanit «Të munduarit», një sukses i autorit është krijimi i figurës së sheh Brahimit. Sheh Brahimimi mund të renditet në një radhë me figurat më të goditura negative të prozës sonë. Mendimi

i shfaqur se sheh Brahimi është personazhi më i goditur i prozës sonë na duket kategorik dhe i paargumentuar. Ne do të thoshim, dhe kjo na duket më e arsyeshme, se sheh Brahimi me individualitetin e theksuar që e karakterizon, me ato tipare të qarta si përfaqësues i klasës së tij, është vërtet një figurë e goditur, që zë një vend të vetin në galerinë e personazheve negativë të prozës sonë. Figura e sheh Brahimit është realizuar aq mirë, sa me të drejtë mund të thoshim se te ky personazh shkrimtari ka tipizuar një fenomen historik të përcaktuar qartë, një klasë dhe një kohë të tillë, që e ka njohur mirë dhe provuar mbi kurrizin e saj fshatarësia jonë. Ne nuk njihemi përnjëherë me sheh Brahimin, ashtu siç nuk njihemi menjëherë edhe në jetë me njerëz të tillë. Autori na e zbulon figurën dalngadalë, duke na e zbërthyer psikologjisht si njeri dhe përfaqësues i klasës shfrytëzuese. Tiparet e tij janë natyra grabitqare, dëshira shtazarake për t'u pasuruar me çdo kusht, armiqësia ndaj lëvizjes kombëtare. Ai është dinak, cinik, intrigant, i pangopur, pa principe morale dhe këto të kombinuara me zgjuarësinë, mprehtësinë dhe shkathtësinë e tij, duke shfrytëzuar pozitën si sheh e bëjnë të vihet mbi bashkëfshatarët dhe të rrojë duke pirë gjakun e tyre. Ai u grabit njerëzve tokat dhe ullinjtë, fut intriga dhe grindje në mes familjeve, vret Kupin, i rrëmben të fejuarën Remës, bën një mijë të zeza. Përpos këtyre merr pjesë nëpër kuvënde, që drejtohen kundër lëvizjes sonë kombëtare, përhap bestytini dhe përpiqet t'i mbajë fshatarët gjithnjë në injorancë e të lidhur sa më ngushtë me fenë. Ai del përpara nesh si një përbindësh me fytyrë njeriu, që rrënon fshatin dhe u shkatërron jetën njerëzve. Figura e sheh Brahimit është paraqitur në disa plane dhe me mjete të pasura shprehëse. Autori ka harmonizuar tek ai me realizëm të fortë tiparet e klasës dhe karakteristikat individuale dhe këto i ka rilevuar jo me anë epitetesh dhe

komentesh, po nëpërmjet analizash e situatash psikologjike, me anë episodesh dhe veprimesh tipizuese. Madje, shkrimtari, nuk ka munguar të zbulojë në natyrën e sheh Brahimit, në ndonjë rast, edhe ndonjë shkëndizë njerëzore. Të gjitha këto e bëjnë figurën e tij bindëse, konkrete dhe në të njëjtën kohë përgjithësuese. Pa këtë personazh plot vitalitet dhe vërtetësi, nuk mund të kuptohet sukcesi i veprës dhe vetë romani.

Realizmi dhe thjeshtësia janë dy veti kryesore të prozës së Hasan Petrelës, që e bëjnë atë një shkrimtar me fytyrë të vetën. Në roman gjejmë përgjithësisht, krahas vërtetësisë së detajeve konkrete, vërtetësinë e paraqitjes së karaktereve tipike në rrethana tipike. Autori e njeh mirë materialin jetësor, mundohet t'i hyjë në esencë fenomeneve shoqërore dhe gjithë këtë realitet të gjallë e të larmë e përfytyron në figura artistike realiste. Realizmi i romanit duket jo vetëm në paraqitjen e personazheve, në psikologjinë dhe mentalitetet e tyre, po edhe në krijimin e atmosferës së kohës, në paraqitjen me ngjyra të gjalla të ambientit dhe të nivelit të fshatarësisë sonë, që të marra së bashku i japin veprës vlera njohëse.

Thjeshtësia të bën për vete. Kjo është në më të shumtën e rasteve një thjeshtësi e vërtetë artistike, që lidhet me faktin se si e sheh autori realitetin dhe në ç'mënyrë e pasqyron këtë me anë të fjalës. Hasan Petrela mundohet ta paraqesë jetën ashtu siç është, thjeshtë dhe me plasticitet, pa filozofuar dhe pa rënë në sociologjizëm. Ai kapet pas atyre anëve dhe hollësirave të realitetit të gjërë, që karakterizojnë thjeshtë dhe bukur. Këtë tipar të prozës së tij autori duhet ta pasurojë dhe ta thellojë më tej. E themi këtë sepse në disa pjesë të romanit autori ka rënë në thjeshtëzim. Në këto raste kemi më shumë bocetin ose skicën, se sa veprën e tërë, të plotësuar e të kryer.

Kompozicioni i romanit në përgjithësi është ndërtuar



drejt. Vepra në pjesën më të madhe ka frymëmarrje. Po romani në punë të kompozicionit, po të vërehet me kujdes, ka edhe dobësi. Nuk e kemi fjalën te hyrja e gjatë dhe as te ritmi i shpejtuar, që karakterizon veprën në pjesën e dytë. Këto janë të meta dhe jo të parëndësishme. Po duam të themi edhe diçka tjetër. Dihet se romani duhet të ndërtohet në një mënyrë të tillë, që ta japë jetën në pamjet kryesore, duke i dhënë vënd njëkohësisht dhe fakteve të tjera të jetës, sipas rëndësisë së tyre. Dihet gjithashtu se kompozicioni nuk është vetëm çështje forme, po lidhet ngushtë me brendinë. Këtu rëndësi merr puna paraprake që bën autori me materialin jetësor. Ky është një moment i rëndësishëm dhe delikat në procesin krijues. Është fjala tek përpjestimet e drejta të materialit jetësor që do të hyjnë në një vepër, te puna dhe sensi i shkrimtarit, për të dalluar faktet e rëndësishme nga ato të dorës së dytë, për të njohur esencialen nga ajo joesenciale. Organizimin e lëndës për romancierin, Tolstoi e quante si detyrën më të vështirë në laboratorin e tij krijues. Ne na duket se disa dobësi të brendisë dhe të kompozicionit të romanit «Të munduarit» duhen kërkuar pikërisht në këtë fazë të punës së autorit. Për mendimin tonë, Hasan Petrela, duke pasur përpara një material të begatë e të shumëllojshëm, ka hasur vështirësi t'i përcaktojë drejt kriteret dhe përmasat e materialit që do të fuste në vepër dhe, për më tepër nuk ka arritur gjithnjë t'i dallojë sipas rëndësisë së tyre faktet e ndryshme të jetës. Gorki thoshte «Fakti s'është e gjithë e vërteta, po mjeti i parë.» Duke u mbështetur mbi faktet, shkrimtari do të japë të vërtetën artistike, sepse kjo e fundit, siç dihet, është riprodhimi krijues i realitetit. Po jo të gjitha faktet e jetës kanë të drejtë ose janë të afta të ngrihen në art për një temë të caktuar. Shkrimtari duhet të ketë disa kritere të përcaktuara, duhet t'ia nënshtrojë materialin një ideje udhëheqëse. Prej kësaj

ideje do të kushtëzohet materiali jetësor, do të varet futja ose lënia jashtë e fakteve të ndryshme. Autori i romanit, nga sa duket, nuk ka arritur ta asimilojë plotësisht materialin jetësor dhe kjo ka bërë të hyjnë në vepër fakte të dorës së dytë dhe të lihen jashtë fakte të rëndësishme. Kemi përshtypjen se mos nënshtrimi plotësisht i lëndës dhe tërheqja prej saj ka bërë që të lihet jashtë tendenca kryesore historike e epokës, lëvizja për çlirimin kombëtar. Sigurisht, ne nuk jemi për zëvendësimin e subjektit të romanit me një subjekt tjetër. Çdo autor mund ta shohë jetën në cilindo aspekt që të dojë, mjafton ta paraqesë drejtë dhe bukur. Po, për mendimin tonë, në një roman siç është «Të munduarit», që i kushtohet jetës së fshatarësisë shqiptare të fillimit të shekullit, mosparaqitja në asnjë formë e lëvizjes sonë kombëtare, mungesa e ndjenjës së atdhedashurisë së fshatarëve, nuk i përgjigjet të vërtetës historike. Sado veçori specifike të kenë pasur krahinat e Shqipërisë së Mesme, nuk është e mundur, qoftë edhe në një fshat të izoluar, siç është Petrela, të mos jenë ruajtur thellë në shpirtin e këtyre njerëzve dashuria për lirinë dhe urrejtja kundër pushtuesve të huaj. Kjo na duket një mungesë e rëndësishme, që e kufizon vlerën njohëse dhe edukative të romanit. Autori do ta kishte evituar këtë, në qoftë se do të ishte thelluar më tepër në materialin jetësor, në qoftë se do të kishte punuar më shumë mbi veprën.

Në këtë roman Hasan Petrela tregoi cilësi të mira edhe prej novatori. Ai di të komunikojë me lexuesin. Tregimi i tij është i shtruar, i thjeshtë dhe tërheqës. Di të zgjojë interes dhe ta prekë lexuesin me sinjeritetin dhe vërtetësinë e atyre që thotë. Përshkrimet janë të gjalla dhe me masë. Dialogu është i shkathët, i natyrshëm dhe shpesh ruan intonacionet e gjuhës së folur. Ritmi i tregimit në përgjithësi është dinamik dhe në përputhje me momentet e subjektit. Tregimin e shoqëron një notë e kënd-

shme lirizmi dhe kjo duket në zgjedhjen e detalit, në përdorimin e figurave, në intonacionin e rrëfimit, në gjuhën emocionale.

Peisazhi, megjithëse i kursyer dhe lakonik, është piktoresk e plastik. Kemi të bëjmë tamam me peisazhin shqiptar. Këtë element estetiko-emocional, autori e përdor shpesh herë me vend, në funksion të plotë të brendisë.

Romani ka gjuhë të mirë dhe emocionale. Shkrimtari ka shkruar me një toskërishte të saktë, duke futur herë-herë me sukses elemente të gegërishtes. Stili i tij është i thjeshtë, i pangarkuar, me fraza zakonisht jo të gjata, me figura fjalësh. Autori po shkon drejt një stili vetiak, po akoma ka luhatje dhe ndihet pasiguria. Ai duhet të punojë me këmbëngulje për një gjuhë më të sigurt, për një stil të krehur dhe koherent. Nuk janë të pakta rastet, kur stili i shtruar e popullor çënohet ose thyhet nga shprehje gazetareske dhe trajta të sferave intelektuale. Personazhet e romanit, me ndonjë përjashtim flasin me një gjuhë të individualizuar. Autori ka përdorur me qëllim një mori fjalësh arkaike dhe barbarizmash, që kanë vlejtur për të dhënë ngjyrat e kohës. Megjithatë, do të qe mirë sikur të ishin qëruar prej gjuhës së tij disa barbarizma të panevojshme. Po kjo gjë duhej bërë edhe me banalitetet. Në roman gjenden fjalë banale, shprehje që të vrasin veshin, skena jo të këndshme, natyraliste, sidomos në pjesën e dytë e veçanërisht kur përshkruhet Rema ushtar. Në të vërtetë këto nuk i shtojnë asgjë romanit, përkundrazi lenë pështypje të keqe. Ato nuk kanë asgjë të përbashkët, për mendimin tonë, me realizmin.

Meritat e romanit «Të munduarit» e Hasan Petrelës janë padyshim më të mëdha se sa dobësitë që konstatuam. Trajtimi i një teme të parratur nga proza jonë e re, fryma realiste, thjeshtësia, krijimi i disa personazheve, veçanërisht ai i sheh Brahimit, pasuria e mjeteve shprehëse dhe

sidomos frymëzimi i ngrohtë e i vetvetishëm me të cilin është shkruar vepra — të gjitha këto veti pozitive i japin të drejtën këtij romani të qëndrojë përkrah romaneve të mirë të letërsisë sonë.

1962

## RRETH VËLLIMIT ME TREGIME «ËNDRA DHE DRITË»

«Ëndra dhe dritë» është vëllimi i dytë me tregime i shkrimtarit Ali Abdihojha. Vëllimi i parë «Në malet tona», botuar vite të shkuara (1952) ra në sy jo aq për merita, se sa për disa dobësi ideoartistike që u vunë në dukje nga kritika. Prandaj, kur lexon përmbledhjen e re dhe e krahason me librin e parë s'ke si të mos vësh re rritjen e autorit si tregimtar. Në librin e fundit, Ali Abdihojha, na paraqitet si një shkrimtar i përgatitur, me profil pak a shumë të vetin, që e bën të ndryshojë nga tregimtarët e tjerë.

Në vëllimin «Ëndra dhe dritë» janë përfshirë 20 tregime të ndarë në tri pjesë me subjekt nga e kaluara, nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe nga jeta e sotme. Libri hapet me tregimin «Ëndra» dhe mbyllet me tregimin «Dritë».

Në goftëse do të bënim një krahasim në mes tregimeve, do të vinim re se tregimet më të mira të vëllimit janë ato me tematikë nga e kaluara dhe pjesërisht ato me subjekt nga Lufta Nacionalçlirimtare, ndërsa tregimet nga jeta e sotme rrallë herë ngrihen në nivelin e të parave.

Ngjarjet, tipat dhe ambientet që na jep autori janë lokalizuar kryesisht në qytetin e Elbasanit dhe në rrethin e tij. Përqëndrimi në një terren të caktuar, nuk duhet marrë si një kufizim i diapazonit të jetës, po si përpjekje serioze për të zbuluar tipa dhe ambiente që ai i njeh më mirë.

Në tregimet e Ali Abdihojhës veprojnë një mori per-

sonazhesh që u përkasin kohëve dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare. Para nesh dalin figura që kanë kaluar në histori ose që jetojnë akoma, ambjente të vjetër e të rinj, koncepte e ide të përparuara ose regresive. Të gjitha këto autori është përpjekur t'i mishërojë në figura të gjalla artistike dhe në përshkrime interesante.

Tregimet me temë nga e kaluara kanë një sfond të përbashkët social. Ato kanë të bëjnë me jetën e vështirë të popullit tonë gjatë rendit feudo-borgjez. Ndër tregimet më të mira me këtë temë mund të përmendim: «Arti për t'u bërë gjeneral», «Përçafim», «Grushti», «Tërbimi» dhe «Para furtunës». Lexuesit i mbetet ndër mend figura e reshter Dautit, heroit të tregimit «Arti për t'u bërë gjeneral». Me reshter Dautin ka arritur të ravijëzojë një tip mjaft të goditur, të vërtetë, pjellë të kohës dhe ambientit ku ai vepron. Reshter Dauti preferon më mirë të mbytet një njeri, se sa të prishen rregullat. Pedantizmi, injoranca, brutaliteti janë tiparet zotëruese të karakterit të këtij njeriu të rritur dhe të edukuar në ushtrinë e vjetër. Nga kjo anë, ai të kujton deri diku Prishibejevin e Çehovit, po merita e Abdihozhës qëndron në faktin se ai ka krijuar një figurë shqiptare, të ngritur mbi truallin tonë.

Në tregimin «Përçafimi» dënohet zakoni i hakmarrjes si një zakon i keq, që në të kaluarën shkretonte shumë vatra. Dy fshatarë, Demir Pisha dhe Hys Lika, të rënë në gjak, plagosin rëndë njëri-tjetrin diku në mes të pyllit dhe ashtu të shtrirë përtokë harrojnë armiqtësinë dhe bisedojnë për jetën e tyre plot halle. Motivi i hakmarrjes i njohur në letërsinë tonë është trajtuar në këtë tregim në mënyrë realiste dhe origjinale. Vetë fabula e gjetur, shtjellimi i saj i shtruar, humanizmi aktiv e bëjnë tregimin një vepër me vlerë. Po mendojmë se fryma realiste e tregimit sikur çënohet kur autori e tepron me evokimin e kujtimeve. Notat sentimentale në këtë rast nuk pajtohen me

natyrën e fshatarit tonë, sidomos në rrethanat që na janë paraqitur personazhet.

Tregimi «Grushti» ka në bazë idenë e bukur të miqësisë së pastër e të solidaritetit të dy njerëzve të thjeshtë, ide kjo që i kundërvihet egoizmit dhe lakmisë së pafre të tregtarit Bim Hirra. Skena e fundit e këtij tregimi, megjithëse pak e kërkuar, kur Lame Xhigadurri me grushtin e tij të fuqishëm shkatërron para Bim Hurrës tavolinën që kishte ndërtuar me duart e veta, i jep tregimit një kuptim të bukur simbolik. Zgjidhja dhe revolta e popullit ndaj padrejtësive që bëheshin në regjimin e Zogut ka gjetur një shprehje interesante në tregimin «Para furtunës». Gjyqi kundër Taf Çapekut dhe Tahir Krastës tingëllon aty si një tragjikomedi që luhet në kurriz të njerëzve të thjeshtë. Paraqitja e figurës burrërore të Tahir Krastës, vizatimi sado që në një plan komik i Taf Çapekut, karikaturizimi i kryetarit të gjyqit dhe prokurorit, përshkrimi i sallës së gjyqit, humori i natyrshëm e plot kolorit e ngrejnë këtë tregim në nivelin e tregimeve më të mira të vëllimit. Subjekti plot koinçidenca në tregimin «Tërbimi», megjithëse i shkruar bukur duket më shumë i sajuar se sa i vërtetë. Autori duke u nisur nga disa ide të paracaktuara e ka ngritur tregimin mbi një bazë që le shkas për diskutim.

Met Troka, një nëpunës i vogël ëndërron dhe përpiqet shtatë vjet me radhë të blejë një radio për të gëzuar fëmijët. Rreth kësaj fabule vërtitet aksioni i tregimit «Ëndrra» dhe tregimi procedon natyrshëm, gjersa nuk është blerë radioja. Po kur Met Troka e blen radion dhe në një moment gati çmendurie e shkatërron, veprimi i tij i fundit është i pamotivuar dhe krejt i papritur. Ne e kuptojmë qëllimin e autorit për të na dhënë një tip të kohës, që e ka shtypur dhe vrarë keq jeta e rëndë, po nuk jemi të pregatitur për atë akt që ai bën në fund dhe që i jep to-

nin gjithë tregimit. Një akt i tillë i Met Trokës nuk është i përligjur nga ana psikologjike.

Nga një motivim i pamjaftueshëm vuan dhe tregimi «Trashëgimtarët». Ideja e rëndësishme se pasuria e prish njeriun, nuk ka gjetur pasqyrim realist në figurën e daj Kasemit. Para së gjithash duhet thënë se daj Kasemi nuk është përcaktuar mirë nga ana sociale dhe kjo ka sjellë që ai të dalë më shumë si një rast i veçuar, se sa si një fenomen tipik. Trajtimi si një fenomen tipik do të kërkonte që të zbuloheshin shkaqet objektive dhe subjektive, që një njeri të kthehet nga punonjës e të marrë tiparet e një shfrytëzuesi. Na duket se autori edhe në këtë tregim është nisur më shumë nga ideja e paramenduar se nga vetë jeta dhe është kjo që e ka penguar t'i hyjë thellë fenomenit dhe të na e zbulojë atë me realizëm. Tregimi «Binjakët» është më shumë një histori e letrarizuar se sa një tregim i zbërthyer artistikisht e me vërtetësi. Autori do të tregojë se si për shkak të pasurisë vëllai vret vëllanë, por përmbyllja e një teme të tillë, të ndërlikuar e të vështirë brënda 5-6 faqeve ka bërë që tregimi të dalë i cekët dhe pa forcë të mjaftueshme emocionale.

Temës së Luftës Nacionalçlirimtare, Ali Abdihoxha, i ka kushtuar pesë tregime, nga të cilat vlejnë të përmenden në mënyrë të veçantë, «Eva» dhe «Kthesa». Në këto tregime autori ka meritën se është përpjekur të hedhë dritë në disa anë të panjohura ose pak të njohura të Luftës Nacionalçlirimtare, të pasqyruara në letërsinë tonë. Tema e gjerë e luftës ka gjetur shprehjen e saj në disa aspekte me të vërtetë interesante. Peripecitë e kalit Eva dhe lidhja e ngushtë e Canit me të përbëjnë brendinë e tregimit «Eva». Autori e ka ndërtuar subjektin duke e perceptuar realitetin herë nga pozita e Canit e herë nga ajo e kalit. Kemi në fakt një humanizëm të kafshës të realizuar me vërtetësi dhe me takt. Kjo e ka bërë tregimin mjaft të



këndshëm e të gjallë, që të kujton nga një anë veprat e mira animalistike. Nuk mund të lemë pa përmendur këtu letrën e të atit të Canes me imtësitë e gjetura psikologjike dhe me koloritin e gjallë të ambientit e të gjuhës.

Në radhën e regjimeve më të mirë do të vinim edhe tregimin psikologjik «Kthesa». Vetë trajtimi i subjektit është bërë në mënyrë origjinale. E gjithë ngjarja dhe zhvillimi i personazheve jepet përmes një udhëtimit sa të zakonshëm aq edhe të jashtëzakonshëm. Çyri, një shofer i thjeshtë, që ka hyrë padashur në shërbim të gjermanëve, nën ndikimin e bisedave të Thomait, të një njeriu të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, bën kthesë dhe në vend që t'u ndihmojë gjermanëve simbas premtimit që ka dhënë, hidhet përfundimisht nga ana e Lëvizjes. Lexuesit i mbetet në mendje figura e Thomait, e të riut entuziast e guximtar, të pastër e të sigurtë. Ai të bën për vete me romantikën e tij, me bindjet e thella dhe me vendosmërinë prej luftëtari. Thomai është vizatuar me dashuri dhe kujdes. Po figura e Thomait nuk do të kishte atë funksion të rëndësishëm që ka, në rast se nuk do t'ishte Çyri. E gjithë biseda e Thomait, tregimet entuziaste dhe optimizmi i tij janë vënë në funksion të ndryshimeve që duhet të pësojë Çyri. Autori na i ka dhënë këto ndryshime që ndodhin në botën e brendshme të shoferit me hollësira interesante dhe në mënyrë graduale. Po me gjithë anët pozitive të figurës së Çyrit, lexuesi me të drejtë mund të pyesi: si ndodh që Çyri të vihet në shërbim të gjermanëve në një kohë kur lufta është në mbarim dhe fitorja e popullit është afuar më shumë se kurrë? Tregimi nga kjo anë do të kërkonte më shumë argumentim e thellim.

Tregimet e tjerë, kushtuar temës së Luftës nuk ngrihen në nivelin ideoartistik të dy të parëve. Ngjarjet në këto tregime nuk janë vendosur në rrethana realiste dhe ndërtimi i tyre të le përshtypjen se me ndërtimin e tyre

autori ka ilustruar disa ide të caktuara, pavarësisht se ato bien ndesh me realitetin ose e japin atë në mënyrë të njëanshme e të përciptë. Vetëm kështu mund të shpjegohet qëndrimi i dy personazheve antagonistë në tregimin «Dy takime». Nuk ka si të përliqet as dehja e fshatarit Cene Belshakut në një kohë kur i gjithë fshati ka marrë arratinë nga frika e gjermanëve dhe aq më tepër ardhja e një ushtari të vetëm gjerman, për të djegur kasollen dhe dehja e tij. Tregimi, me gjithë skenat e bukura komike, të cilat mbeten të bukura në vetvete, nuk të bind dhe nuk e mban idenë e rëndësishme.

Tregimi «Në follenë e shqiponjës» bën fjalë për odisenë e dy partizanëve që, të shkëputur nga shokët, enden për nëntë ditë rresht nëpër male dhe zona të armikut. Paralelizma që heq autori në mes partizanëve dhe shqiponjave e kthen këtë në një qëllim në vetvete dhe i jep ngjarjeve e figurave një karakter tepër simbolik.

Përsa i përket tregimeve që i kushtohen jetës së sotme, lexuesi e ka të vështirë të japë një gjykim unik, po mund të themi se këta tregime në një mënyrë apo në një tjetër të shtynë të diskutosh. Ali Abdihoxha në këto tregime ka shtruar probleme të rëndësishme dhe delikate, ka krijuar figura interesante në disa raste, është orvatur herë herë të mos ecë në rrugë të rrahura, po megjithatë ngelet shumë për të diskutuar. Me këtë rast le të analizojmë dy tregime për vlerën e të cilëve mund të ketë mendime të ndryshme. Është fjala për tregimin «Përmbysja» që shtron një problem mjaft interesant dhe tregimin «Dritë» që na duket një krijim i dështuar nga ana ideore. Në tregimin «Përmbysja» shkrimtari është munduar të na paraqesë figurën e partizanit marrë në një plan etik, gjë që rrallë herë i është kushtuar vemendje nga shkrimtarë të tjerë. Partizani Zeqo Bodurri ngarkohet, gjatë kohës që luftohet për çlirimin e qytetit, të rrethojë shtëpinë e beut, të arrestojë

atë dhe njerëzit e tij dhe të ruajë çdo vlerë materiale që gjendet në atë shtëpi. Sigurisht rrethimi i shtëpisë dhe arrestimi i beut nuk i kushton gjë Zeqos. Prova për partizanin fillon atëherë kur ai gjendet para vajzës së bukur të beut dhe për më tepër, kur ajo i jep një qeskë me flori. Zeqoja tani kalon nëpër disa situata që e vënë në provë karakterin e tij dhe kjo provë përbën linjën kryesore të subjektit. Zeqoja e merr qeskën e florumit dhe me të në xhep shkon në pazar. Këtu kemi disa momente me të vërtetë të bukura, kur te ky partizan zgjohet shpirti i fshatarit dhe lind dëshira të blejë një plug hekuri. Autori rreh të na mbushë mendjen se Zeqoja e ka marrë qeskën në mënyrë të pandërgjegjshme. Po në të vërtetë veprimet e tij tregojnë të kundërtën. Ai në një mënyrë apo në një tjetër është tunduar dhe çdo ndërhyrje e autorit, për ta lehtësuar është një retush që s'e fsheh dot të vërtetën. Detyra e shkrimtarit në këtë rast nuk ishte t'i kalonte anash problemit, po t'i hynte me guxim thellë figurës, të na jepte luftën psikologjike që zhvillohet në botën e brendshme të partizanit dhe të tregonte se si ideali i ri triumfon mbi konceptet apo mbeturinat që mund të kishte heroi i tij. Për fat të keq, autori ka bërë një devijim të linjës realiste të figurës dhe shumë veprime dhe mendime të Zeqos, sidomos në pjesën e dytë, nuk janë të tijat.

Përgjithësisht, tregimet e Ali Abdihoxhës kanë një domethënie të rëndësishme shoqërore, kurse një gjë e tillë nuk ndodh me tregimin «Dritë». Ky tregim i botuar në një variant tjetër në gazetën «Drita» ngrinte një problem, pavarësisht se i jepte këtij problemi një zgjidhje jo të drejtë. Është fjala për një çift porsa të martuar, për Luanin dhe Marien që, duke ndenjuri shtrirë në plazh, lexojnë në gazetë që një farë Oberleider bën përgatitje për luftë dhe pak më vonë ky çift, duke kaluar në një zonë diku afër plazhit, vritet aksidentalisht nga një minë që kishin

lënë aty pushtuesit nazistë. Sigurisht, lexuesi nuk kishte si të pajtohej me këtë zgjidhje që i jepej tregimit dhe autori në variantin e ri e eviton vdekjen e heronjve. Tani në variantin e dytë lexuesi mund të pyesi me të drejtë se cili është problemi në tregim? Mos vallë gjesti fisnik i një çifti plak që u lëron dhomën për të kaluar pushimet, përbën idenë kryesore? Sa vlerë do të kishte kjo, ashtu siç është dhënë? Në variantin e dytë ai ka bërë një përgjithësim të gabuar të jetës sonë. Dy të rinj, porsa të martuar, vinë në plazh të pushojnë, po nuk kanë asnjë mundësi, kudo hasin pengesa. Dhomë s'ka, me gjithë porosinë që kanë bërë, kabinë prapë s'ka, në det nuk i lënë të shetisin të lirë, dalin në natyrë po edhe atje, toka është e minuar.(?!). Duhej fisnikëria dhe sakrifica e dy njerëzve të panjohur, që heronjtë e tregimit të gjejnë më në fund prehje. Është e tepërt të themi se ç'pikëpyetje të ligjshme krijon tregimi dhe sa i padrejtë është rasti që rreh të përgjithësojë autori.

Në tregimin «Gruaja me nishan në mjekër», ideja që Musai, një fshatar i zakonshëm e ndan gruan për shkak se e shoqja ndihmon për ngritjen e kooperativës në fshat dhe ai shkon në qytet dhe bëhet druvar e pastaj nga një koinçidencë e rastit vendos prapë të kthehet në shtëpi, nuk ka gjetur realizim të motivuar nga pikëpamja ideoartistike. Tregimi ka dalë skematik, ndihet një tendencë e pajustificuar, personazhet janë të zbetë, dialogjet tingëllojnë artificialë. Po këtë mund të themi edhe për tregimin «Peshkatari», që ka një ide të hallakatur me një hyrje të gjatë e me hollësira të panevojshme. Sado që tregimet «Pragu» dhe «Lutja e fundit» janë shkruar me gjuhë të mirë dhe figura interesante, prapë të mbajnë të ftohtë dhe tingëllojnë më shumë të sajuar se sa të vërtetë.

E thamë edhe më lart se Ali Abdihoxa si tregimtar ka profilin e tij që shprehet si në mënyrën e konceptimit

të fenomeneve të ndryshme të realitetit ashtu edhe në stilin, në zgjedhjen e figurave, në gjuhën. Ai është një shkrimtar i përgatitur, që shkruan me kulturë, vëmendja e tij drejtohet nga probleme të rëndësishme, atë nuk e tërheqin ngjarje të jashtme dhe aventura, po bota e brendshme e njerëzve. Ai tregohet shpesh herë një psikolog i hollë, hetues i kujdesshëm në jetë. Në tregimet e Ali Abdi-hoxhës gjejmë tipa të goditur, me individualitetin e tyre, pjellë jo të fantazisë, po të realitetit të gjallë. Ai ka zotësinë të krijojë atmosferë interesante dhe me kolorit në funksion të kohës dhe të ambientit që përshkruan. Nota e humorit është një veti tjetër, që i bën tregimet të këndshëm e të gjallë. Ali Abdi-hoxha është nga ata shkrimtarë që di t'i ndërtojë drejtë tregimet nga pikëpamja kompozicionale, gjithnjë në përshtatje me idenë dhe materialin jetësor. Stili i tij është i punuar dhe i zhdërvjellët. Ai shkruan në një toskërishte letrare, me ndonjë gegërizëm e barbarizëm të futur me vend, që i japin frazës kolorit.

1964

## PIKËNISJA E AUTORIT DHE LOGJIKA OBJEKTIVE E PERSONAZHEVE

Kur lexon romanin «Ditë të gjelbra» të Gazmend Kongolit konstaton se autori ka marrë përsipër të realizojë përmes veprës së tij një ide të rëndësishme, bile shumë të rëndësishme, po nga ana tjetër, nuk mund të mos vëshre se kjo ide, për shumë arsye, gjatë zhvillimit të romanit është kompromentuar dhe objektivisht nuk janë arritur ato synime ideoemocionale që premtan tema.

Sa tërheqëse dhe interesante është vepra në faqet e para, aq indiferent të lë më pas. Sepse ndodh kështu: ngjarjet zhvillohen, personazhet, në kundërshtim me qëllimin e autorit, zbulojnë vetveten dhe atëherë lexuesi vëren se ideja fillestare nuk gjen mishërim në vepër dhe se ajo sa vjen e humbet forcën emocionale.

Në radhë të parë duke shqyrtuar romanin «Ditë të gjelbra», gjëndemi përpara problemit të rëndësishëm se sa janë heronjtë e veprës heronjtë tanë, sa përfaqësojnë ata njeriun tonë të ri.

Duam ta themi që në krye se G. Kongoli në tërësi nuk ka mundur dot të shkruajë një vepër realiste, pasqyrë të gjallë të jetës dhe idealeve tona, të psikologjisë së re të njerëzve tanë, ai ka shkruar një vepër skematike, një roman artificial.

Skematizmi dihet se vjen në radhë të parë nga njohja dhe konceptimi i çekët i jetës, nga përvoja e pamjaftueshme letrare për të trajtuar tema të rëndësishme.

Shkrimtarin mund ta nxisin dëshira dhe qëllime fisnike, ai mund të ketë mbledhur fakte dhe ngjarje me vlerë, mund të jetë i shkathët në të shkruar, siç ndodh me autorin tonë, po për të krijuar një vepër me temë të rëndësishme shoqërore këto s'mjaftojnë. Praktika letrare tregon se procesi i krijimit të një vepre është më i thellë, më i komplikuar se kaq. Pasqyrimi në një vepër i jetës së njerëzve tanë kërkon njohje të gjithanshme; artisti duhet të depërtojë në brendi të fenomenit, t'i njohë heronjtë nga brenda e të vihet në pozitat e tyre, të kapë e të fiksojë, nëpërmjet artit të tij, patosin dhe frymën revolucionare të këtyre heronjve. Për t'ia arritur kësaj, shkrimtari duhet ta asimilojë materialin jetësor në mënyrë të atillë që të bëjë një shkrimje të fakteve reale me emocionet dhe mendimet e veta, të cilat duhet doemos të përkojnë me ato të bashkëkohësve të tij. Në romanin «Ditë të gjelbra» bie në sy pikërisht një kontradiktë e qartë: ndihet qëllimi i autorit për të paraqitur figura luftëtarësh, përfaqësues të rinisë revolucionare, kurse në të vërtetë ata dalin figura tepër të zbeta, njerëz me horizont të ngushtë ideopolitik, të mbyllur në botën e tyre të vogël.

Le ta shohim më afër problemin. Thamë se romani ka një nisje premtuese. Gjëndemi para një fakti emocional: dy të rinj, Kujtimi dhe Shpresa, nisen vullnetarë për në malësi. Që në fillim marrim vesh se ata porsa janë martuar, se Kujtimi është vëlla dëshmori dhe se Shpresa është një vajzë e thjeshtë e popullit. Gjithashtu, nga sa na thotë autori, nëpërmjet tregimit të heroit, kuptojmë se ata janë të vendosur të shkojnë në krye të detyrës. Rrugë që do të bëjnë dy të rinjtë është e gjatë dhe lexuesi ka rast t'i njohë heronjtë pa mbërritur në fshat. Natyrisht heronjtë si të posamartuar, janë gjithë gëzim dhe lexuesi s'ka si të mos e kuptojë drejtë këtë gëzim të tyre të ligjshëm. Bile, për hir të kësaj, ai bën sikur nuk e vë re Kujtimin

kur e krahason Shpresën, që në krye, me kukullën (!) që varin shoferët te xhami i makinës që t'u sjellë fat (f.6). Po më tej lexuesi dalngadalë konstaton një gjë të rëndësishme: heronjtë tani na lënë të kuptojmë se nuk janë organikisht të ndërgjegjshëm për detyrën që kanë marrë, se ata nuk i frymëzon ndonjë mendim i qartë, përkundrazi gjatë rrugës kanë «një farë kllapije dhe një varg të ngatërruar mendimesh e përfytyrimesh» (f.8). Kujtimi edhe kur vjen në vete, nuk mendon për ndonjë gjë të rëndësishme, po jepet vetëm pas erës së sapunit të flokëve e të qafës së saj, vështron majën e hundës dhe shigjetat e holla të qerpikëve të saj. Që në krye, vëmë re se ata mbyllen në botën e tyre të vogël, shkëputen nga njerëzit. Edhe kur janë në automobil me të tjerët, edhe kur ecin nëpër malësi, të shoqëruar nga një malësor, ata rrijnë mënjanë dhe s'krijojnë asnjë lidhje me të tjerët. Lexuesi prapë e kupton gjendjen e tyre, ata porsa janë martuar, por ai s'ka si të mos marrë parasysh faktin se autori i konsideron këta njerëz të pararojës dhe u ka ngarkuar një detyrë të rëndësishme. Atëherë lind pyetja, ku është romantika e kësaj detyre, ku është ajo ide e madhe, që i ka mobilizuar këta dy të rinj? Te këta personazhe mungon patosi i luftëtarëve të shoqërisë sonë. Gëzimi i tyre nuk është gëzimi i madh i detyrës, përkundrazi është një gëzim i shtirë, i lidhur artificialisht me botën e madhe.

Në roman çdo gjë është vënë në funksion të dashurisë së heronjve dhe kjo ka bërë që shkrimtari të bjerë në subjektivizëm. Kështu, kur është fjala për të rilevuar dashurinë e tyre, ai e *nxin* jetën tonë, ndërsa kur është puna për të treguar vështirësitë e vërteta të jetës, e lustron realitetin. P.sh. kur Stavri, një mësues që ata takojnë në qytetin e vogël, u thotë se është mërziur malësive për tre vjet me radhë e pastaj shton: «Kam humbë nga bota si egërsinë maleve», Kujtimi i dehur nga dashuria dhe i



dëshiruar të largohet nga njerëzit për të gëzuar dashurinë e tij të vogël, e pyet si pa të keq «*Nuk të pëlqejnë malet?*» Kuptohet se logjika e Stavrit është më e besueshme se sa e Kujtimit. Po këtë e pohon edhe Shpresa, kur fshatari që i shoqëron me sinqeritet u thotë se do ta kini vështirë në këto male, ajo i përgjigjet se nuk ka gjë, se «*prapë malet tona janë*» (f.30).

Veprimet dhe bisedat që bëjnë Kujtimi me Shpresën gjatë rrugës për në malësi janë kryesisht refleksi i gjendjes së tyre subjektive: ata i karakterizojnë sensualizmi dhe afekcioni i sëmurë për njëri-tjetrin, kudo janë të pa përmbajtur, bile dhe në prani të fshatarit që i shoqëron. Në këtë gjendje emocionale është vështirë të presësh prej tyre mendime të rëndësishme. Ata janë harruar në një botë të vogël dhe kur autori pa prituri, fut ndonjë frazë që ka të bëjë me socializmin, me luftën për ndërtimin e jetës së re, ajo duket si pa vend. Kujtimi flet për çështjet e mëdha të kohës, shkarazi, me fjalë të përgjithshme. Mendimet e tij për socializmin nuk mund të kundërballancojnë skenat dhe situatat liçencioze, afeksionet e tepruara. Lexuesi i vëmendshëm e kupton se ç'gjë është kryesore në roman.

Me të mbërritur në fshat, asnjëri prej heronjve nuk mendon për detyrën që i pret. Nuk vëmë re asnjë ëndërr a plan që të lidhet me punën e tyre të ardhshme. Gjëja e parë që i shkon ndër mend Kujtimit është kjo: «*Dielli ishte shumë i ngrohtë dhe unë mendoja që qysh të nesërmen të filloja të bëja banja dielli*». Pas kësaj, heronjtë e romanit gdhëndin emrat në një pemë dhe ndërkaq u shkon mendja që para shkollës të bëjnë një yll (!) në mes të lulishtes. Pastaj nisin shëtitjet që s'kanë të mbaruar, pa ndonjë synim, shëtitjet jo në mes të njerëzve, po në gjirin e virgjër të natyrës. Megjithatë edhe këto shëtitje turistike nuk i kënaqin dy të rinjtë.

Në romanin «*Ditë të gjelbra*» jeta intime e heronjve

është absolutizuar dhe kuptohet se këta njerëz, në një mënyrë apo në një tjetër, do ta tregojnë veten e tyre. Në kundërshtim me qëllimin e autorit, vjen një çast kur ata fillojnë e mërzhiten dhe e shikojnë të ardhmen me një lloj skepticizmi. Kujtimi tregon: «*Pyesja veten se si do të jetonim në të ardhmen. Më vinte keq në qoftë se gjithë jetën do ta kalonim kështu, unë e Shpresa*» (f.71).

Puna arrin gjer këtu: jeta e vogël që bëjnë heronjtë i fut ata në një rrugë pa krye. Atëherë edhe autori gjendet ngushtë dhe për të treguar se heronjtë e tij nuk janë të tillë, se Kujtimi dhe Shpresa janë njerëz të sakrificës (!), se ata kanë ardhur në këto vende të egra për të ndërtuar jetën e re (!?), se nuk janë aq sentimentalë dhe të papërmbajtur, aq mizantropë dhe individualistë, ai e nis heroin e tij që të bëjë heroizma. Po ku e dërgon? Nuk e çon në fshat, në mes njerëzve, po e largon akoma më shumë nga ata, e ngjit më lart, në male, në vende ku «zor se mund të kalonin edhe barinjtë» (f.107). Për më tepër, Kujtimi ngjitet gjer në këto vende të largëta e të rrezikshme, fill vetëm, pa ditur rrugën, pa ndonjë qëllim, ashtu kot, si të thuash «për të gjetur shtigje të reja e vende të bukura, për të gjetur «oazin e lumturisë», siç thotë ai. Kujtimi harron fare se në ç'kohë jeton dhe ç'ndodh përçark tij. Në vështrimin e parë duket sikur me këtë autori do ta qortoje heroin e tij, po në të vërtetë bie në gabim, kur e bën të ndeshet heroin e tij me një diversant. Po a është i denjë dhe i aftë Kujtimi, me sa e njohim në pjesën e parë të romanit, ta kryejë këtë detyrë të vështirë? Lexuesi e ka zor të bashkohet këtu me autorin. Kujtimi ka dëshira, po këto mbeten vetëm dëshira të mjegullta romantike të një të riu, që e ka marrë vala e kohës dhe që nuk tregohet i lidhur shpirtërisht, me lidhje të vërteta, me ata të rinj që mbajtën mbi supet e tyre shumë detyra të rënda e delikate në vitet e para të Çlirimit. Nga ana tjetër, sikur të mos

mjaftonte kjo, G. Kongoli na e paraqet heroin edhe të paarmatosur. Pra, kemi të bëjmë me një hero «tonin», të çarmatosur para armikut shpirtërisht dhe fizikisht, ai do të ndeshet me një diversant të regjur, të armatosur deri në dhëmbë, i cili qenkish dhe profesor (?!). Si duhet ta kuptojmë këtë gjë? Mos autori do të tregojë me këtë individualizmin e heroit ashtu siç është në të vërtetë, dhe ky rast t'i shërbejë atij si mësim? Apo me heroizmin që kryen Kujtimi, autori do të mbushë jetën e zbrazët të heroit? Cilidoqoftë qëllimi, rezultati është i njëjtë. Dhe ndodh që me një *deus ex machina*, Kujtimi kur gjendet para armikut shndërrohet në njeri tjetër; ai e harron menjëherë idilin e dashurisë, i vijnë papritur forca dhe mendime të jashtëzakonshme dhe para nesh ravijëzohet për një moment figura e një luftëtari, që s'ka të bëjë fare me Kujtimin e parë. Po ky është vetëm një iluzion i çastit, sepse figura e tij mbetet po ajo, e para. Nuk duam të merremi me faktin se sa reale dhe bindëse është dhënë ndeshja e Kujtimit me diversantin. Mjafton të themi që armiku është i pajisur me automatik e thikë, me revole e radio... dhe heroi i romanit vetëm... me një shkop (?!) e megjithatë ai del fitimtar. Jo, ne nuk do të merremi me këtë; çdo njeri do të buzëqeshte kur ta lexonte dhe sado që përshkrimi me vërtetësi i ndeshjes dhe i rrethanave konkrete ka rëndësinë e tij, ne do ta konsideronim këtë gjë të jashtme, për t'i kushtuar më shumë vëmendje, jo ndeshjes fizike se sa ndeshjes moralopolitike që zhvillohet në mes protagonistit dhe antagonistit gjatë gjysmës së dytë të romanit. Le t'i hetojmë me kujdes të dy figurat. Autori i bën këta të ndeshen nëpërmjet një dialogu të pafund. Ne jemi dëshmitarë të një lufte ideologjike që bëhet në mes pikëpamjeve tona dhe pikëpamjeve të një armiku të popullit. Është një ide interesante kjo, po që në këtë rast ka dështuar. Duke e hetuar me kujdes lo-

gjikën e brendshme të kësaj ndeshjeje, duke lexuar nëntekstin, vëmë re se autori objektivisht, bile kundër dëshirës dhe qëllimit të tij, ka nxjerrë supremacinë e armikut. Armiku paraqitet gjithnjë në pozita sulmi dhe kjo theksohet më tepër kur autori, për t'u treguar sa më realist, i merr këta në pozita të barabarta, d.m.th. që secili mbron dhe lufton për diçka dhe si pasojë secili ka të drejtën e tij. Kjo ka sjellë që armiku, një diversant, një krimb që nuk përfaqëson asgjë, bëhet të flasë nga autori për ideale dhe qëllime fisnike ndaj popullit dhe t'ia kundërvejë këto idealeve tona. Diversanti arrin deri atje sa akuzon kundërshtarin se pushteti popullor i paska vrarë dashurinë («ma vranë dashurinë time» (f. 137). Ai flet për humanizëm, për pasione të larta njerëzore, merr në mbrojtje popullin dhe Shqipërinë, ka një keqardhje për Kujtimin që vuan nëpër malësi pa një qëllim real... Ai flet e flet pa pushim dhe Kujtimi nuk është në gjendje t'i kundërvejë asgjë bindëse, sepse ai vetë nuk është i bindur, ai vetë nuk i ka asimiluar mirë ato ide, që armiku ia godet e ia përdhos. Për më tepër, ne ndjejmë që Kujtimi nga presioni që i bën «profesori» është i detyruar të pohojë në tregimin e tij se armiku paraqitet me «një qetësi apostolike», «me pozë madhështore»... Ai ecën i qetë, megjithëse shkon drejt vdekjes, përgjigjet me vend, i bindur për ato që thotë, me një ironi therëse (vetë nota e ironisë në fjalën e tij është një shenjë supremacie), pa u mburrur, siç bën heroi ynë dhe mbi të gjitha, me një logjikë të fortë, gjë që autori s'e ka arritur këtë me Kujtimin. Kujtimi tregohet pa masë naiv dhe i papjekur ideologjikisht, ai u përgjigjet sulmeve të armikut me fjalë të përgjithshme, me argumente neveritëse ose me heshtje, po pa vend. G. Kongoli, për ta bërë veprën sa më dramatike dhe për të ngjallur urrejtjen ndaj armikut, bën që «profesori» të plagosë Shpresën. Po kjo gjë është kthyer në një veprim të

kundërt me qëllimin e autorit: në vend që figura e Kujtimit të ngrihet, përkundrazi ajo bie. Ai shndërrohet para armikut në njeri sentimental, humbet kurajon dhe derdh lot.

Autori i ka kushtuar një vend të veçantë përshkrimet me një notë të theksuar sensualizmi të marrëdhënieve intime të Kujtimit me Shpresën. Është vështirë të gjendet në letërsinë tonë një vepër e tillë, ku përshkrimi i këtyre marrëdhënieve të jetë kthyer në një qëllim në vetvete dhe libri t'i zvjerdhet lexuesit serioz, siç ndodh me romanin «Ditë të gjelbra». Sensualizmi dhe ekzaltimi pa vend e pa kohë, pangopësia dhe njëkohësisht velja, ja se ç'i karakterizon personazhet e veprës. Më e keqja është se këto nota zotërojnë kudo dhe i japin tonin romanit.

Një problem tjetër që nxjerr analiza e romanit është çështja e të kuptuarit të tendenciozitetit të shkrimtarit, e qëndrimit ideoemocional që duhet të mbajë ai ndaj asaj që përshkruan. Ngjarjet në romanin e G.Kongolit tregohen në vetën e parë, nga pozita e heroit. Kjo mënyrë i jep mjaft dorë autorit për ta bërë tregimin interesant dhe të singertë, po kjo mënyrë ka edhe vështirësitë e saj. Çështja është te raporti i pikëpamjes së heroit me atë të autorit, që në vepër duhet të harmonizohen. Në romanin «Ditë të gjelbra» ndihet një farë dualiteti, nuk ka harmonizim dhe koherencë. Heroi shpesh herë nuk vepron në linjën e karakterit dhe tipit të tij dhe kjo vjen nga ndërhyrjet e autorit.

Ka raste, kur idetë e mëdha të kohës sonë në gojën e Kujtimit dhe në rastet kur ai i shpreh, vulgarizohen. P.sh. për të gjetur përcaktimin e shekullit të XX, si shekulli i komunizmit, çifti e ndërton këtë mbi një cash e lashë (f.60), ose Kujtimi thotë: «Trupi i saj në këmishë të natës kishte vijat e paqes» (f.79), ose përziën komunizmin me konsumimin e rakisë (f.91), ose kur bisedojnë dy të rinjtë për fëmijët që do të bëjnë, harrojnë të caktojnë një-

rin prej tyre që të bëhet oficer sigurimi, sepse, kur plagoset Shpresa, Kujtimi thotë, «ne duhet të kishim mendue edhe për një oficer sigurimi, përveç poetit» (f. 158). Të gjitha këto dhe plot të tjera që gjenden në roman janë mendime artificiale dhe s'kanë asnjë lidhje organike me figurën e brendshme të personazheve. Shkrimtari natyrisht duhet të jetë tendencioz, po jo në kuptimin vulgar. Idetë dhe mendimet e mëdha të kohës duhet të materializohen në personazhe, të shprehen në veprimet e tyre dhe jo të paraqiten të qepura aty-këtu me pe të kuq, siç ndodh në rastin tonë. Ne kemi nevojë për një tendenciozitet artistik që ta pasqyrojë thellë e drejtë jetën, ashtu siç është, pa qenë nevoja që personazhet e veprave tona të mbahen me paterica nga autori.

Për romanin «Ditë të gjelbra» mund të flisnim akoma. Mund ta kritikojmë veprën për mungesën e botës shqip-tare, të tipave dhe ambienteve tona. Zor se mund t'i ngjaj-në të rinjtë tanë heronjve të romanit të G.Kongolit. Ata të sjellin ndër mend më shumë jehonën e heronjve të ndo-një vepre bulevardeske nga letërsia e huaj, me interesat e tyre të kufizuara, me kultin e ndjenjave dhe veçimin nga bota e madhe. Me një fjalë heronjtë e romanit «Ditë të gjelbra» nuk janë figura të marra nga realiteti ynë, nga trualli ynë, po figura të trilluara.

Ne e kuptojmë qëllimin e mirë të autorit, ashtu si çmojmë dhe disa anë pozitive të veprës, si shkathtësinë e të shkruarit, përpjekjen për një kompozicion origjinal, disa nota poetike aty këtu, ndonjë skenë të bukur, por kjo nuk justifikon faktin që G.Kongoli i ka hyrë një ndër-marrje të vështirë, pa pasur përgatitjen e mjaftueshme ideoartistike.



## P Ë R M B A J T J E

1. — Fillimet romantike të Naim Frashërit dhe novela «Katër stinët» .....	3
2. — «Ëndërrimet» — përmbledhja e parë poetike e Naimit ....	18
3. — <u>Mendime rreth pikëpamjeve estetiko-letrare të F.S.Nolit</u> .....	26
4. — <u>Dhimbje krenare</u> .....	39
5. — Krijimtaria letrare e Sterjo Spases para çlirimit .....	43
6. — Rruga e një shkrimtari patriot .....	67
7. — <u>Dorëshkrimet e Luftës Nacionalçlirimtare të Haki Stër- millit</u> .....	93
8. — <u>Ditari partizan «Shtigjet e lirisë»</u> .....	98
9. — Romani «Kalorësi i Skënderbeut» .....	106
10. — <u>Mendimi teoriko-letrar në vitet '30</u> .....	113
11. — <u>Satira e Chri-Chri-ut</u> .....	123
12. — <u>Trashëgimi letrar i Qemal Stafës</u> .....	128
13. — <u>Revista letrare klandestine «Liri»</u> .....	134
14. — <u>Realiteti dhe frymëzimi në dimensionet e një romani</u> ....	145
15. — <u>Rreth vëllimit me tregime «Ëndrra dhe dritë»</u> .....	156
16. — <u>Pikënisja e autorit dhe logjika objektive e personazheve</u> .....	165